

A L B A N I A N  
BASIC COURSE

Volume IX  
Lessons 91 - 110

April 1970

DEFENSE LANGUAGE INSTITUTE

## PREFACE

This is the ninth volume--the very first written in Toskë dialect--of the DLI Basic Course in Albanian. It contains 20 lessons, one for each day beginning with the 26th week of the intermediate phase, right after rules governing the Toskë dialect have been introduced.

The purpose of each lesson is twofold:

1. Drill in Toskë the already known structural features of the Gegë dialect.
2. Teach military terminology; as a matter of fact, the contents of the whole volume are nothing but military subjects.

As before, the daily lesson unit will continue to be centered around the basic dialogue, which has to be memorized. A prose narrative and questions provide for recombination of the material presented in the basic dialogue. You are expected to study the narrative of the current daily lesson unit at home. You should be ready to answer questions in class the following day and give an oral resume of the whole prose narrative. The situational topic of each lesson will be used also for free conversation.

Each day you will also have a small amount of written homework consisting of sentences to be translated into Albanian and into English. These sentences incorporate structural elements and military terminology of the lesson just learned.

A glossary of all new vocabulary and idioms rounds out the printed materials of each lesson.

The individual lessons are set according to a prescribed plan: presentation of the new material (dialogue presentation, prose narrative and military terminology) is given during the last two hours of the afternoon; the lesson cycle will continue the following morning with dialogue recitation, structural drill, questions and answers, which lead gradually to free conversation (the third hour of the morning). The first hour of the afternoon will be spent for reading and translation (Supplementary Reader, Vol. II).

All inquiries concerning these materials, including requests for authorization to reproduce, should be addressed to the Director, Defense Language Institute, U. S. Naval Station, Anacostia Annex, Washington, D. C. 20390.

## TABLE OF CONTENTS

Lesson	<u>Page</u>
91. THE RECRUITING	1
92. THE FIRST DAYS OF THE RECRUIT	13
93. MILITARY TRAINING	25
94. DRILLS WITH WEAPONS	39
95. FRONT LINE POSITIONS	51
96. THE REPELLING OF AN ENEMY ATTACK	63
97. RECONNAISSANCE ACTION	75
98. BOMBING CONCENTRATIONS OF TROOPS	87
99. THE BEGINNING OF THE DECISIVE ATTACK	99
100. THE DECISIVE ATTACK	113
101. INTERROGATION OF POWs	123
102. BREAKTHROUGH IN THE ENEMY FRONT LINE	135
103. A CONVOY OF SHIPS SAILING	147
104. UNSUCCESSFUL BEACH LANDING	161
105. PARATROOPERS BEHIND THE ENEMY LINES	173
106. THE ARREST AND EXECUTION OF A SPY	185
107. GUERRILLAS AND ENEMY AGENTS IN OUR REAR LINES	199
108. FINAL ASSAULT ON THE CAPITAL CITY	211
109. VICTORY DAY CELEBRATION	223
110. THE DISCHARGE FROM THE SERVICE	237

## Lesson 91




### REKRUTIMI

#### DIALOGUE

1. Si vete, Agim?
2. Mirë jam, të falem nderit. E pe shpalljen e mobilizimit të përgjithshëm?
3. E kush nuk e ka parë, o derëbardhë! A të erdhi ftesa e paraqitjes nga Zyra e Rekrutimit?
4. Si jo! U-paraqita dje para komisionit mjekësor.
5. Mua s'më ka ardhur akoma, por e pres të më vijë çdo minutë. Si dole ti me komisionin e kontrollimit?
6. Më deklaruan të aftë për shërbim ushtarak, natyrisht pas një vizite të përgjithshme.
7. Në se konsiston kjo vizitë e përgjithshme?
8. Të matin gjoksin, të matin për gjatësi, të peshojnë, të marrin gjakun e tjera gjëra si këto.
9. Pastaj, ku të shpunë?
10. Në zyrën e një oficeri të komisionit; ai më tha të qëndroja gatitu dhe të ngreja dorën e djathtë lart.
11. Dhe në këtë pozicion të bëri të betohesh....?
12. Tamam. Pastaj më urdhëroi të paraqitesha atë pasdreke në një komandë tjetër ushtarake.
13. Ç'të thanë të bësh atje?
14. Më futën në një autobus dhe më shpunë në një kamp ushtarak.
15. Në ç'orë arrite në kamp?
16. Tamam në çastin kur po ulnin flamurin. Një formacion ushtarësh qëndronte në nderim duke e përshëndetur.
17. A i more pajimet që të nevojiten?
18. Jo. Depoja e pajimeve ishte mbyllur; ato i mora sot në mëngjes.
19. Kur do t'i filloni stërvitjet ushtarake?
20. Këtë javë.

L. 91

21. Sa zgjatin?
22. Tre muaj.
23. E pas stërvitjeve?
24. Në ndonjë front.



READING TEXT

Ky është tregimi i një djaloshi që quhet Agim dhe që merret nën armë e lufton për atdheun e tij.

Kur shteti i Agimit hyri në luftë, Ministria e Mbrojtjes Popullore shpalli mobilizim të përgjithshëm. Menjëherë pas kësaj shpallje, Agimit i erdhi ftesa nga Zyra e Rekrutimit që të paraqitej para një komisioni të posaçëm mjekësor për t'u-kontrolluar në se ishte fizikisht i aftë për të shërbyer në ushtri.

Në Zyrën e Rekrutimit gjeti shumë djem tjerë, shokë e fqinjë, që ishin paraqitur për të njëjtin qëllim. Shumica e tyre ishin të thirrur, por ca prej tyre ishin paraqitur vullnetarisht, d.m.th. ishin vullnetarë.

Kur Agimit i erdhi radha që të dilte para komisionit, mjeku e vizitoi me kujdes të madh; pastaj, i mati gjoksin, e peshoi dhe e mati për gjatësi. Në fund të vizitës, mjeku e gjeti Agimin të aftë për shërbim ushtarak; në një zyrë tjetër bëri betimin dhe mori udhëzime se ku duhej të paraqitej atë pasdreke.

Në orën e caktuar, Agimi hypi në një autobus të posaçëm, i cili e shpuri në një kamp ushtarak. Autobusi arriti atje në çastin kur po ulnin flamurin. Ndërsa flamuri po ulej një



formacion ushtarësh kish marrë drejtqëndrim, kurse komandanti i këtij formacioni e përshëndeste flamurin duke mbajtur dorën e djathtë pranë strehës së kapelës. Kur flamuri kish arritur fundin e shtizës, borizani dha shenjën se ceremonia kish marrë fund; komandanti i dha urdhër formacionit që të shpërndahej. Ushtarët u-drejtuuan togje-togje nga kazermat e tyre, për t'u-larë, për t'u-pastruar dhe për t'u-bërë gati që të venin në mensë për të ngrënë. Ushtrimet e asaj dite kishin marrë fund.

Pasi ishte vonë dhe depoja e pajimeve ishte mbyllur, Agimi ndenji i veshur si civil edhe atë natë; të nesërmen do të pajisej me të gjitha gjërat që i nevojiten një ushtari. Për tre a katër muaj do të bënte stërvitje të ndryshme dhe pas kësaj periudhe do t'a dërgonin në ndonjë front për të luftuar.

QUESTIONS

1. Tregimi i kujt është ky që lexuam sot?
2. Si quhet djaloshi që merret nën armë?
3. Për cilin vend lufton Agimi?
4. Cili shtet hyri në luftë?
5. Ç'bëri Ministria e Mbrojtjes Popullore kur shteti i Agimit hyri në luftë?
6. Pse shpalli mobilizim të përgjithshëm Ministria e Mbrojtjes Popullore?
7. Kur i erdhi Agimit ftesa për t'u-paraqitur para një komisioni të posaçëm mjekësor?
8. Ç'i erdhi Agimit menjëherë pas kësaj shpallje?
9. Çfarë komisioni ishte ai, para të cilit duhej të paraqitej Agimi?
10. Pse do të paraqitej Agimi para komisionit të posaçëm mjekësor?
11. Si duhet të ishte Agimi fizikisht për të shërbyer n'ushtri?
12. Në cilën zyrë gjeti ai shumë djem tjerë, shokë e fqinjë?
13. Pse ishin paraqitur ata në Zyrën e Rekrutimit?
14. Cilët ishin paraqitur në Zyrën e Rekrutimit për të njëjtin qëllim që ishte paraqitur edhe Agimi?
15. A ishin të thirrur të gjithë ata që gjeti Agimi në Zyrën e Rekrutimit?
16. Sa prej tyre ishin të thirrur dhe sa ishin paraqitur vullnetarisht?
17. Si quhet një njeri që bën diçka vullnetarisht?
18. Kush e vizitoi Agimin kur i erdhi radha që të dilte para komisionit?

19. Kur e vizitoi mjeku Agimin?
20. Me çfarë kujdesi e vizitoi mjeku Agimin?
21. Pasi e vizitoi, ç'i mati mjeku Agimit?
22. Ç'tjetër bëri mjeku pasi i a mati gjoksin?
23. Si e gjeti mjeku Agimin në fund të vizitës?
24. Kë gjeti mjeku të aftë për shërbim ushtarak?
25. Ç'bëri Agimi në një zyrë tjetër?
26. Pasi bëri betimin, çfarë udhëzimesh mori Agimi?
27. Kur mori ai udhëzime se ku duhej të paraqitej atë pasdreke?
28. Ç'bëri Agimi në orën e caktuar?
29. Kur hypi Agimi në një autobus të posaçëm?
30. Ku e shpuri Agimin autobusi i posaçëm?
31. Në çë çast arriti autobusi në kampin ushtarak?
32. Kur po e ulnin flamurin?
33. Ndërsa po ulej flamuri, çfarë qëndrimi kish marrë formacioni i ushtarëve?
34. Pse kish marrë drejtqëndrim ky formacion ushtarësh?
35. Kush e përshëndeste flamurin duke mbajtur dorën e djathtë pranë strehës së kapelës?
36. Në ç'mënyrë e përshëndeste flamurin komandanti i formacionit?
37. Kur flamuri kish arritur fundin e shtizës, kush dha shenjën se ceremonia kish marrë fund?
38. Kur dha borizani shenjën se ceremonia kish marrë fund?
39. Ç'do të thonte shenja që dha borizani kur flamuri arriti fundin e shtizës?

L. 91

40. Cila ceremoni kish marrë fund kur borizani i ra borisë?
41. Kush i dha urdhër formacionit që të shpërndahej?
42. Ç'urdhër i dha komandanti formacionit?
43. Cilët u-drejtuuan togje-togje nga kazermat e tyre?
44. Nga u-drejtuuan që të venë ushtarët?
45. Cilët duhet të laheshin, të pastroheshin dhe të bëheshin gati për të vajtur në mensë?
46. Pse duhet të venin ushtarët në kazermat e tyre?
47. Pse duhet të venin ata në mensë?
48. Cilat ushtrime kishin marrë fund pas uljes së flamurit?
49. Pse ndenji atë natë i veshur si civil Agimi?
50. Ç'i duhej Agimit të bënte atë natë, pasi ishte vonë dhe pasi depoja e pajimeve ishte mbyllur?
51. Kur do të pajisej ai me të gjitha gjërat që i nevojiten një ushtari?
52. Me se do të pajisej Agimi të nesërmen?
53. Çfarë gjërash ka në një depo pajimesh?
54. Ç'do të bënte Agimi në kampin ushtarak për nja tre a katër muaj?
55. Sa kohë zgjatin stërvitjet e ndryshme që do të bënte Agimi?
56. Pas kësaj periudhe, ku do t'a dërgonin Agimin?
57. Pas cilës periudhë do t'a dërgonin Agimin në ndonjë front?
58. Pse do t'a dërgonin atë në front pasi të mbaronin stërvitjet e ndryshme?

## VOCABULARY

i, e, të aftë të afta	(adj. m. & f.)	able, capable; fit
akoma	(adv.)	still, yet
për të arritur (unë arrij)	(v.)	see "me mrrîjtë"
betim, -i betime, -t	(m.)	oath
për t'u-betuar (unë betohem)	(v.)	to swear, to take an oath, to be sworn in
borizan, -i borizanë, -t	(m.)	bugler
ceremoni, -a ceremoni, -të	(f.)	ceremony
derëbardhë	(adj.)	used as an interjection, sarcastically, meaning "my dear friend"
djalosh, -i djelmosha, -t	(m.)	a young man
fizikisht	(adv.)	physically
formacion, -i formacione, -t	(m.)	formation
fqinjë, -a fqinjë, -t	(f.)	neighbor
ftesë, -a ftesa, -t	(f.)	invitation; summons

## L. 91

kamp, -i kampe, -t	(m.)	camp
komandë, -a komanda, -t	(f.)	command, headquarters; order (mil.)
komision, -i komisione, -t	(m.)	commission
për të konsistuar (konsiston)	(v.)	to consist
kontrollim, -i kontrollime, -t	(m.)	control; search
për t'u-kontrolluar (unë kontrollohem)	(v.)	to be checked; searched
lart	(adv.)	see "nalt"
mobilizim, -i mobilizime, -t	(m.)	mobilization
nderim, -i nderime, -t	(m.)	respect; honoring; salute, saluting
të nesërmen	(adv.)	next day
për t'u-nevojitur (unë nevojitem)	(v.)	to be needed
për të ngritur (unë ngre)	(v.)	to raise, lift
pajime, -t	(f.)	supplies, equipment (mil.)
për t'u-pajisur (unë pajisem)	(v.)	to be equipped, furnished
paraqitje, -a paraqitje, -t	(f.)	reporting; introduction

pozicion, -i pozicione, -t	(m.)	position
rekrutim, -i	(m.)	recruiting
stërvitje, -a stërvitje, -t	(f.)	training; exercises
strehë, -a strehë, -t	(f.)	shelter; eaves (roof); brim (of a hat); asylum, refuge
shenjë, -a shenja, -t	(f.)	sign, mark; target
për të shpënë (unë shpie)	(v.)	to send, take (persons or things)
shtizë, -a shtiza, -t	(f.)	flagpole; spear
tog, -u togje, -t	(m.)	group, heap
togje - togje	(adv.)	in groups
i, e, të thirrur të thirrura	(adj. m. & f.)	called, invited; summoned
udhëzim, -i udhëzime, -t	(m.)	instruction, briefing(s)
urdhër, -i urdhëra, -t	(m.)	order, command
vullnetar, -i vullnetarë, -t	(m.)	volunteer
vullnetarisht	(adv.)	voluntarily

## IDIOMS

Gatitu!		Attention!
për të bërë betim(in (unë bëj betimin)	(v.)	to take an oath, to be sworn in
për t'u-bërë gati (unë bëhem gati)	(v.)	to get ready
për të marr drejqëndrim (unë marr drejqëndrim)	(v.)	to come to attention
për të marrë fund (merr fund)	(v.)	to come to an end, to end
për t'u-marrë nën armë (unë merrem nën armë)	(v.)	to be drafted

## HOMEWORK

Translate the following questions:

1. I swear that I wasn't here yesterday.
2. I'll go with you; wait a moment.
3. Did you measure it?
4. I got a temporary job at the Division HQ.
5. They came almost at the same time.
6. Nuk mori drejtpërdrejt, prandaj i bërtiti.
7. Nuk qe i veshur ashtu si thua ti.
8. Ndenja nën strehë të shtëpisë gjersa pushoi shiu.
9. Mos më thuaj që s'ke vajtur.
10. Po të kisha ngrënë më heret do të vija me ty.



## Mësimi i 92-të







### DITËT E PARA TË REKRUTIT

#### DIALOGU

1. Me lejë? Mirë mëngjes!
2. Urdhëroni! Urdhëroni! Më duket se jeni i ri këtu!
3. Po, ka dhjetë ditë që jam marrë nën armë.
4. Atëherë qenkeni ende duke bërë stërvitjet e para!
5. Po, jam rekrut.
6. Ç'bën një rekrut ditën e parë që paraqitet në garnizon?
7. Ditën e parë rekruti duhet të bëjë të gjitha provimet e klasifikimit për të marrë vesh se çfarë aftësie ka.
8. Po pastaj, ç'ngjan?
9. Sipas aftësisë që tregon, rekrutin e caktojnë ja në ushtri, ja në marinë ose në aviacion.
10. Në ç'degë ju caktuan ju?
11. Mua më caktuan në këmbësori si pushkatar. Po atë ditë më dërguan në një magazinë ku mora të gjitha pajimet që ka nevojë një ushtar.
12. Cilat janë këto pajime?
13. Uniforma, pushka, rrypi i fishekëve, mataraja, krahoshi etj.
14. A ju kanë mësuar si bëhet krevati në ushtri?
15. Sigurisht, m'a kanë mësuar që ditën e parë.
16. Përveç stërvitjeve ushtarake, ç'gjë tjetër bëni?
17. Herë pas here na caktojnë të lajmë enët, të presim barin, të pastrojmë oborrin dhe të ngarkojmë e të shkarkojmë plaçka.
18. A keni lejë të dilni përditë?
19. Gjatë ditëve të para jo, më vonë po.
20. Ç'ngjan po të dilni pa lejë?

L. 92

21. Na fusin në burg e në qoftë se e përsërisim na dëbojnë nga ushtria.
22. Kanë dëbuar ndonjë nga shokët tuaj?
23. Po, një shoku i ngjau një fatkeqësi e tillë.



## LEXIM E PËRKTHIM

Agimi, që ish marrë ushtar pak ditë më parë, arriti një mbrëmje në bazën ushtarake ku e kishin caktuar.

Të nesërmen Agimit i u-desh të ngrihej heret për të marrë pjesë në paraqitjen e forcës. Atë e kishin caktuar përkohësisht në një njësi, dhe emri i tij ish në raportin e mëngjesit të kompanisë. Më vonë, gjatë asaj dite, Agimi pati rast të shihte të tërë kampin ku ish caktuar. Garnizoni ish i madh, dhe përveç degësh tjera, kish edhe një degë për edukimin dhe stërvitjen e ushtarëve. Kjo degë posa ish krijuar.

Pastaj Agimin e dërguan në seksionin e Klasifikimit dhe të Caktimit të Detyrave për t'a provuar për prirje e aftësi. U-caktua në degën e këmbësisë për t'u-stërvitur si pushkatar. Pastaj i dhanë pajimet: uniformën ushtarake me shenjën dalluese të këmbësisë që është një kurorë dafine mbi një cohë të kuqe. Agimi i gJORë s'dinte ç'të bënte me pushkën, me rrypin e fishekëve, me mataranë dhe me krahoshin.

Gjëja e parë që mësoi Agimi qe si të bënte krevatin ashtu siç e bëjnë ushtarët tjerë. Ai mori vesh edhe se, përveç ushtrimeve dhe mësimëve ushtarake, do të caktohej herë pas here, të bënte punë të ndryshme, si p.sh. të lante enë, të priste bar, të pastronte oborrin dhe të ngarkonte e të shkarkonte material ushtarak.

Një ditë prej ditësh njerit prej shokëve të Agimit i ngjau një fatkeqësi. Duke qenë se ai ish i pakujdesshëm, i pasjellshëm dhe se nuk bashkëpunonte me tjerët, atij i u-mohua e drejta e lejës. Kjo gjë e pezmatoi shumë dhe prandaj iku pa leje në shtëpi.

Pak ditë më vonë u-arrestua nga Forcat e Sigurimit të Ushtrisë, të cilat e sollën në garnizon për t'u-gjykuar nga Gjyqi Ushtarak. Gjyqi ushtarak e nxori fajtor. E dëbuan nga ushtria dhe e futën në burg.

PYETJE

1. Kush ish marrë ushtar pak ditë më parë?
2. Kur ish marrë ushtar Agimi?
3. Në çfarë baze arriti ai një mbrëmje?
4. Ku arriti Agimi një mbrëmje?
5. Kur i u-desh atij të ngrihej heret?
6. Ç'i u-desh Agimit të bënte të nesërmen për të marrë pjesë në paraqitjen e forcës?
7. Pse i u-desh Agimit të ngrihej heret të nesërmen?
8. Ku e kishin caktuar atë përkohësisht?
9. Për sa kohë e kishin caktuar Agimin në një njësi?
10. Në çfarë raporti ish emri i tij?
11. Emri i kujt ish në raportin e mëngjesit të kompanisë?
12. Gjatë cilës ditë pati rast Agimi të shihte të tërë kampin ku ish caktuar?
13. Ç'pati rast të bënte Agimi më vonë, gjatë asaj dite?
14. Cilin kamp pati rast të shihte Agimi gjatë asaj dite?
15. Si ish garnizoni ku u-caktua Agimi?
16. Përveç degësh tjera, edhe çfarë dege kish garnizoni?
17. Për edukimin dhe stërvitjen e kujt ish krijuar dega tjetër e garnizonit?
18. Kur ish krijuar dega për edukimin dhe stërvitjen e ushtarëve?
19. Kë dërguan pastaj në Seksionin e Klasifikimit dhe të Caktimit të Detyrave?

20. Në çfarë seksioni e dërguan pastaj Agimin?
21. Agimin e dërguan në Seksionin e Klasifikimit dhe të Caktimit të Detyrave për t'a provuar për aftësi dhe për çka tjetër?
22. Atë e dërguan për t'a provuar për prirje dhe për çka tjetër?
23. Në ç'degë u-caktua Agimi për t'u-stërvitur si pushkatar?
24. Pse u-caktua Agimi në degën e këmbësorisë?
25. Ç'i dhanë pastaj Agimit?
26. Kujt i dhanë pastaj pajimet për të cilat ka nevojë një ushtar?
27. Çfarë pajimesh i dhanë Agimit?
28. Cila është shenja dalluese e këmbësorisë në uniformën ushtarake?
29. Shenja dalluese e çfarë dege është një kurorë dafine mbi një cohë të kuqe?
30. Çfarë ngjyre ka coha, mbi të cilën është një kurorë dafine?
31. Kush nuk dinte ç'të bënte me pushkën, me rrypin e fishekëve, me mataranë dhe me krahoshin?
32. Si quhen me një fjalë pushka, rrypi i fishekëvet, mataraja dhe krahoshi?
33. Cila qe gjëja e parë që mësoi të bënte Agimi?
34. Si cilët ushtarë mësoi t'a bënte ai krevatin?
35. Çfarë punësh do të caktohej të bënte Agimi herë pas here?
36. Përveç ushtrimeve e mësimëve ushtarake, ç'do të bënte ai herë pas here?
37. Ç'mori vesh Agimi?
38. Kur do të lante ai enë, do të priste bar, do të pastronte oborrin dhe do të ngarkonte e do të shkarkonte material ushtarak?

39. Ç' duhej t'i bënte barit?
40. Ç' duhej të pastronte?
41. Ç' material duhej të ngarkonte e të shkarkonte ai?
42. Kujt i ngjau një fatkeqësi?
43. Ç' i ngjau njerit prej shokëve të Agimit?
44. Kur i ngjau një fatkeqësi njerit prej shokëve të Agimit?
45. Kush ish i pakujdesshëm dhe i pasjellshëm?
46. Cili nuk bashkëpunonte me tjerët, Agimi apo njeri nga shokët e tij?
47. Pse i u-mohua e drejta e lejës njerit prej shokëve të Agimit?
48. Ç' i u-mohua njerit prej shokëve të Agimit?
49. Kë pezmatoi kjo gjë?
50. Pse u-pezmatua njeri nga shokët e Agimit?
51. Ç' bëri ky?
52. Ku iku pa lejë?
53. Si iku ky në shtëpi?
54. Kush u-arrestua pak ditë më vonë nga Forcat e Zbulimit të ushtrisë?
55. Ç' i ngjau pak ditë më vonë njerit prej shokëve të Agimit?
56. Kur u-arrestua ai?
57. Nga kush u-arrestua njeri nga shokët e Agimit?
58. Ç' bënë Forcat e Sigurimit të Ushtrisë pak ditë më vonë?
59. Kë sollën Forcat e Sigurimit të Ushtrisë në garnizon?



60. Cilat forca e sollën atë në garnizon për t'u-gjykuar?
61. Pse e sollën Forcat e Sigurimit të Ushtrisë njerin nga shokët e Agimit në garnizon?
62. Nga kush do të gjykohej njeri nga shokët e Agimit?
63. Ç'do t'i bënte gjyqi ushtarak njerit nga shokët e Agimit?
64. Cili gjyq do t'a gjykonte shokun e Agimit?
65. Kë nxori fajtor gjyqi ushtarak?
66. Kë dëbuan nga ushtria dhe futën në burg?
67. Pse e dëbuan nga ushtria dhe e futën në burg njerin nga shokët e Agimit?
68. Ç'i ngjau shokut të Agimit pasi e dëbuan nga ushtria?
69. Në ç'vit jeni marrë nën armë?
70. Kur jeni marrë ushtar?
71. Kur keni hyrë në ushtri?
72. Kur keni hyrë në aviacion?
73. Kur keni hyrë në marinë?
74. A arrestohet një djalë i ri kur nuk paraqitet në zyrën e rekrutimit?
75. Cila është shenja dalluese e Këmbësorisë së Ushtrisë Amerikane?
76. Çfarë ngjyre ka uniforma e Marinës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës?
77. Çfarë ngjyre ka uniforma e Aviacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës?
78. Cili nga ju ka prirje për muzikë?
79. Për çfarë keni prirje ju?

## FJALOR

për t'u-arrestuar (unë arrestohem)	(v.)	to be arrested
për të bashkëpunuar (unë bashkëpunoj)	(v.)	to collaborate
caktim, -i	(m.)	assignment, designation
për t'u-caktuar (unë caktohem)	(v.)	to be assigned, designated; to be set
cohë, -a cohëra, -t	(f.)	cloth, material
dafinë, -a dafina, -t	(f.)	laurel
dallues, -e	(adj. m. & f.)	distinguishing
për të dëbuar (unë dëboj)	(v.)	to expel, oust, throw out, deport
duke	(particle)	see "tue"
enë, -a enë, -t	(f.)	dish(es)
fajtor, fajtorë fajtore	(adj. m. & f.)	guilty
garnizon, -i garnizone, -t	(m.)	garrison
i, e, të gjorë të gjora	(adj. m. & f.)	poor, miserable, wretched
për t'u-gjykuar (unë gjykohe)	(v.)	to be judged, tried
për të ikur (unë iki)	(v.)	see "me hikë"

klasifikim, -i klasifikime, -t	(m.)	classification
krahosh, -i krahosha, -t	(m.)	knapsack
magazinë, -a magazina, -t	(f.)	warehouse, store; department store
për të marrë pjesë (unë marr pjesë)	(v.)	to participate, to take part
për të mohuar (unë mohoj)	(v.)	to deny, refute, refuse
për t'u-mohuar (mohohet)	(v.)	to be denied, refuted, refused
për t'u-ngritur (unë ngrihem)	(v.)	to get up; to be raised; to take off (aircraft)
ose	(conj.)	see "ase"
pas	(prep. & adv.)	after; behind
i, të pakujdesshëm e, të pakujdesshme	(adj. m. & f.)	careless, reckless
i, të pasjellshëm e, të pasjellshme	(adj. m. & f.)	impolite
për të pezmatuar (unë pezmatoj)	(v.)	to irritate, inflamm
përkohësisht	(adv.)	temporarily
prirje, -a prirje, -t	(f.)	talent, inclination
që	(prep.)	since (for time), from
raport, -i raporte	(m.)	report

rekrut, -i rekrutë, -t	(m.)	recruit
seksion, -i seksione, -t	(m.)	section
siç	(conj.)	as, like
sipas	(prep.)	see "simbas"
për t'u-stërvitur (unë stërvitem)	(v.)	to be trained

#### SHËNIM

për të marrë pjesë në paraqitjen  
e forcës

to report to the  
reveille formation

#### DETYRË SHTRËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. He was drafted last month.
2. I denied everything he said because he wasn't telling the truth.
3. He has talent for music.
4. She is working here temporarily until she finds a better job.
5. I was trained in one of the Army camps in the Berat district.
6. What color is the new uniform?
7. He lacks the ability for this kind of job.
8. Poor Petrit had a car accident downtown and was arrested.
9. He'll be tried for not having a driver's license.
10. He is careless once in a while.

## Mësimi i 93-të




### STËRVITJE USHTARAKE

#### DIALOGU

1. Mirë mëngjes, Zoti Kapter!
2. Mirë mëngjes, Agim!
3. Të lutem më trego pak ç'duhet të mësojë një rekrut gjatë stërvitjeve të para ushtarake. Jam i ri këtu dhe jam hutuar fare.
4. Kështu është në fillim. Gjërat kryesore janë: ushtrimet fizike, marshimet, përdorimi i armëve, leximi i hartave topografike etj.
5. Ç'na mësojnë në ushtri ditët e para?
6. Ju mësojnë si të marshoni, si të nderoni e si të viheni në radhë.
7. A merr rekruti mësimë mbi organizimin e ushtrisë?
8. Po, por mbi gjëra themelore d.m.th. mbi gradat e ushtrisë, mbi njësitë e ndryshme dhe cilët janë oficerët që i komandojnë.
9. Cilat janë degët që përbëjnë Fuqitë e Armatosura?
10. Ushtria, Marina dhe Aviacioni.
11. Po Xhenioja, Këmbësoria, Trupi Mjekësor e Njësia e Sinjaleve, a nuk janë degë më vete?
12. Jo, ato mvaren nga Ushtria.
13. A janë të vështira ushtrimet fizike?
14. Jo, nuk janë të vështira sidomos kur njeriu është i ri siç je ti.
15. Çfarë ushtrimesh bëjnë rekrutët?
16. Marshojnë çdo javë 20-30 km., dhe kur shkojnë për fushim, natën flejnë ndër çadra.
17. Po tjetër ç'bëjnë?
18. Kalojnë lumenj të ftohët e të rrezikshëm, kapërcejnë pengesa dhe u ngjiten maleve.

L. 93

19. Cili është organi më i lartë që drejton Fuqinë e Armatosura?
20. Ministria e Mbrojtjes Popullore dhe titullari i këtij dikasteri është një gjeneral.
21. Të falem nderit shumë. Tani kuptoj diçka më tepër.
22. Pak nga pak do të mësosh shumë gjëra.
23. Ditën e mirë!
24. Ditën e mirë!



## LEXIM E PËRKTHIM

Të tërë ushtarët, çfarëdo dege qofshin, duhet të kenë një farë njohurie mbi gjërat themelore që mësohen në ushtri. Këto gjëra janë: organizimi i ushtrisë, përdorimi i armëve në përgjithësi dhe i armëve vetiake, leximi i hartave topografike etj.

Agimi filloi stërvitjet ushtarake duke mësuar të marshojë, të nderojë dhe të marrë pjesë në formacione ushtarake. Në mësimet e organizimit të ushtrisë, Agimi mësoi edhe gradat e ushtrisë, të cilat, duke filluar nga poshtë, janë: ushtar i thjeshtë, tetar, rreshter, kapter, marshall, nëntoger, toger, kapiten, kapiten i klasës së parë, major, nënkolonel, kolonel dhe gjeneral.

Çdo skuadër komandohet nga një nënoficer, kurse një togë komandohet nga një toger. Kompania ose bateria zakonisht komandohet nga një kapiten, batalioni nga një major; regjimenti komandohet nga një kolonel dhe brigada ose një njësi më e madhe se kjo komandohet nga një gjeneral.

Agimi mësoi shumë gjëra mbi disa nga degët e ndryshme të ushtrisë, si p.sh. mbi Këmbësinë, mbi Artilerinë, mbi Mjetet e Koracuara, mbi Trupin Mjekësor, mbi Trupin e Veterinerëve dhe mbi Njësinë e Sinjaleve. I dhanë edhe ca njohuri mbi degët tjera të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, si mbi Marinën dhe Aviacionin.



Për t'u-zhvilluar fizikisht dhe në mënyrë që të përballonte kondita të vështira, Agimi ndoqi edhe një kurs ushtrimesh fizike. Në një nga këto ushtrime i u-desh të marshonte njëzet e pesë kilometra në pothuaj pesë orë. Gjithënjë gjatë stërvitjeve njësia, në të cilën ndodhej Agimi, shkoi për fushim. Gjatë kësaj kohe ushtarët e kësaj njësie flinin ndër çadra dhe në mëngjes ktheheshin me kamiona në kampin e tyre.

Nga sa thamë më lart, duket sikur jeta ushtarake është e vështirë dhe se nuk ka gjë tjetër përveç stërvitjeve dhe mësimëve. Kjo përshtypje është e gabuar. Jeta ushtarake ka edhe të mirat e saja. Miqësitë më të ngushta formohen nganjëherë gjatë jetës ushtarake. Djali i ri që shkon në ushtri takohet me djem tjerë nga krahina të ndryshme, sheh vende të reja dhe, përveç që bën detyrën, mëson edhe shumë gjëra të vlefshme për jetën e tij.

PYETJE

1. Cilët duhet të kenë një farë njohurie mbi gjërat themelore që mësohen në ushtri?
2. Ç' duhet të kenë të tërë ushtarët, çfarëdo dege qofshin?
3. Mbi çfarë gjërash duhet të kenë njëfarë njohurie të tërë ushtarët?
4. Kush duhet të ketë njohuri mbi organizimin e ushtrisë, mbi përdorimin e armëve në përgjithësi dhe të armëve vetiake?
5. Ku mësohet përdorimi i armëve në përgjithësi, i armëve vetiake dhe leximi i hartave topografike?
6. Ç' mësohet në ushtri?
7. Ç' duhet të dijë të lexojë një ushtar?
8. Si i filloi Agimi stërvitjet ushtarake?
9. Kush i filloi stërvitjet ushtarake duke mësuar të marshojë, të nderojë dhe të marrë pjesë në formacione ushtarake?
10. Në cilat mësimë i mësoi Agimi gradat e ushtrisë?
11. Cilat janë gradat e ushtrisë duke filluar nga poshtë?
12. Cilat janë gradat e ushtrisë duke filluar nga lart?
13. Ç' njësi komandohet nga një nënoficer?
14. Kush e komandon skuadrën?
15. Kush e komandon togën?
16. Kush e komandon kompaninë ose baterinë?
17. Ç' gradë ka komandanti i një toge?
18. Ç' gradë ka komandanti i një kompanie?
19. Ç' gradë ka komandanti i një batalioni?

20. Ç'gradë ka komandanti i një regjimenti?
21. Ç'njësi komandohet nga një kolonel?
22. Ç'njësi komandohet nga një gjeneral?
23. Kush e komandon brigadën?
24. Çka mësoi Agimi mbi disa nga degët e ndryshme të ushtrisë?
25. Mbi cilat degë të ushtrisë mësoi Agimi shumë gjëra?
26. Ç'mësoi ai mbi Këmbësorinë, mbi Artilerinë, mbi Mjetet e Koracuara, mbi Trupin Mjekësor, mbi Trupin e Veterinerëve dhe mbi Njësinë e Sinjaleve?
27. Si quhet dega e këmbësorëve?
28. Si quhet dega që merret me shëndetin e ushtarëve?
29. Si quhet njësia që merret me sinjale?
30. Si quhet njësia që merret me ndërtimin e urave?
31. Si quhet njësia që merret me ndërtimin e rrugëve?
32. Edhe mbi çfarë degësh i dhanë Agimit njohuri?
33. Nga cila ministri mvaren Ushtria, Marina dhe Aviacioni?
34. Çka mvaret nga Ministria e Mbrojtjes Popullore?
35. Çfarë kursi ndoqi Agimi për t'u-zhvilluar fizikisht?
36. Ç'kurse ndjekin rekrutët për t'u-zhvilluar fizikisht dhe për të përballuar kondita të vështira?
37. Pse i ndjekin rekrutët kurset e ushtrimeve fizike?
38. Çfarë konditash duhet të përballojë një ushtar?
39. Sa kilometra i u-desh Agimit të marshonte në një nga këto ushtrime fizike?
40. Ç'i u-desh atij të bënte në pothuaj pesë orë?

41. Në çfarë rasti i u-desh Agimit të marshonte njëzet e pesë kilometra në pothuaj pesë orë?
42. Në sa orë i bëri Agimi të 25 kilometrat duke marshuar?
43. Ku shkoi njësia në të cilën ndodhej Agimi?
44. Ç'bëri njësia në të cilën ndodhej Agimi, gjithënjë gjatë stërvitjeve?
45. Ku flinin ushtarët e kësaj njësie gjatë kësaj kohe?
46. Kur ktheheshin me kamiona në kampin e tyre?
47. Me çfarë mjetesh ktheheshin ushtarët në kampin e tyre?
48. Me se ktheheshin ata në kamp pas fushimit?
49. Nga sa thamë më lart, çfarë jete duket se është e vështirë?
50. Cila jetë duket se nuk ka gjë tjetër, përveç stërvitjeve dhe mësimeve?
51. Ç'përshtypje është e gabuar?
52. Ç'gjë tjetër ka jeta ushtarake përveç stërvitjeve dhe mësimeve?
53. Ç'formohet nganjëherë gjatë jetës ushtarake?
54. Çfarë miqësish formohen nganjëherë gjatë kësaj jete?
55. Me kë takohet djali i ri që shkon në ushtri?
56. Nga ç'krahina janë djemtë, me të cilët takohet djali i ri që shkon ushtar?
57. Çfarë vendesh sheh një i ri që shkon ushtar?
58. Përveç detyrës që bën, edhe çfarë gjërash mëson një i ri që shkon ushtar?
59. Për çka duhen gjërat e vlefshme që mëson i riu në ushtri?
60. A janë armë vetiake pushka e revolveri?

61. Ç'gradë ka komandanti i togës suaj?
62. Sa toga ka një kompani?
63. Kur i përdorim ne çadrat?
64. Ç'përdorim ne kur bie shi?
65. Kush i përdor hartat topografike më shumë: oficerët apo nënoficerët?
66. Për se shërbejnë hartat topografike?
67. Në cilën degë të Fuqive të Armatosura është më e vështirë jeta sipas mendimit tuaj?
68. Ç'degë e ushtrisë ka mjete të koracuara?
69. A përdor Marina mjete të koracuara?
70. A keni parë ndonjë mjet të koracuar në Presidio?
71. Ç'mjete transporti dini të ngisni ju, Z....?

## FJALOR

bateri, -a bateri, -të	(f.)	battery
çfarëdo	(adj. & pron.)	whatever, any kind
për t'u-dorëzuar (unë dorëzohem)	(v.)	to surrender oneself; to be handed over
i, e, të gabuar të gabuara	(adj. m. & f.)	mistaken, wrong, erroneous
fizik, -e	(adj. m. & f.)	physical
për t'u-formuar (unë formohem)	(v.)	to be formed
fushim, -i fushime, -t	(m.)	camping, bivouac
hartë, -a harta, -t	(f.)	map
për t'u-hutuar (unë hutohem)	(v.)	to be confused, distracted
kamion, -i kamiona, -t	(m.)	truck
për të kapërcyer (unë kapërcej)	(v.)	to jump over, cross; to transcend
për të komanduar (unë komandoj)	(v.)	to command
për t'u-komanduar (unë komandohem)	(v.)	to be commanded
i, e, të koracuar të koracuara	(adj. m. & f.)	armored
kurs, -i kurse, -t	(m.)	course

i, e, të lartë të larta	(adj. m. & f.)	see "i naltë"
lexim, -i lexime, -t	(m.)	reading
marshim, -i marshime, -t	(m.)	march, marching
për të marshuar (unë marshoj)	(v.)	to march
një farë	(adj.)	a certain, a kind of, a sort of
pengesë, -a pengesa, -t	(f.)	obstacle, hurdle, stumbling-block
për të përballuar (unë përballoj)	(v.)	to withstand (hardships); to meet (expenses)
përshtypje, -a përshtypje, -t	(f.)	impression
sinjal, -i sinjale, -t	(m.)	signal
skuadër, skuadra skuadra, -t	(f.)	squad, team
titullar, -i titullarë, -t	(m.)	head of an office
togë, -a toga, -t	(f.)	platoon
topografik, -e	(adj. m. & f.)	topographic, topographical
themelor, -e themelorë	(adj. m. & f.)	fundamental, basic
më vete	(adj.)	independent

veteriner, -i veterinerë, -t	(m.)	veterinarian
vetiak, -e	(adj. m. & f.)	personal
i, të vlefshëm e, të vlefshme	(adj. m. & f.)	valuable, valid
xhenio, -ja	(f.)	engineer (mil.)
për t'u-zhvilluar (unë zhvillohem)	(v.)	to be developed, evolved; to take place

SHËNIME

mjetet e koracuara	armored vehicles
Trupi mjekësor	Medical Corps
Trupi i Veterinerëve	Veterinarian Corps
ushtar i thjeshtë	private (mil.)

DETYRË SHËNIME

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. Albania became independent on November 28, 1912.
2. Don't you have an umbrella? It's raining hard.
3. They went camping out of town.
4. We have a very good map of Albania made in Austria.
5. This is a street for pedestrians and not for cars.
6. They surrendered without conditions.
7. This gentleman is the head of the office.



8. Why don't you take the dog to a veterinarian?
9. I bought a new battery yesterday and I'm broke.
10. I like to sleep in a tent when the weather is good.

L. 93

Mësimi i 94-të









USHTRIME ME ARMË

DIALOGU

1. Hajde! Hajde! Më këmbë shpejt! Më dukeni si pleq të shkretë.
2. Ngadalë, Zoti Kapter, jemi shumë të lodhur nga marshimi që bëmë dje.
3. Nuk do të bëjmë ushtrime sot. Sot do të flasim mbi armët. Ç'armë duhet të njohë më mirë një ushtar?
4. Pushkën, natyrisht, duhet të dijë t'a montojë dhe t'a smontojë me sy mbyllur.
5. Duhet të dijë vetëm t'a montojë e t'a smontojë?
6. Jo, duhet të njohë mirë mekanizmin e mbushjes dhe të zbrazjes, të njohë mirë pjesët e saja si p.sh. kondakun, tytën, këmbëzën, shinjestrën, shulin etj.
7. Ku i bëjnë qitjet ushtarët?
8. Në poligonin e qitjeve dhe po në atë vend ushtrohen mbi mënyrat e ndryshme të të shtirit.
9. Cilat janë mënyrat e ndryshme të të shtirit?
10. Kryqëzim zjarri, shtirje për mbrojtje, shtirje e tërthortë etj.
11. Cilat janë pozicionet në të cilat shtijnë?
12. Më këmbë, në gjuhë, ulur përdhe dhe barkas.
13. Po ushtrime luftimi, a duhet të bëjnë ushtarët?
14. Po, bëjnë ushtrime në sulm, në tërheqje dhe, nga përdorimi i mortajave, mësojnë rëndësinë e një plani shtirjesh.
15. Me çfarë armësh bëjnë qitje ushtarët?
16. Në përgjithësi ushtarët bëjnë qitje me të gjitha armët: me revolver, me mitraloz, me bazukë, me pushkë granatë hudhëse, me mortaja etj.
17. Po me topa, a nuk bëjnë qitje?
18. Qitjet me topa bëhen nga ushtarët e artillerisë.

L. 94

19. Siç e shihni, pra, këtu mësoni shumë gjëra të nevojshme për të mbrojtur veten dhe vendin tuaj.
20. Po, përndryshej nga padituria e përdorimit të armëvevet dhe nga pakujdesia në luftim mund të vdesim.
21. Nesër do të flasim më gjatë mbi armët dhe vlerën e tyre në front.
22. Ju falemi nderit, Zoti Kapter.



## LEXIM E PËRKTHIM

Agimi duhet të mësojë sa më shumë që të mundet mbi armët që do të përdorë në luftë. Gjëja e parë që mëson ai është të montojë dhe të smontojë pushkën me sy mbyllur. Në të njëjtën kohë ai fillon të mësojë terma ushtarake si këto: mekanizmi i mbushjes dhe i zbrazjes, kondaku, karikator, fisheku, plumbi, shinjestra e shenja.

Duke shtënë me pushkë Agimi mëson mënyrat e ndryshme të të shtirit, si p.sh. kryqëzim zjarri, shtirje për mbrojtje, shtirje të tërthortë etj. Pastaj vete në poligonin e qitjeve. Atje ai shtie në pozicione të ndryshme: më këmbë, në gjunjë dhe barkas. Prej aty Agimi vete në një vend tjetër ku shtie nga çatitë dhe nga gropat; bën edhe ushtrime luftimi, si sulm, tërheqje etj.

Agimi ushtrohet edhe në përdorimin e bajonetës dhe të llojeve të ndryshme të bombavet të dorës. Një ushtar, që të jetë luftar i mirë, duhet të ketë njohuri mbi të tëra armët, qofshin këto vetiake ose jo. Nga përdorimi i mortajave kalibër 61 dhe 83, ai mëson se ç'rëndësi ka një plan shtirjesh, se si duhet të qëllohet një objektiv etj. Agimi vazhdon të mësojë si të shtjerë me revolver, me pushkë automatike, me mitraloz, me bazukë dhe me pushkë granatë hudhëse.

Tani, nga dituria që kanë fituar gjatë stërvitjeve, të tërë  
rekrutët e kuptojnë fare mirë se si vjen vdekja në luftim nga  
pakujdesia.

PYETJE

1. Kush duhet të mësojë mbi armët që do të përdorë në luftë?
2. Sa duhet të mësojë Agimi mbi armët që do të përdorë në luftë?
3. Ç' duhet të bëjë Agimi?
4. Ç' është gjëja e parë që nxë ai?
5. Si duhet t'a montojë dhe t'a smontojë ai pushkën?
6. Ç' duhet të bëjë ai me sy mbyllur?
7. Kur fillon të mësojë ai terma ushtarake?
8. Ç' fillon të mësojë ai në të njëjtën kohë?
9. Cilat janë termat ushtarake që mëson Agimi?
10. Çfarë termash janë mekanizmi i mbushjes dhe i zbrazjes, kondaku, karikatorit, fisheku, plumbi, shinjestra e shenja?
11. Ç' bën Agimi me termat që përmendëm më lart?
12. Ç' mëson ai duke shtënë me pushkë?
13. Si i mëson ai mënyrat e ndryshme të të shtirit?
14. Cilat janë mënyrat e ndryshme të të shtirit që mëson Agimi duke shtënë me pushkë?
15. Ç' bën Agimi duke shtënë me pushkë?
16. Ku vete ai pastaj?
17. Në cilin poligon vete ai pastaj?
18. Në çfarë pozicionesh shtie Agimi në poligonin e qitjeve?
19. Cilat janë pozicionet, në të cilat shtie një ushtar në poligonin e qitjeve?



20. Pse venë ushtarët në poligonin e qitjeve?
21. Në çfarë pozicioni shtini ju më mirë: më këmbë, në gjunjë apo barkas?
22. Ku veni ju për qitje?
23. Në çfarë vendi vete Agimi nga poligoni i qitjeve?
24. Ç'bën ai nga çatitë dhe nga gropat?
25. Kujt i pëlqen të shtjerë nga çatitë dhe kujt i pëlqen të shtjerë nga gropat?
26. Çfarë ushtrimesh tjera bën ai pastaj?
27. Çfarë ushtrimesh janë sulmi dhe tërheqja?
28. Kush mëson si të sulmojë dhe si të tërhiqet?
29. Përveç Agimit, edhe kush tjetër ushtrohet në përdorimin e bajonetës dhe të bombavet të dorës?
30. Ç'mësojnë ata të përdorin pasi të jenë ushtruar mirë?
31. Çfarë lloje bombash përdorin në ushtri?
32. Mbi sa lloje armësh duhet të ketë njohuri një ushtar?
33. Mbi çka duhet të ketë njohuri një luftar i mirë?
34. Cilat armë duhet të njohë mirë ai?
35. Që të bëhet luftar i mirë, a duhet që çdo ushtar të ketë njohuri mbi të tëra armët, qofshin këto vetiake ose jo?
36. Ç'mëson ushtari nga përdorimi i mortajave kalibër 61 e 83?
37. Cilët mësojnë nga përdorimi i mortajave se ç'rëndësi ka një plan shtirjesh?
38. Nga se mësojnë ushtarët se si duhet të qëllohet një objektiv?
39. Kush duhet të mësojë mbi rëndësinë që ka një plan shtirjesh?
40. Cilët duhet të mësojnë se si qëllohet një objektiv?

41. Ç'vazhdon të mësojë pastaj Agimi?
42. Cilët duhet të mësojnë si të shtien me revolver, me pushkë automatike, me mitraloz, me bazukë dhe me pushkë granatë hudhëse?
43. Me cilën nga këto armë dini të shtini ju më mirë, Z....?
44. Ç'kanë fituar rekrutët gjatë stërvitjeve?
45. Ç'kuptojnë të tërë rekrutët nga dituria që kanë fituar gjatë stërvitjeve?
46. Kush e kupton fare mirë edhe se si vjen vdekja nga pakujdesia?
47. Nga se mund të vijë vdekja në luftim?
48. Ç'mund të vijë në luftim nga pakujdesia?
49. Ç'mund të na ndodhë në luftim, në qoftë se nuk jemi të kujdesshëm?
50. Në ç'rast mund të na vijë vdekja në luftim?
51. Ç'armë është revolveri?
52. Cilat janë armët vetiake dhe jo vetiake që njihni ju?
53. Kush përdor armë automatike?
54. A ka topi kondak?
55. Cila pjesë e pushkës ju ndihmon për të shtënë më mirë?
56. Sa pjesë ka fisheku?
57. Sa fishekë zë një karikator revolveri?

## FJALOR

automatik, -e	(adj. m. & f.)	automatic
bajonetë, -a bajoneta, -t	(f.)	bayonet
barkas	(adv.)	in a prone position
bazukë, -a bazuka, -t	(f.)	bazooka
bombë, -a bomba, -t	(f.)	bomb
dituri, -a dituri, -të	(f.)	knowledge, wisdom
granatë, -a granata, -t	(f.)	grenade
gropë, -a gropa, -t	(f.)	hole, pit, foxhole
gju, gjuri gjunjë, -t	(m.)	knee
hudhëse, hudhësja hudhëse, -t	(f.)	thrower
kalibër, kalibri kalibra, -t	(m.)	caliber
karikator, -i karikatora, -t	(m.)	ammunition clip
këmbëz, -a këmbëza, -t	(f.)	trigger
kondak, -u kondakë, -t	(m.)	rifle stock
kryqëzim, -i kryqëzime, -t	(m.)	cross, crossing; crucifixion

luftar, -i luftarë, -t	(m.)	fighter, warrior
luftim, -i luftime, -t	(m.)	fighting, combat,
mbushje, -a mbushje, -t	(f.)	filling
mekanizëm, mekanizmi	(m.)	mechanism
për të montuar (unë montoj)	(v.)	to assemble (to piece together)
mortajë, -a mortaja, -t	(f.)	mortar
objektiv, -i objektive, -t	(m.)	objective
padituri, -a	(f.)	ignorance
pakujdesi, -a	(f.)	carelessness
plan, -i plane, -t	(m.)	plan
poligon, -i poligone, -t	(m.)	firing range
për t'u-qëlluar (unë qëllohem)	(v.)	to be hit, struck, shot
qitje, -a qitje, -t	(f.)	firing for practice
për të smontuar (unë smontoj)	(v.)	to disassemble
sulm, -i sulme, -t	(m.)	attack
shinjestër, shinjestra shinjestra, -t	(f.)	sight (of a gun)

për të shtënë (unë shtie)	(v.)	see "me shti"
të shtirë, -t	(neuter)	charge, report of a gun, shooting; putting, inserting
shtirje, -a shtirje, -t	(f.)	charge, report (of a gun); putting, inserting
shul, -i shula, -t	(m.)	bolt of a rifle, bolt
tani	(adv.)	see "tash"
termë, -a terma, -t	(f.)	term
tërheqje, -a tërheqje, -t	(f.)	withdrawal, retreat
i, e, të tërthortë të tërthorta	(adj. m. & f.)	indirect, oblique
tytë, -a tyta, -t	(f.)	gun barrel
zbrazje, -a zbrazje, -t	(f.)	discharge, discharging; vacating, evacuation
zjarr, -i zjarre, -t	(m.)	see "zjarm"

## SHËNIME

në gjunjë		in a kneeling position
poligoni i qitjeve		firing range (mil.)
për të rënë barkas (unë bie barkas)	(v.)	to hit the dirt

DETYRË SHTEPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. I'm interested to buy this property; what's its price?
2. I have a pain in my left knee.
3. The roof of my house is in a bad condition; it needs repairing but I haven't got the money to fix it.
4. When the fighting was over I had only one clip of ammunition left.
5. Could you tell me what caliber this gun (cannon) is?
6. The evacuation of the town began the same day that you left.
7. The firing range is not far from here.
8. The attack will start at 6 o'clock; if it rains it will be postponed for 24 hours.
9. Vajtëm me aeroplan se rruga u-mbyll nga shirat.
10. Hap një gropë të vogël dhe mbille aty!

Mësimi i 95-të

NË VIJËN E FRONTIT

DIALOGU





1. Ku të dërguan pasi mbarove kursin e stërvitjeve të para ushtarake?
2. Më dërguan në frontin perëndimor.
3. Ku të caktuan?
4. Në fillim më vendosën në llogore, pastaj më dërguan të hapja gropa të reja për të ndërtuar një rjetë llogoresh e fortifikatash.
5. Po tjetër, ç'bëre?
6. Përballë llogoreve vumë tela me gjëmba dhe pengesa tjera.
7. Gjatë gjitha llogoreve?
8. Jo, vetëm në ato pika nga ku dyshonim se mund të depërtonte armiku.
9. A ju linte armiku të punonit në qetësi?
10. Jo, në fillim hodhi një raketë që ndriçoi të tërë zonën ku punonim.
11. Pse vallë?
12. Për të parë se ç'po bënim, por nuk na zbuluan sepse u-shtrimë barkas menjëherë.
13. Po pastaj, a ju trazuan më?
14. Shtinë me artileri me predha të ndryshme dhe ca shrapnela.
15. Ç'bëtë ju?
16. U-fshehëm ku mundëm. Copat e predhave janë shumë të rrezikshme.
17. Sa kohë punuat aty?
18. Punuam edhe të nesërmen duke vendosur tela gjithëfarë lloji e funksioni.
19. Po mina, a vendosët?
20. Po, por minat i vendosën ushtarët e xhenios ndërsa ne hëngrëm; na kish këputur uria.

L. 95

21. Ç'hëngrët?

22. Ç'kish për të ngrënë: çorbë, mish kutie dhe peksimet.





## LEXIM E PËRKTHIM

Pasi mbaroi kursin e stërvitjeve ushtarake, Agimin e dërguan jashtë kufive të Atdheut, në një divizion që kish zënë pozicion mbrojtje në vijën e frontit. Në atë kohë që arriti Agimi, në front po zhvillohej një dyluftim artilerie. Artileria jonë po përpiquej t'a mundte artilerinë e armikut, në mënyrë që të kish superioritet zjarri.

Në fillim Agimin e dërguan në llogore, pastaj e caktuan që të hapte gropa të reja, në mënyrë që të zgjeroheshin pozicionet dhe të formohej një rjetë llogoresh e fortifikatash. Më vonë kapteri i togës i caktoi Agimit vendin ku do t'i përqëndronte shtirjet e tia kur të bëhej mbrojtja e fundit.

Po atë natë Agimin e dërguan jashtë llogoreve për vendosur tela me gjëmba; telat duhej të vendoseshin kundrejt pozicioneve të tyre, gjatë gjithë pjesës së tokës nga ku mund të afrohej armiku. Ndërsa po kryhej kjo punë, armiku hodhi një raketë për të parë se ç'po ngjante. Agimi dhe ushtarët tjerë ranë barkas menjëherë për të mos u-zbuluar. Armiku hodhi gjithashtu disa shrapnela për të kontrolluar në se zjarri i artilerisë ish përqëndruar mirë. Si Agimi ashtu edhe gjithë shokët tjerë filluan të fshiheshin që të mos vriteshin nga copat e predhave.

Të nesërmen, Agimi edhe shokët e tij, vazhduan fortifikimin e zonës së betejës, përballë së cilës kishte zënë vend njësia e tyre. Vendosën tela me gjëmba për të penguar kalimin e armikut, si dhe tela të lidhur me raketa për të fortifikuar pozicionet e tyre sa më shumë që të ish e mundur.

Atë mbrëmje, së bashku me ca ushtarë të xhenios, Agimin e dërguan që të vendoste mina antitank dhe mina kundër njerëzve në zonën ku armiku mund të depërtonte dhe t'u afrohej pozicionevet të tyre. Pasi e kryen edhe këtë detyrë ata u-kthyen tamam në kohë për të ngrënë një gjellë të ngrohët. Gjella e ngrohët është shumë e shijshme pas një natë pune. Agimi pati rast gjithashtu t'i shkruante familjes, por natyrisht në letrën e tij nuk përmendi asgjë mbi punët që po kryheshin, sepse këtë gjë e ndalon rreptësisht censura ushtarake.

**PYETJE**

1. Ç'kurs mbaroi Agimi?
2. Kur e dërguan atë jashtë kufive të atdheut?
3. Jashtë çfarë kufish e dërguan Agimin?
4. Në ç'divizion e caktuan?
5. Cili divizion kish zënë pozicion në vijën e frontit?
6. Çfarë pozicioni kish marrë ai divizion në vijën e frontit?
7. Çfarë dyluftimi po zhvillohej në atë kohë kur arriti Agimi?
8. Kur po zhvillohej në front një dyluftim artilerie?
9. Cila artileri po përpiquej t'a mundte artilerinë e armikut?
10. Ç'po përpiquej të bënte artileria jonë?
11. Çfarë superioriteti donte të kish artileria jonë?
12. Në ç'mënyrë po përpiquej artileria jonë t'a mundte artilerinë e armikut?
13. Kur e dërguan Agimin në llogore?
14. Në ç'vend e dërguan atë në fillim?
15. Çfarë gropash e caktuan të hapte pastaj?
16. Ç'e caktuan të bënte pastaj?
17. Pse e caktuan Agimin bashkë me shokët e tij të hapte gropa?
18. Ç'duheshin zgjeruar?
19. Ç'u duhej bërë pozicioneve?
20. Çfarë rjete duhej formuar?
21. Kur i a caktoi kapteri i togës vendin Agimit ku të përqëndronte shtirjet e tia?

22. Ç'i caktoi Agimit kapteri i togës?
23. Kur do t'i përqëndronte Agimi shtirjet e tia në vendin që i caktoi kapteri i togës?
24. Kur e dërguan Agimin jashtë llogoreve për të vendosur tela me gjëmbe?
25. Pse e dërguan Agimin jashtë llogoreve?
26. Kundrejt cilave pozicione duhej të vendoseshin telat?
27. Ç'duhej bërë kundrejt pozicioneve të tyre?
28. Gjatë çfarë pjese të tokës duhej të vendoseshin telat me gjëmbe?
29. Ku mund të afrohej armiku?
30. Kush hodhi një raketë ndërsa po kryhej kjo punë?
31. Pse hodhi armiku një raketë?
32. Ç'ndodhi ndërsa po kryhej kjo punë?
33. Si ra Agimi dhe ushtarët tjerë?
34. Kur ranë ata barkas?
35. Pse ranë ata menjëherë barkas?
36. Ç'do t'u ndodhte atyre po të mos binin barkas?
37. Cilët u-shtrinë barkas për të mos u-diktuar?
38. Pse hodhi armiku disa shrapnela?
39. Ç'bëri armiku për të kontrolluar në se zjarri i artilerisë së tij ish përqëndruar mirë?
40. Cilët filluan të fshiheshin që të mos vriteshin nga copat e predhave?
41. Ç'filluan të bënë si Agimi ashtu edhe shokët tjerë?

42. Pse filluan të fshiheshin ata?
43. Nga se filluan të fshiheshin?
44. Ç'vazhduan të nesërmen Agimi dhe shokët e tij?
45. Cilët e vazhduan të nesërmen fortifikimin e fushës së betejës?
46. Përballë cilës zonë kish zënë vend njësia e tyre?
47. Ku kish zënë vend njësia e Agimit?
48. Cilët vendosën tela me gjëmba dhe tela të lidhur me raketa në zonën e fortifikimeve?
49. Ç'bëri Agimi me shokët e tij në atë zonë?
50. Çfarë telash vendosën ata në zonën e fortifikimeve?
51. Pse i vendosën ata telat me gjëmba dhe telat e lidhur me raketa?
52. Si do t'i fortifikonin ata pozicionet e tyre?
53. Ç'duhej të bënin ata sa më shumë që të ish e mundur?
54. Me kë e dërguan Agimin që të vendoste mina antitank dhe mina kundër njerëzve?
55. Kur e dërguan Agimin të vendoste mina antitank dhe mina kundër njerëzve?
56. Ç'e dërguan të bënte Agimin së bashku me ca ushtarë të xhenios?
57. Çfarë minash e dërguan të vendosnin Agimin me shokët e tij?
58. Ku vendosën ata mina antitank dhe mina kundër njerëzve?
59. Kush mund të depërtonte në atë zonë dhe t'u afrohej pozicioneve të tyre?
60. Ç'mund të bënte armiku në atë zonë?

61. Në ç'kohë u-kthyen ata për të ngrënë një gjellë të ngrohët?
62. Ç'bënë ata pasi e kryen edhe këtë detyrë?
63. Si është një gjellë e ngrohët pas një natë pune?
64. Ç'është shumë e shijshme pas një natë pune?
65. Kujt pati rast t'i shkruante Agimi?
66. Mbi cilat punë nuk përmendi asgjë Agimi?
67. Pse nuk përmendi Agimi asgjë, në letrën e tij, mbi punët që po kryheshin në front?
68. Në çka nuk përmendi Agimi asgjë mbi punët që po kryheshin?
69. Çka ndalon rreptësisht censura ushtarake?
70. Cila censurë i ndalon ushtarët rreptësisht të përmendin diçka mbi punët që kryejnë?
71. A mund të depërtoni nëpër telat me gjëmba pa përdorur asnjë mjet?
72. Pse hudhen raketat në zonën e betejës?
73. Ç'mjet përdorni ju për të zënë peshk?
74. A mendoni se ka censurë edhe për letrat private në Shqipëri?

## FJALOR

antitanks	(adj. & m.)	antitank
censurë, -a	(f.)	ensorship
çorbë, -a çorba, -t	(f.)	soup
për të depërtuar (unë depërtoj)	(v.)	to penetrate
divizion, -i divizione, -t	(m.)	division
dyluftim, -i dyluftime, -t	(m.)	duel
fortifikatë, -a fortifikata, -t	(f.)	fortification
fortifikim, -i fortifikime, -t	(m.)	fortifying, fortification
për të fortifikuar (unë fortifikoj)	(v.)	to fortify
funksion, -i funksione, -t	(m.)	function
gjëmb, -i gjëmbe, -t	(m.)	barb; thorn; fish bone
për t'u-kryer (kryhet)	(v.)	to be finished, accomplished
kundrejt	(prep.)	opposite, towards(s)
llogore, llogorja llogore, -t	(f.)	trench
për të ndaluar (unë ndaloj)	(v.)	to stop; to prohibit, ban, forbid



për të ndriçuar (unë ndriçoj)	(v.)	to illuminate; to clarify
peksimet, -i peksimete, -t	(m.)	hardtack
për të përqëndruar (unë përqëndroj)	(v.)	to concentrate
për t'u-përqëndruar (unë përqëndrohem)	(v.)	to be concentrated, to concentrate oneself
predhë, -a predha, -t	(f.)	bullet, shell (of any weapon)
raketë, -a raketa, -t	(f.)	flare, rocket
rreptësisht	(adv.)	strictly, rigorously; severely
superioritet, -i	(m.)	superiority
shrapnel, -i shrapnela, -t	(m.)	shrapnel
tel, -i tela, -t	(m.)	wire
për t'u-vendosur (unë vendosem)	(v.)	to be decided, determined; to be settled, to settle oneself; to be placed
për të zbuluar (unë zbuloj)	(v.)	to discover, reveal, disclose; to uncover
për t'u-zbuluar (unë zbulohem)	(v.)	to be discovered, revealed, disclosed; to be uncovered, to uncover oneself

për t'u-zgjeruar  
(unë zgjerohem)

(v.)

to be widened,  
expanded

### SHËNIME

na kish këputur uria

we were starved

tel me gjëmba

barbed wire

### DETYRË SHTRËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. It's strictly forbidden to go (to pass) through this road.
2. They are going to illuminate the town for Christmas.
3. The enemy has fortified the trenches and it seems that he is going to resist.
4. I can hardly wait to have a hot meal.
5. If you hear any noise hit the dirt right away.
6. Drita depërtonte me vështirësi nëpër xhamet e ndyrë.
7. A mund të zgjërohet kjo xhaketë?
8. S'kisha njohuri mbi këtë çështje.
9. Merre, por m'a kthe menjëherë.
10. Ngreje me kujdes se mund të të bjerë e mund t'a thyesh.

Mësimi i 96-të






ZMBRAPJA E NJË SULMI TË ARMIKUT

DIALOGU

1. Më tregove se kur vajte në front njësia jote kish marrë pozicion mbrojtje.
2. Po, dhe dy ditët e para i kaluam duke rregulluar fortifikatat.
3. Kur ju sulmoi armiku?
4. Më parë dërgoi një togë këndeje lumit, e cila bëri një sulm frontal.
5. Pse vallë dërgoi vetëm një togë?
6. Për të parë pozicionet tona dhe për të marrë vesh se çfarë qëndrese mund të bënim ne.
7. A pati sukses ky sulm?
8. Jo, aspak. Së pari armiku takoi në mina; së dyti zjarri ynë i kombinuar i të gjitha armëve e zbrapi sulmin krejtësisht.
9. Ndërhyri artileria juaj?
10. Në fillim jo, sepse armiku ish tepër afër fortifikatave tona.
11. Kur ndërhyri artileria?
12. Kur ushtarët armiq u-larguan prapa bregoreve ku shtirjet tona të rrafshita nuk u bënëin gjë.
13. Ç'masa mbrojtëse vazhdoi të mirrte divizioni pas këtij sulmi?
14. Komanda e divizionit vendosi një pararojë të përgjithshme, i caktoi zonat e përgjegjësisë secilës njësi dhe pikat se ku do t'a përqëndronin zjarrin.
15. Kush i a jep artilerisë udhëzimet e nevojshme për të bërë shtirje me përfundime të mira?
16. Larg vijës së frontit gjendet një vëzhgues që vështron natë e ditë pozicionet e armikut dhe quhet vëzhguesi që rri përpara.
17. A ka vëzhguesi kontakt drejt për drejt me artilerinë?
18. Jo drejt për drejt.

L. 96

19. Po qysh, atëhere?
20. Ky bën një raport dhe i a kalon komandës....
21. Cilës komandë?
22. Komandës që koordinon shtirjet për të tërë frontin.



## LEXIM E PËRKTHIM

Me qëllim që të zbulonte pozicionet tona, armiku dërgoi këndeje lumit një togë, e cila bëri një sulm frontal kundër forcave tona. Minat kundër njerëzve, që ishin vendosur natën përpara, i shkaktuan armikut humbje të konsiderueshme; por me gjithë atë armiku vazhdoi të sulmonte dhe të priste telat që ishin vënë si pengesë përpara vijës së frontit. Shtirjet tona të kombinuara, të pushkëve, të mitralozave dhe të artilerisë e zbrapën këtë sulm dhe i shkaktuan togës humbje të mëdha në njerëz. Artileria jonë, me shtirje të shpeshta, i dhjetoi edhe më tepër ushtarët armiq që po tërhiqeshin nëpër ato vende, ku nuk i kapnin shtirjet e rrafshita të armëve tona.

Pasi armiku bëri këtë sulm, komanda e divizionit tonë urdhëroi që të vendosej në zonën e frontit një pararojë e përgjithshme. Komanda e divizionit tonë i caktoi gjithashtu edhe zonat e përgjegjësisë secilës njësi të divizionit, në mënyrë që një sulm tjetër të mos i gjente ca zona të mbrojtura më pak e ca më shumë.

Agimi u-caktua në pozicionet e përgjithshme të mbrojtjes dhe ndihmoi në organizimin e tyre. U-caktuan gjithashtu edhe pikat e drejtimet, në të cilat duhej të shtinin mitralozat dhe mortajat.

Nga raporti i vëzhguesit të artilerisë që rri përpara, komanda që koordinon shtirjet për të tërë frontin, njoftoi me telefon një plan shtirjesh, në të cilin ishin përcaktuar të tëra shtirjet e armëve të ndryshme për fazën e fundit të mbrojtjes.

Pasi mbaroi organizimi i vijës kryesore të zjarrit, Agimi u-dërgua që të ndihmonte në organizimin e pozicioneve të dyta të mbrojtjes. Në këtë rast, batalioni, në të cilin bënte pjesë Agimi, u-organizua në mënyrë që të ish i mbrojtur nga të tëra anët.

PYETJE

1. Kush dërgoi një togë këndeje lumit?
2. Pse dërgoi armiku një togë këndeje lumit?
3. Me qëllim që të zbulonte cilat pozicione armiku dërgoi një togë këndeje lumit?
4. Kundër cilave forca bëri një sulm frontal kjo togë?
5. Çfarë sulmi bëri kjo togë kundër forcave tona?
6. Me çfarë sulmi i sulmoi toga e armikut forcat tona?
7. Cilat mina i shkaktuan armikut humbje të konsiderueshme?
8. Kur ishin vendosur këto mina?
9. Çfarë humbjesh i shkaktuan armikut minat kundër njerëzve?
10. Por, me gjithë atë, kush vazhdoi të sulmonte dhe të priste telat?
11. Ç'vazhdoi të bënte armiku?
12. Pse ishin vënë telat përpara vijës së frontit?
13. Përpara cilës vijë ishin vënë telat si pengesë?
14. Cilin sulm zbrapën shtirjet tona të kombinuara të pushkëve, të mitralozave dhe të artilerisë?
15. Çka zbrapën shtirjet tona të kombinuara të pushkëve, të mitralozave dhe të artilerisë?
16. Çfarë shtirjesh i shkaktuan togës së armikut humbje të mëdha në njerëz?
17. Cilët dhjetoi artileria jonë me shtirje të shpeshta?
18. Me çfarë shtirjesh i dhjetoi artileria jonë ushtarët armiq?
19. Ku po tërhiqeshin ushtarët armiq kur u-dhjetuan nga artileria jonë?



20. Cilët u-tërhoqën nëpër ato vende ku nuk i kapnin shtirjet e rrafshita?
21. Në ç'vende i dhjetoi artileria jonë ushtarët armiq?
22. Ku vuri komanda jonë një pararojë të përgjithshme?
23. Ç'urdhëroi komanda e divizionit të vendosnin në zonën e frontit?
24. Kur urdhëroi komanda e divizionit tonë që të vendosej në zonën e frontit një pararojë e përgjithshme?
25. Çfarë pararoje urdhëroi komanda e divizionit tonë që të vendosej në zonën e frontit?
26. Cila komandë i caktoi gjithashtu edhe zonat e përgjegjesisë secilës njësi të divizionit?
27. Ç'caktoi gjithashtu komanda e divizionit tonë?
28. Kujt i a caktoi komanda e divizionit zonat e përgjegjesisë?
29. Në ç'mënyrë i a caktoi komanda e divizionit zonat e përgjegjesisë secilës njësi?
30. Ç'duhej të mos ngjante një herë tjetër?
31. Në ç'rast nuk duhet të gjenden ca zona të mbrojtura më pak dhe ca më shumë?
32. Si duhej të gjendeshin të mbrojtura zonat në një sulm tjetër?
33. Në çfarë pozicionesh u-caktua Agimi pastaj?
34. Ç'ndihmoi ai?
35. Ku u-caktua dhe ç'ndihmoi Agimi?
36. Edhe cilat pika e drejtime u-caktuan nga komanda e divizionit?
37. Nga duhej të shtinin mitralozat dhe mortajat?
38. Ç'duhej të bënin mitralozat dhe mortajat në pikat dhe drejtimet që u-caktuan?

39. Cila komandë njoftoi me telefon një plan shtirjesh?
40. Si e njoftoi komanda planin e shtirjeve?
41. Nga raporti i cilit vëzhgues e njoftoi komanda planin e shtirjeve?
42. Ç'dha vëzhguesi i artilerisë që rri përpara?
43. Ç'koordinon komanda që dha me telefon planin e shtirjeve?
44. Ç'ish përcaktua në atë plan?
45. Shtirjet e cilave armë ishin përcaktuar në atë plan?
46. Për cilën fazë ishin përcaktuar të tëra shtirjet e armëve të ndryshme?
47. Ku ishin përcaktuar të tëra shtirjet e armëve të ndryshme?
48. Organizimi i cilës vijë mbaroi?
49. Ku u-dërgua Agimi pasi mbaroi organizimi i vijës kryesore të zjarrit?
50. Në ç'organizim do të ndihmonte ai, pasi mbaroi organizimi i vijës kryesore të zjarrit?
51. Ç'do të bënte Agimi në organizimin e pozicioneve të dyta të mbrojtjes?
52. Në këtë rast, në ç'mënyrë u-organizua batalioni, në të cilin bënte pjesë Agimi?
53. Nga cila anë duhej të ish i mbrojtur batalioni i Agimit?
54. Cili batalion duhej të ish i mbrojtur nga të tëra anët?

## FJALOR

bregore, bregorja bregore, -t	(f.)	a small hill
për të dhjetuar (unë dhjetoj)	(v.)	to decimate; to tithe
fazë, -a faza, -t	(f.)	phase
frontal, -e	(adj. m. & f.)	frontal
humbje, -a humbje, -t	(f.)	loss; casualty
këndej	(adv. & prep.)	on this side, this side of....
i, e, të kombinuar të kombinuara	(adj. m. & f.)	combined
i, të konsiderueshëm e, të konsiderueshme	(adj. m. & f.)	considerable
kontakt, -i kontakte, -t	(m.)	contact, touch
për të koordinuar (unë koordinoj)	(v.)	to co-ordinate
krejtësisht	(adv.)	entirely, totally, completely
mbrojtës, -e	(adj. m. & f.)	defensive
i, e, të mbrojtur të mbrojtura	(adj. m. & f.)	protected, defended
për të ndërhyrë (unë ndërhyj)	(v.)	to intervene, interfere
për t'u-organizuar (unë organizohem)	(v.)	to be organized

pararojë, -a pararoja, -t	(f.)	outpost, vanguard
për t'u-përcaktuar (përcaktohet)	(v.)	to be defined
përfundim, -i përfundime, -t	(m.)	result; conclusion
qëndresë, -a	(f.)	resistance
i, e, të rrafshhtë të rrafshta	(adj. m. & f.)	level, flat
sukses, -i suksese, -t	(m.)	success
për të vështruar (unë vështroj)	(v.)	to look, look out, look after
vëzhgues, -i vëzhgues, -it	(m.)	observer, reconnoiterer
zmbrapje, -e zmbrapje, -t	(f.)	withdrawal, retreat, repulsion, repelling
për të zmbrapur (unë zmbrap)	(v.)	to repel, to drive back

## SHËNIME

për të marrë masa	(v.)	to take steps
vëzhguesi që rri përpara		forward observer

## DETYRË SHTEPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. The enemy withdrew after having suffered heavy casualties.
2. I told him not to interfere in our business.
3. He is well-protected, don't worry!
4. I hope I'll finish this job on time even though there are a lot of handicaps.
5. This is a flat country and I like it because walking here doesn't tire me.
6. He has caused him considerable damage.
7. They have widened this street recently.
8. The battle lasted about five hours and both sides suffered heavy casualties.
9. Mitralozat dhe pushkët, me zjarr të kombinuar, i dhjetuan ushtarët armiq.
10. Armiku u-tërhoq duke lënë shumë të vdekur përballë fortifikatave tona.



Mësimi i 97-të

AKSION VËZHGIMI





DIALOGU

1. Më trego një gjë Agim, ç'detyrë ka një patrullë zakonisht?
2. Mvaret nga misioni që duhet të kryejë; zakonisht vëzhgon pozicionet e armikut dhe mbledh informata.
3. Po ti, ke dalur ndonjëherë patrullë?
4. Po, ca herë kam dalur vullnetarisht e ca herë tjera më kanë caktuar prorët.
5. Kush e formon patrullën?
6. Komandanti i kompanisë; ai zakonisht cakton edhe kryetarin e patrullës.
7. Ç'gradë ka kryetari?
8. Zakonisht është një nënoficer me eksperiencë.
9. Ç'bën komandanti i kompanisë pasi formon patrullën?
10. Me anën e koordinatave cakton zonën dhe vendin në hartë ku duhet të shkojë patrulla dhe i thotë nënoficerit ç'informata do që të mbledhë.
11. A janë prezent pjesëtarët e patrullës?
12. Jo, s'është nevoja që të jenë aty; ata i udhëzon kryetari i patrullës.
13. Po pastaj, ç'ngjan?
14. Pastaj në orën e caktuar patrulla del nga vija e frontit dhe ndjek një rrugë ku armiku nuk e sheh.
15. Ç'bën patrulla kur arrin në vendin e caktuar?
16. Ushtarët zënë një vend ku nuk shihen, po prej nga ata shohin mirë. Kryetari nxjerr dylbitë dhe me to shikon përreth.
17. Ç'i intereson të shohë?
18. Pozicionet e armikut, lëvizjet e tia, në se ka ndonjë kolonë dhe nga drejtohet....
19. Vetëm këto?
20. Jo. Mundohet edhe të zbulojë pozicionet e armëvet të rënda....

L. 97

21. Mund t'i mbajë mend të tëra me përpikni?
22. S'ka nevojë t'i mbajë mend; ai mba shënime dhe bën një skicë mbi pozicionet e armikut.
23. Kujt i a raporton të gjitha këto?
24. Komandantit të kompanisë dhe ky i a dërgon komandës së divizionit.





## LEXIM E PËRKTHIM

Komandantit të kompanisë së Agimit, sipas urdhërit që kish marrë, i u-desh të dërgonte matanë lumit një patrullë për të vëzhguar pozicionet e armikut dhe për të mbledhur elementet kryesore të informatave. Komandanti i kompanisë formoi një patrullë dhe udhëzoi kryetarin e saj me ndihmën e koordinatave në hartën e operacioneve që gjendej në komandën e zonës. Ai i tregoi me saktësi vendin se ku duhej të shkonte patrulla dhe ç'informata duhej të sillte. Pastaj, kryetari i patrullës, njeri me eksperiencë, udhëzoi pjesëtarët e patrullës dhe u kontrollloi rrobat dhe pajimet, për të qenë i sigurtë se gjatë misionit të tyre asgjë nuk do të shkaktonte zhurmë. Ai caktoi gjithashtu një vend ku duhej të mblidheshin në rast se patrullës do t'i duhej të shpërndahej andej e këndeje, dhe u tregoi drejtimin që duhej të ndiqnin për t'u-kthyer në bazë.

Edhe Agimi u-caktua në patrullë. Pak para se të agonte, patrulla, e udhëhequr nga kryetari, kaloi pengesat e ndryshme dhe telat me gjëmba që ishin vendosur përballë pozicioneve të tyre. Patrulla kaloi nëpër një rrugë përmes greminash e pyjesh për të mos rënë në kontakt me armikun.

Kur u-gdhi, ata ishin të fshehur në një vend, thellë brenda vijave të armikut. Kryetari i patrullës vendosi, pak larg nga

patrulla, ca vëzhgues, që të mos gjendeshin befasisht përballë armikut, dhe për të qenë të lajmëruar në rast rreziku.

Kryetari i patrullës shikonte me dylbi lëvizjet dhe pozicionet e armikut. Ai pa një kolonë tankesh dhe automjetesh duke u-drejtuar nga vija e frontit. Pastaj pa fortifikata të përgatitura mirë dhe në gjendje të përballonin një sulm. Gjithashtu pa llogore dhe armë të mbuluara me degë pemësh, të radhitura për mbrojtje.

Kryetari i patrullës bëri një skicë duke shënuar të tëra gjërat që vëzhgoi dhe pastaj dha urdhër që patrulla të kthehej nga kish ardhur.

Kur arriti në bazë, kryetari i patrullës i a raportoi gjendjen komandantit të kompanisë. Këto informata u-dërguan në batalion dhe pastaj në komandën e divizionit. Në bazë të këtyre informatave dhe të informatave tjera të mbledhura nga burime të ndryshme, komandanti i divizionit mund të marrë vendime me rëndësi.

PYETJE

1. Cilit komandant i u-desh të dërgonte një patrullë matanë lumit?
2. Ç'i u-desh të bënte komandantit të kompanisë së Agimit?
3. Sipas cilit urdhër i u-desh atij të dërgonte një patrullë matanë lumit?
4. Ku duhej t'a dërgonte komandanti i kompanisë së Agimit patrullën?
5. Ç'duhej të dërgonte ai matanë lumit?
6. Çfarë pozicionesh do të vëzhgonte patrulla?
7. Ç'do të bënte patrulla?
8. Çfarë informatash do të mblidhte ajo?
9. Cilat ishin dy arsyt, për të cilat u-dërgua patrulla matanë lumit?
10. Kush formoi një patrullë dhe kush e udhëzoi atë?
11. Ç'bëri komandanti i kompanisë?
12. Në çfarë mënyre e udhëzoi komandanti i kompanisë kryetarin e patrullës?
13. Ç'bëri komandanti i kompanisë me ndihmën e koordinatave?
14. Në çka ishin koordinatat?
15. Ku gjendej harta e operacioneve?
16. Ç'gjendej në komandën e zonës?
17. Kush i tregoi kryetarit të patrullës me saktësi vendin se ku duhej të shkonte patrulla?
18. Kujt i a tregoi komandanti i kompanisë me saktësi vendin se ku do të shkonte patrulla?

19. Ç'tregoi komandanti i kompanisë me saktësi?
20. Çka do të sillte kryetari i patrullës?
21. Kush ish njeri me eksperiencë?
22. Ç'njeri ish kryetari i patrullës?
23. Kush i udhëzoi pjesëtarët e patrullës?
24. Ç'u bëri kryetari i patrullës pjesëtarëve të patrullës pasi i udhëzoi?
25. Pse u a kontrollloi ai rrobot e pajimet pjesëtarëve të patrullës?
26. Ç'mund të ngjante po të shkaktonte zhurmë ndonjeri nga pjesëtarët e patrullës?
27. Në ç'mënyrë duhej kryer ky mision?
28. Kush u caktoi pjesëtarëve të patrullës gjithashtu edhe vendin se ku duhej të mblidheshin?
29. Në ç'rast duhej të mblidheshin pjesëtarët e patrullës?
30. Ç'duhej të bënin pjesëtarët e patrullës po të shpërndareshin andej e këndeje?
31. Çfarë drejtimi u tregoi ai pjesëtarëve të patrullës?
32. Ç'duhej të ndiqnin pjesëtarët e patrullës për t'u-kthyer në bazë?
33. Edhe kush u-caktua në patrullë?
34. Nga kush ish e udhëhequr patrulla?
35. Kur i kaloi patrulla pengesat e ndryshme dhe telat me gjëmba?
36. Ç'kaloi patrulla pak para se të agonte?
37. Ç'ish vendosur përballë pozicioneve të tyre?
38. Nëpër çfarë rruge kaloi patrulla?

39. Pse kaloi patrulla përmes greminash e pyjesh?
40. Për të mos rënë në kontakt me kë kaloi patrulla nëpër një rrugë përmes greminash e pyjesh?
41. Ku ishin të fshehur ata kur u-gdhi?
42. Brenda çfarë vijash ishin të fshehur ata kur u-gdhi?
43. Ç'vendosi kryetari i patrullës pak larg nga patrulla?
44. Pse vendosi ai ca vëzhgues pak larg nga patrulla?
45. Ç'do të bënte patrulla në rast rreziku?
46. Kë do të lajmëronin vëzhguesit në rast rreziku?
47. Kush nuk duhej të gjendej befasisht përballë armikut?
48. Me çfarë mjeti i shikonte kryetari i patrullës lëvizjet dhe pozicionet e armikut?
49. Ç'shikonte ai me dylbi?
50. Kush pa një kolonë tankesh dhe automjetesh duke u-drejtuar nga vija e frontit?
51. Ç'pa kryetari i patrullës me dylbi?
52. Nga po drejtohej kolona e tankeve dhe e automjeteve që pa kryetari i patrullës?
53. Çfarë fortifikatash pa pastaj kryetari i patrullës?
54. Si ishin fortifikatat që pa kryetari i patrullës?
55. Ç'ishin në gjendje të përballonin fortifikatat që pa kryetari i patrullës?
56. Cilat mund të përballonin një sulm?
57. Me çka ishin të mbuluara llogoret dhe armët që pa ai?
58. Ç'ishin të mbuluara me degë pemësh?
59. Si ishin të radhitura llogoret dhe armët e mbuluara me degë pemësh?

60. Ç'bëri kryetari i patrullës?
61. Ç'shënoi ai në atë skicë?
62. Kush bëri një skicë duke shënuar të tëra gjërat që vëzhgoi?
63. Kur dha urdhër ai që patrulla të kthehej nga kish ardhur?
64. Ç'urdhër dha pastaj kryetari i patrullës?
65. Nga do të kthehej patrulla?
67. Kur i a raportoi kryetari i patrullës gjendjen komandantit të kompanisë?
68. Ç'i raportoi ai komandantit të kompanisë pasi arriti në bazë?
69. Ç'bëri kryetari i patrullës pasi u-kthye dhe arriti në bazë?
70. Kujt i a raportoi ai gjendjen?
71. Ku u-dërguan këto informata?
72. Ç'u-dërgua në batalion?
73. Ç'u-dërgua nga batalioni në komandën e divizionit?
74. Informatat e kujt u-dërguan një herë në batalion dhe pastaj në komandën e divizionit?
75. Cili komandant mund të marrë vendime me rëndësi në bazë të këtyre informatave?
76. Çfarë vendimesh mund të marrë komandanti i divizionit në bazë të informatave të mbledhura nga burime të ndryshme?
77. Nga çfarë burimesh janë mbledhur informatat, në bazë të të cilave komandanti i divizionit mund të marrë vendime me rëndësi?
78. Kush nuk mund të marrë asnjë vendim pa këto informata?

## FJALOR

për të aguar (agon)	(v.)	to dawn
aksion, -i aksione, -t	(m.)	action; share, stock
automjet, -i automjete, -t	(m.)	vehicle
befasisht	(adv.)	unexpectedly, suddenly
brenda	(adv. & prep.)	inside, in; within
dylbi, -të	(f.)	binoculars
eksperiencë, -a	(f.)	experience
element, -i elemente, -t	(m.)	element
epror, -i eprorë, -t	(m.)	superior (boss)
i, e, të fshehur të fshehura	(adj. m. & f.)	hidden, concealed
për t'u-gdhirë (gdhihet)	(v.)	to dawn
për të interesuar (më, të, i etj. intereson)	(v.)	to interest
kolonë, -a kolona, -t	(f.)	convoy, column
koordinata, -t	(f.)	co-ordinates
i, e, të lajmëruar të lajmëruara	(adj. m. & f.)	notified, warned
matanë	(adv. & pre.)	on the other side, beyond



për të ndjekur (unë ndjek)	(v.)	to follow; chase, pursue; to attend (school)
operacion, -i operacione, -t	(m.)	operation
patrullë, -a patrulla, -t	(f.)	patrol
përmes	(prep.)	through
përpikni, -a	(f.)	exactness, precision
pjesëtar, -i pjesëtarë, -t	(m.)	member, partner
i, e, të përgatitur të përgatitura	(adj. m. & f.)	prepared
prezent	(adj.)	present
i, e, të radhitur të radhitura	(adj. m. & f.)	lined up
për të raportue (unë raportoj)	(v.)	to report
saktësi, -a	(f.)	accuracy, exactness precision
skicë, -a skica, -t	(f.)	sketch
për t'u-shpërndarë (shpërndahet)	(v.)	see "me u-shpërdá"
tank, -u tanke, -t	(m.)	tank (mil.)
i, e, të udhëhequr të udhëhequra	(adj. m. & f.)	guided, led
për të udhëzuar (unë udhëzoj)	(v.)	to instruct; brief; direct

L. 97

vëzhgim, -i (m.) observation,  
vëzhgime, -t reconnaissance

për të vëzhguar (v.) to observe, to  
(unë vëzhgoj) reconnoiter

#### SHËNIME

me anë të.... by means of,  
me anën e.... through

për të rënë në kontakt (v.) to get in touch,  
(unë bie në kontakt) to contact

#### DETYRË SHTËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. The A.B.C. Company sold many shares last year.
2. The policemen found him hidden in the forest.
3. He wasn't prepared for that type of mission.
4. Call the names to find out who is present and who is absent.
5. These binoculars are very good but expensive; I can't afford to buy them.
6. We were guided by a man who knew the area well.
7. He instructed the soldiers what to do in case of a bombardment.
8. Vëzhguesi raportoi me saktësi pozicionin e topave, numrin e divizioneve etj.
9. Kryetari i patrullës humbi rrugën dhe u-kthye me shumë vonesë.
10. Komandanti i kompanisë e kish humbur shpresën se do t'a shihte të gjallë përsëri.

Mësimi i 98-të







BOMBARDIM PËRQËNDRIME TRUPASH

DIALOGU

1. Sot do të më flasësh pak mbi rëndësinë e aviacionit. A ke njohuri mbi këtë çështje?
2. Kam njohuri? Pilotët na kanë shpëtuar jetën sa herë, si të mos kem njohuri!
3. Sa larg frontit gjendet aeroporti?
4. Zakonisht aq larg sa të mos qëllohet nga artileria e armikut.
5. Çfarë aeroplanash ka tani në front?
6. Dymotorsha, tremotorsha dhe katërmotorsha për bombardime dhe aeroplana me një motor për vëzhgim.
7. Me se janë të armatosur aeroplanat?
8. Janë të pajisur me mitraloza dhe shumë prej tyre edhe me topa e raketa.
9. Ke ndjekur ndonjë kurs pilotazhi?
10. Jo, por do të doja mjaft; më pëlqen shumë të hypi në aeroplan.
11. Tani kurset e pilotazhit janë shumë të vështira sepse tani avionat reaktivë bëjnë më se 1000 km. n'orë.
12. Do të më pëlqente të pilotoja një reaktiv vëzhgues për të marrë fotografi.
13. Kjo është ëndra e shumë djemve të ri, të venë shlemofonin, të veshin parashutën dhe të çajnë hapsirën.
14. Po, po, por kur pilotët janë me mision bombardimi ose vëzhgimi në zonat e armikut....
15. Natyrisht ai nuk është më dëfrim....
16. Dhe mbrojtja kundërajrore nuk bën shaka.
17. Po t'a qëllojë armiku avionin në bisht ose në fletë, piloti mund të hudhet me parashutë.
18. Po, pa tjetër, po ku bie? Ndofta bie në zonën e armikut.

L. 98

19. Nganjëherë mund të qëllojë që parashuta të mos hapet.
20. O! Po të fillojmë të mendojmë ashtu askush nuk do të hynte në aviacion.
21. Ke të drejtë.



## LEXIM E PËRKTHIM

Pasi arritën në komandën eprorë informatat e mbledhura nga kompania e Agimit, aviona vëzhgues u-dërguan në zonën e armikut. Aeroplanat vëzhgues panë se një kolonë e armikut po shkonte drejt vijës së frontit. Vëzhguesit lajmëruan me radio komandën e tyre në aeroport, duke dhënë me hollësi të tëra informatat e nevojshme: vendin e saktë ku ishin përqëndruar trupat, ç'kolonë ish, ku drejtohej, në se dallohej mirë etj.

Një kolonel i aviacionit, pasi shënoi mbi një hartë të tëra informatat që i dhanë vëzhguesit, i raportoi gjendjen komandantit të përgjithshëm të aviacionit në atë zonë. Ky thirri në zyrën e tij pilotët dhe u dha udhëzimet e duhura për të shkatërruar këtë përqëndrim trupash.

Bombardues të lehtë filluan të ngriheshin në ajr nga aerodromi. Në pak minuta ata arritën mbi objektivin e caktuar, ku filluan të bombardonin dhe të mitralonin. Një shumicë tankesh u-shkatërruan nga bombat e shumta e të shpeshta. Ca tanke që i shpëtuan vrullit të parë u-organizuan në grupe dhe filluan të shtinin me topa e mitraloza kundërajrorë. Bombarduesit tonë lëshuan ca raketa dhe shkatërruan shumë tanke, por mjerisht dy nga aeroplanat tonë u-nxorën jashtë luftimi. Dy nga aeroplanat u-rrëzuan, por piloti i njerit shpëtoi duke u-hudhur me parashutë

brenda vijave tona. Pastaj artileria jonë filloi një bombardim të vazhdueshëm në mënyrë që armiku të mos mundte të përqëndronte trupa dhe të vihej në pamundësi t'a përdorte atë zonë për aksione ushtarake.

PYETJE

1. Ç'arriti në komandën eprorë?
2. Informatat e cilës patrullë arritën në komandën eprorë?
3. Ku arritën informatat e mbledhura nga kompania e Agimit?
4. Ç'u-dërgua në zonën e armikut pasi arritën në komandën eprorë informatat e mbledhura nga kompania e Agimit?
5. Ku u-dërguan aviona vëzhgues?
6. Ç'panë aeroplanat vëzhgues?
7. Drejt cilës vijë po shkonte një kolonë e armikut?
8. Një kolonë e kujt po shkonte drejt vijës së armikut?
9. Me çfarë mjeti e lajmëruan vëzhguesit komandën e tyre në aeroport?
10. Ç'lajmëruan vëzhguesit?
11. Kë lajmëruan ata me hollësi?
12. Ç'gjëra dhanë me hollësi ata?
13. Kush e dha vendin e saktë ku ishin përqëndruar trupat?
14. Çfarë informatash tjera dhanë vëzhguesit?
15. Kujt i dhanë ata vendin e saktë ku ishin përqëndruar trupat, ç'kolonë ish, ku drejtohej dhe në se dallohej mirë?
16. Ç'shënoi mbi një hartë një kolonel i aviacionit?
17. Kush i shënoi mbi një hartë të tëra informatat që i dhanë vëzhguesit?
18. Ku i shënoi koloneli i aviacionit të tëra informatat që i dhanë vëzhguesit?
19. Kujt i a raportoi ai gjendjen?



20. Ç'i raportoi koloneli i aviacionit komandantit të përgjithshëm në atë zonë?
21. Kë thirri komandanti i përgjithshëm në zyrën e tij?
22. Kush i thirri pilotët në zyrën e tij?
23. Ç'udhëzime u dha komandanti i përgjithshëm pilotëve?
24. Kujt i a dha ai udhëzimet e duhura?
25. Ç'do të shkatërronin pilotët sipas udhëzimeve të komandantit të përgjithshëm në atë zonë?
26. Kush do t'a shkatërronte përqëndrimin e trupave?
27. Çfarë bombarduesish filluan të ngriheshin në ajr nga aerodromi?
28. Nga ku filluan të ngriheshin bombarduesit e lehtë?
29. Ç'filluan të bënin bombarduesit e lehtë?
30. Kur arritën ata mbi objektivin e caktuar?
31. Kur arritën bombarduesit e lehtë mbi objektivin e caktuar?
32. Ç'filluan ata të bënin posa arritën mbi objektivin e caktuar?
33. Cilët filluan të bombardonin dhe të mitralonin?
34. Kur filluan bombarduesit të bombardonin dhe të mitralonin objektivin armik?
35. Nga se u-shkatërruan një shumicë tankesh?
36. Nga çfarë bombash u-shkatërruan një shumicë tankesh?
37. Sa tanke i shpëtuan vrullit të parë?
38. Cilat tanke u-organizuan në grupe dhe filluan të shtinin me topa e mitraloza kundërajrorë?
39. Ç'filluan të bënin tanket që i shpëtuan sulmit të parë?
40. Me çfarë topash filluan të shtinin ata?

41. Ç'lëshuan bombarduesit tonë?
42. Ç'shkatërruan bombarduesit tonë me raketat që lëshuan?
43. Sa nga aeroplanat tonë u-nxorën jashtë luftimi?
44. Ç'u ngjau dy aeroplanave tonë?
45. Sa nga aeroplanat tonë u-rrëzuan?
46. Piloti i cilit aeroplan shpëtoi?
47. Si shpëtoi piloti i njerit nga aeroplanat tonë?
48. Cili pilot shpëtoi duke u-hudhur me parashutë brenda vijave tona?
49. Brenda cilave vija u-hudh piloti që shpëtoi me parashutë?
50. Cila artileri filloi pastaj një bombardim të vazhdueshëm?
51. Ç'filloi pastaj artileria jonë?
52. Çfarë bombardimi filloi pastaj artileria jonë?
53. Në ç'mënyrë e filloi artileria jonë bombardimin?
54. Kush duhej të mos përqëndronte trupa?
55. Në ç'gjendje duhej vënë armiku?
56. Ç'bën një bombardim i vazhdueshëm?
57. Kush duhej vënë në pamundësi t'a përdorte atë zonë për aksione ushtarake?
58. Në ç'pamundësi duhej vënë armiku?
59. Cilën zonë nuk duhej t'a përdorte armiku për aksione ushtarake?
60. Për çfarë aksionesh nuk duhej t'a përdorte armiku atë zonë?
61. Ç'informata mund të japë një vëzhgues patrulle?
62. Kush ju a ka dhënë udhëzimet e para mbi gjuhën shqipe?

63. A e mbani mend se cili qytet i Shqipërisë u-bombardua dhe u-shkatërrua më shumë gjatë Luftës së Dytë Botërore?
64. Kur mund të nxiret një aeroplan jashtë luftimi?
65. Sa aeroplana mund të ngrihen në ditë nga aeroporti i Monterey-t?
66. A ngrin uji gjatë dimrit në Monterey?

## FJALOR

aerodrom, -i aerodrome, -t	(m.)	airport
avion, -i aviona, -t	(m.)	airplane
për të bombarduar (unë bombardoj)	(v.)	to bomb, bombard
bombardues, -i bombardues, -it	(m.)	bomber (airplane)
për të çarë (unë çaj)	(v.)	to chop, split
dymotorsh, -i dymotorsha, -t	(m.)	a two engine airplane
epror, -e	(adj. m. & f.)	superior, high
ëndër, ëndra ëndra, -t	(f.)	dream
fletë, -a fletë, -t	(f.)	wing; leaf; sheet
fotografi, -a fotografi, -të	(f.)	photography; photograph
hangar, -i hangarë, -t	(m.)	hangar
për t'u-hapur (unë hapem)	(v.)	to be opened, to be spread out; to spread out; to make room (for someone to go by)
për t'u-hudhur (unë hudhem)	(v.)	to jump, leap, throw oneself; to be thrown away

për t'u-këputur (unë këputem)	(v.)	to get very tired; to be plucked; to be broken (wire, thread, etc.)
kundërajror, -e	(adj. m. & f.)	antiaircraft
për të mitraluar (unë mitraloj)	(v.)	to strafe, to machine-gun
ndofta	(adv.)	see "ndoshta"
pamundësi, -a pamundësi, -të	(f.)	impossibility
para, -ja para, -të	(f.)	see "pare"
parashutë, -a parashuta, -t	(f.)	parachute
përqëndrim, -i	(m.)	concentration
pilotazh, -i	(m.)	piloting
për të pilotuar (unë pilotoj)	(v.)	to pilot
reaktiv, -i reaktivë, -t	(m.)	a jet plane
për t'u-rrëzuar (unë rrëzohem)	(v.)	see "me u-rrëxue"
shlemofon, -i shlemofona, -t	(m.)	the pilot's helmet
trupë, -a trupa, -t	(f.)	troop(s), a military unit
vëzhgues, -e	(adj. m. & f.)	reconnaissance, reconnoitering, observing
vrull, -i	(m.)	impetus, momentum; rush

SHËNIME

aeroplan reaktiv	jet plane
për të çarë hapësirën (unë çaj hapësirën)	to go through space
për të marrë (në) fotografi (v.) (unë marr (në) fotografi)	to take a picture, to photograph
Me se....?	With what....?
nxorën jashtë luftimi dy aeroplana	they put two airplanes out of action

DETYRË SHTËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. Më trego me hollësi se ç'ngjau.
2. Merr me vete vetëm njerin prej tyre; tjetrin lëre në shtëpi.
3. Gjatë udhëtimit kemi bërë ca fotografi të bukura.
4. Ç'kërkon prej meje? S'kam para me vete!
5. Eshtë një aeroport i vogël për aeroplana privatë.
6. Rrypi i shlemofonit qe këputur.
7. Vëzhguesit na dhanë pozicionin e saktë të divizionit të armikut.
8. Raketat e armikut shkatërruan hangarët dhe disa aeroplana që ishin në aerodrom.

Mësimi i 99-të






FILLIMI I SULMIT VENDIMTAR

DIALOGU

1. Mirë mëngjes, Agim! Ç'ke, më dukesh i mërziur, a mos ke frikë?
2. Kush nuk ka frikë nuk është njeri. Sulmi i sotëm është vendimtar si për ne ashtu edhe për fatin e ushtrisë.
3. Me të vërtetë ky është një operacion me rëndësi. Kush e solli urdhërin?
4. Si zakonisht një lajmëtar, por gjer tani vetëm komandanti dhe një rreth i ngushtë oficerësh kanë pasur dijeni mbi këtë çështje.
5. Kur ju a komunikuan juve?
6. Pak orë më parë dhe na thanë që të jemi gati në tri orë.
7. Pa tjetër komandanti i divizionit do t'i ketë studjuar të gjithë faktorët e ndryshëm si forcën e tij, atë të armikut, terrenin etj.
8. Po ç'të bëjë tjetër?! Ai dhe shtabi i tij këtë punë bëjnë; për bukuri s'i kanë vënë aty ku janë.
9. A i akordohet gjeneralit ndonjë afat për të përgatitur planet?
10. Zakonisht po, por çdo gjë mvaret sipas rëndësisë së sulmit dhe rrethanave tjera.
11. Besoj se të gjitha njësive të divizionit u është komunikuar urdhëri dhe u janë dhënë udhëzimet e duhura.
12. Po, pa tjetër. Tani aeroplanat janë duke lëshuar tym gjatë lumit ku do të zbarkojmë.
13. Po artileria, nuk merr pjesë fare?
14. Po; edhe artileria është duke bombarduar pozicionet e armikut.
15. Ç'do të bëni në qoftë se armiku është i mbrojtur ndër fortifikata?
16. Do të përdorim zjarrhuhëse duke futur flakën nëpër frangjia.

17. Për të asgjësuar armikun!
18. Ja për t'a asgjësuar ja t'a shtrëngojmë të dorëzohet.
19. A do të mundeni vallë të nxirni informata nga ushtarët që do të zini rob?
20. Ti e di se ushtari që zihet rob, sipas Konventës Ndërkombëtare të Gjenevës, duhet të tregojë vetëm emrin, mbiemrin, gradën dhe numrin e tij ushtarak e asgjë tjetër.





## LEXIM E PËRKTHIM

Në komandën e divizionit arriti një lajmëtar i Komandës së Përgjithshme, i cili solli me vete urdhëra sekretë. Këta urdhëra njoftonin se divizioni duhej t'a rifillonte sulmin. Shtabi i divizionit i hyri punës për të vënë në hartë operacionet që do të bëheshin. Gjenerali i divizionit në front studjoi gjendjen duke marrë parasysh si forcën e njësive të tia, ashtu edhe informatat që kish mbi armikun. Ai u-sigurua që në planin e sulmit të përfshiheshin, përveç tjerave, edhe këto gjëra: një lëvizje e shpejtë e trupave, një plan i koordinuar shtirjesh dhe sidomos që sulmi të bëhej papritmas.

Urdhëri i fillimit të operacioneve i u-dërgua të tëra regjimenteve. Ky urdhër nuk qe sekret më dhe i u-komunikua të tërë ushtarëve duke përfshirë edhe Agimin.

Në muzgun e asaj dite, kompania, në të cilën bënte pjesë Agimi, u-vu në lëvizje në drejtim të lumit ku ishte baza e sulmit (pikënisja) dhe ku ishin duke pritur barka gome. Në çdo barkë kishte dy ushtarë të xhenios, të cilët janë të praktikuar në këtë lloj transporti. Njëkohësisht artileria jonë hapi zjarr me shtirje të dendura dhe fitoi superioritet mbi atë të armikut. Aeroplana dhe aparate që përftojnë tym, lëshuan tym gjatë tërë lumit për të fshehur operacionet, kështu që armiku të mos dinte

me saktësi se në ç'pikë do t'a kalonim lumin. Për t'a detyruar armikun të qëndronte gjithënjë i fshehur dhe me kokë ulur, u-organizua një rjetë zjarri dhe shtirjet vazhduan gjersa vala e parë e këmbësorisë sonë kaloi nga vendi i përqëndrimit në pikënisje. Njësitë e para e kaluan lumin me sukses e pas tyre arritën edhe tjera.

Kompania e Agimit zuri një pozicion të mirë sulmi. Ajo që në gjendje t'a shpartallonte armikun me shtirjet e veta dhe duke luftuar trup me trup. Nganjëherë përdori edhe zjarrhuhëse kundër fortifikatave për të asgjësuar armikun, ose për t'a detyruar të dilte jashtë fortifikatave dhe të dorëzohej.

Me një kundërsulm që bëri, armiku u-mundua t'i zmbapte forcat tona përtej lumit, por kundërsulmi u-thye. Armiku u-dorëzua në atë sektor dhe forcat tona e zgjeruan kryeurën.

Shërbimi i zbulimit i divizionit tonë mori në pyetje ca civila që banonin në zonën e luftës, prej të cilëve morëm vesh shumë gjëra që nuk dinim më parë mbi armikun dhe mbi forcat e tia.

PYETJE

1. Kush arriti në komandën e divizionit?
2. Lajmëtari i cilës komandë arriti në komandën e divizionit?
3. Ç'urdhëra solli ai me vete?
4. Kush solli urdhëra sekretë në komandën e divizionit?
5. Nga ç'komandë solli ai urdhëra sekretë?
6. Ç'njoftonin këta urdhëra?
7. Ç'duhej të bënte divizioni sipas këtyre urdhërave?
8. Kush duhej t'a rifillonte sulmin?
9. Çfarë pune i hyri shtabi i divizionit?
10. Cilat operacione vuri në hartë shtabi i divizionit?
11. Ç'bëri shtabi i divizionit?
12. Kush e studjoi gjendjen?
13. Ç'bëri gjenerali i shtabit të divizionit në front?
14. Cili e studjoi gjendjen duke marrë parasysh si forcën e njësive të tija, ashtu edhe informatat që kish mbi armikun?
15. Si e studjoi gjenerali i shtabit gjendjen?
16. Ç'forca dhe ç'informata mori ai parasysh kur e studjoi gjendjen?
17. Kush u-sigurua që në planin e sulmit të përfshiheshin shumë gjëra?
18. Për çka u-sigurua gjenerali?
19. Sipas planit të sulmit, si duhej të ish lëvizja e trupave?
20. Po plani i shtirjeve, si duhej të ish?

21. Ç'duhej të ish i koordinuar mirë?
22. Në ç'mënyrë duhej bërë sulmi?
23. Ç'duhej bërë papritmas?
24. Ç'gjëra duheshin përfshirë në planin e sulmit?
25. Cilave regjimente i u-dërgua urdhëri i fillimit të operacioneve?
26. Ç'i u-dërgua të tëra regjimenteve?
27. Ç'u-bë me urdhërin e fillimit të operacioneve?
28. Cili urdhër nuk qe më sekret?
29. Ç'i u-komunikua të tërë ushtarëve duke përfshirë edhe Agimin?
30. Kujt i u-komunikua dy urdhër?
31. Cila kompani u-vu në lëvizje në muzgun e asaj dite?
32. Ç'ndodhi në muzgun e asaj dite?
33. Kur u-vu në lëvizje kompania, në të cilën bënte pjesë Agimi?
34. Në ç'drejtim u-vu në lëvizje kompania e Agimit?
35. Ç'ishte afër lumit?
36. Ku ishin duke pritur ca barka gome?
37. Çfarë barkash ishin duke pritur afër lumit?
38. Sa ushtarë të xhenios kishte në çdo barkë?
39. Ku kishte nga dy ushtarë të xhenios?
40. Cilët ushtarë janë të praktikuar në këtë lloj transporti?
41. Në çka janë të praktikuar ushtarët e xhenios?
42. Kur hapi zjarr artileria jonë?
43. Ç'bëri artileria jonë njëkohësisht?

44. Me çfarë shtirjesh hapi zjarr ajo?
45. Mbi cilën artileri fitoi superioritet artileria jonë?
46. Ç'fitoi artileria jonë mbi artilerinë e armikut me shtirje të dendura?
47. Ç'aeroplana dhe ç'aparate lëshuan tym?
48. Cilat mjete përftojnë tym?
49. Gjatë çfarë pjese të lumit lëshuan tym ato aparate dhe aeroplana?
50. Për çfarë qëllimi lëshuan tym ato mjete?
51. Ç'bënë aeroplanat dhe aparatet që lëshojnë tym për të fshehur operacionet?
52. Kush nuk duhej të dinte me saktësi se në ç'pikë do t'a kalonim lumin?
53. Çka nuk duhej të dinte armiku?
54. Ç'u-organizua për t'a detyruar armikun të qëndronte gjithënjë me kokë ulur?
55. Kush duhej të qëndronte gjithënjë i fshehur dhe me kokë ulur?
56. Si duhej të qëndronte armiku gjithënjë?
57. Çfarë zjarri u-organizua?
58. Për sa kohë vazhduan shtirjet?
59. Ç'ndodhi gjersa vala e parë e këmbësisë sonë kaloi nga vendi i përqëndrimit në pikënisje?
60. Nga ç'vend gjer në ç'vend kaloi vala e parë e këmbësisë sonë gjatë shtirjeve?
61. Ç'kaloi nga vendi i përqëndrimit në pikënisje?
62. Cilat njësi e kaluan lumin me sukses?
63. Ç'kaluan njësitë e para me sukses?

64. Ç'ngjau pasi kaluan njësitë e para me sukses?
65. Kur arritën njësitë tjera?
66. Çfarë pozicioni zuri kompania e Agimit?
67. Ç'qe në gjendje të bënte ajo me shtirjet e veta?
68. Kë qe në gjendje të shpartallonte kompania e Agimit me shtirjet e veta?
69. Me kë luftoi ajo trup me trup?
70. Ç'i bëri armikut kompania e Agimit duke shtënë dhe duke luftuar trup me trup?
71. Kundër çfarë gjëje përdori ajo nganjëherë edhe zjarrhuhëse?
72. Pse përdori kompania e Agimit zjarrhuhëse kundër fortifikatave?
73. Kë desh të asgjësonte ose t'a detyronte të dilte jashtë fortifikatave ajo kompani?
74. Kush duhej asgjësuar ose të dorëzohej?
75. Ç'bën armiku kur është i detyruar të dalë jashtë fortifikatave?
76. Kush u-mundua t'i zbrapte forcat tona përtej lumit me një kundërsulm?
77. Qysh u-mundua armiku t'i zbrapte forcat tona përtej lumit?
78. Ç'u-mundua të bënte armiku?
79. Ç'i ngjau kundërsulmit të tij?
80. Ç'i ngjau armikut në atë sektor?
81. Cilat forca e zgjeruan kryeurën?
82. Kë mori në pyetje shërbimi i zbulimit i divizionit?
83. Cili shërbim mori në pyetje ca civila që banonin në zonën e luftës?

L. 99

84. Nga cilët morëm vesh shumë gjëra që nuk i dinim më parë?

85. Mbi kë morëm vesh shumë gjëra që nuk dinim më parë?



## FJALOR

afat, -i afate, -t	(m.)	deadline
për t'u-akorduar (akordohet)	(v.)	to be granted, accorded; to be tuned (musical instrument)
për të asgjësuar (unë asgjësoj)	(v.)	to annihilate, wipe out
dijeni, -a	(f.)	knowledge, information
faktor, -i faktorë, -t	(m.)	factor
flakë, -a flakë, -t	(f.)	flame
frangji, -a frangji, -të	(f.)	loophole
gjer	(conj.)	see "deri"
gjersa	(conj.)	until; as long as
kokë, -a kokë, -t	(f.)	see "krye"
për të komunikuar (unë komunikoj)	(v.)	to communicate
për t'u-komunikuar (komunikohet)	(v.)	to be communicated
konventë, -a konventa, -t	(f.)	convention (an international agreement)
i, e, të koordinuar të koordinuara	(adj. m. & f.)	co-ordinated

kryeurë, -a kryeura, -t	(f.)	bridgehead, beachhead
kundërsulm, -i kundërsulme, -t	(m.)	counterattack
lajmëtar, -i lajmëtarë, -t	(m.)	messenger
muzg, -u muzgje, -t	(m.)	dusk, twilight
për t'u-përfshirë (unë përfshihem)	(v.)	to be included, encompassed
për të përftuar (unë përftoj)	(v.)	to produce; create
pikënisje, -a	(f.)	initial point, starting point
i, e, të praktikuar të praktikuar	(adj. m. & f.)	experienced, trained
për të rifilluar (unë rifilloj)	(v.)	to resume
sekret, -të sekrete	(adj. m. & f.)	secret
për t'u-siguruar (unë sigurohem)	(v.)	to be assured; insured, guaran- teed, warranted
për të shpartalluar (unë shpartalloj)	(v.)	to destroy (especially a military unit); to smash
shtab, -i shtabe, -t	(m.)	staff (mil.)
për të shtrënguar (unë shtrëngoj)	(v.)	to force, oblige, compel; to tighten, to fasten; to shake hands

teren, -i terene, -t	(m.)	terrain
transport, -i transporte, -t	(m.)	transport
ulur	(adv.)	seated
vendimtar, -e vendimtarë	(adj. m. & f.)	decisive
zbulim, -i zbulime, -t	(m.)	discovery, discovering; uncovering; intelligence (G-2)
për të zgjeruar (unë zgjeroj)	(v.)	to widen, expand
zjarrhudhëse, zjarrhudhësja zjarrhudhëse, -t	(f.)	flame thrower
për t'u-zmbrapur (unë zmbrapem)	(v.)	to withdraw, to back up; to be repelled, to be driven back

## SHËNIME

me kokë ulur		stooping
për t'i (a) hyrë punës (unë i (a) hyj punës)	(v.)	to start working
trup me trup		hand to hand (for fighting)
për t'u-vënë në lëvizje (vihem në lëvizje)	(v.)	to start (moving)

DETYRË SHTRËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:


1. He was interrogated before he was released.
2. The Third Army has its headquarters near Lushnja.
3. This is a very narrow road; go slowly, please!
4. I'm sorry, I can do nothing under these circumstances.
5. He came out at the same time I did.
6. The counterattack was repelled with heavy casualties on both sides.
7. I bought four used tires because I didn't have enough money to buy new ones.
8. The deadline is tomorrow; do you have the money ready?
9. Describe the terrain of the other side of the river for me.
10. Take with you the platoon machine gun.

Mësimi i 100-të

SULMI VENDIMTAR NË ZHVILLIM E SIPËR

DIALOGU

1. Hej Agim! Më trego si e ndërtuan urën xhenierët.
2. Së pari vendosën për së gjeri barka breg në breg, pastaj vunë trerë ose binarë hekuri e mbi ta dërrasa të trasha e të forta.
3. A nuk lëvizin këto kur kalojnë automjetet?
4. Jo. Shtresa e urës sigurohet mirë me litar e mjete tjera.
5. A duhet shumë kohë për të ndërtuar një urë të tillë?
6. Ndërtimi i uravet është specialiteti i xhenierëve dhe kryhet me zotësi e shpejtësi të madhe.
7. Ç'taktikë ndoqën repartet mbasi e kaluan urën?
8. Gjatë natës u-dërguan patrulla në të tëra anët.
9. Ç'mision i u-caktua këtyre patrullave?
10. Të shtinin vazhdimisht kundër armikut dhe të mos e lënin të organizonte qëndresë, të hapte llogore, të vendoste topa etj.
11. Ç'bëri këmbësoria në këtë ndërkohë?
12. Këmbësoria e ndihmuar nga tanket rifilloi sulmin dhe zgjeroi terrenin e pushtuar në fillim.
13. A hyri këmbësoria thellë në terrenin e armikut?
14. Jo tepër. Nuk është mirë të shtyresh thellë në terrenin e armikut sepse mund të të rrethojë dhe të të asgjësojë fare kollaj.
15. Ç'bëri armiku?
16. Armiku u-tërhoq, por përveç ushtarëve në pusi përdori tanke dhe gaze.
17. Besoj se kjo taktikë e armikut nuk dha përfundime të mira.
18. Ashtu është. Ne shkatërruam armët antitank, topat, armët që nuk zbrapen kur zbrazen dhe dërruam çdo qëndresë.
19. Atëherë punët janë duke vajtur mirë.
20. Po, ashtu duket.



## LEXIM E PËRKTHIM

Në perëndimin e diellit të asaj dite që shpërtheu sulmi vendimtar, xhenierët po mbaronin ndërtimin e një ure me barka. Posa që gati ura filluan të kalonin mbi të tanke e topa, në mënyrë që t'i jepnin sulmit ndihmën e duhur. Nesërejt në mënjgjes këmbësoria ishte e ndihmuar nga tanket.

Gjatë natës u-organizuan vende dëgjimi dhe kudo u-dërguan patrulla për të mos e lënë armikun rahat dhe, po të ish e mundur, të mos i jepej kohë të ndërtonte llogore. Këmbësoria dhe tanket e kaluan pikëmbështetjen për të rifilluar sulmin. Kështu, me përqëndrim zjarri dhe manevrim, këmbësoria fitoi teren përtej pozicioneve të sulmit, dhe u-vu në gjendje të luftonte kundër armikut nga afër.

Më në fund, të tëra grupet që paraqitnin rezistencë u-asgjësuan ose u-lanë pas, si edhe u-zu një shumicë e madhe robësh. Forcat tona depërtuan thellë në terrenin e armikut, por gjithënjë duke pasur kujdes që të mos shtyheshin shumë thellë.

Komanda jonë ushtarake u-transferua përpara në zonën e pushtuar rishtas. Armiku vuri aty-këtu ushtarë në pritë, armë antitank dhe përdori gaze me qëllim që të përmbante sulmin tanë; por forcat tona i neutralizuan gazet dhe i shkatërruan armët antitank.

L. 100

Armët që nuk zbrapen kur zbrazen, të cilat i kish armiku në përdorim, u-zbuluan nga pjesa e tokës së përzhitur që kanë mbrapa dhe u-shkatërroun nga artileria dhe mortajat tona. Bazukat e armikut u-shkatërroun nga këmbësoria. Sulmi vazhdoi të vente mbarë dhe të dërmonte çdo qëndresë.



## PYETJE

1. Ç'sulm shpërtheu në perëndimin e asaj dite?
2. Ç'po bënin xhenierët në perëndimin e diellit të asaj dite që shpërtheu sulmi vendimtar?
3. Cilët po mbaronin ndërtimin e një ure mbi barka?
4. Kur po mbaronin xhenierët një urë mbi barka?
5. Ç'filloi të kalonte mbi urë posa ajo qe gati?
6. Mbi çka filluan të kalonin tanke e topa?
7. Pse filluan të kalonin tanke e topa nëpër urën mbi barka?
8. Ç'ndihmë do t'i jepnin tanket e topat sulmit?
9. Kur u-ndihmua këmbësoria nga tanket?
10. Nga se u-ndihmua këmbësoria?
11. Kur u-organizuan vende dëgjimi?
12. Ç'vende u-organizuan gjatë natës?
13. Ç'u-bë gjatë natës?
14. Ku u-dërguan patrulla gjatë natës?
15. Pse u-organizuan vende dëgjimi dhe u-dërguan patrulla gjatë natës?
16. Kë nuk duhej të linin rahat patrullat?
17. Ç'duhej t'i bënin patrullat armikut?
18. Kujt nuk duhej t'i jepej kohë të ndërtonte llogore?
19. Ç'nuk duhej t'i jepej armikut?
20. Për ç'arësye u-dërguan patrullat?
21. Cilat njësi e kaluan pikëmbështetjen për të rifilluar sulmin?

22. Ç'kaluan këmbësoria dhe tanket?
23. Pse e kaluan pikëmbështetjen këmbësoria dhe tanket?
24. Me se fitoi këmbësoria teren përtej pozicioneve të sulmit?
25. Ç'fitoi këmbësoria me përqëndrim zjarri e manovrim?
26. Ku fitoi këmbësoria teren me përqëndrim zjarri dhe manovrim?
27. Ç'u-vu në gjendje të bënte këmbësoria nga afër?
28. Kundër kujt u-vu në gjendje të luftonte këmbësoria?
29. Si e luftonte këmbësoria armikun?
30. Cilat grupe u-asgjësuan më në fund?
31. Ç'paraqitnin grupet që u-asgjësuan më në fund?
32. Ku u-lanë grupet që paraqitnin rezistencë?
33. Ç'u ndodhi grupeve që paraqitnin rezistencë?
34. Sa robër u-zunë?
35. Ç'i ngjau një shumice së madhe robësh?
36. Ku depërtuan forcat tona?
37. Si depërtuan forcat tona në terrenin e armikut?
38. Ç'bënë forcat tona?
39. Cilat forca patën kujdes që të mos shtyreshin shumë thellë?
40. Ç'patën kujdes forcat tona të mos bënin kur depërtuan thellë në tokën e armikut?
41. Cilat forca nuk duhej të shtyreshin shumë thellë në tokën e armikut?
42. Pse nuk duhej të shtyreshin shumë thellë forcat tona në terrenin e armikut?
43. Ku u-transferua komanda jonë ushtarake?

44. Cila komandë u-transferua përpara në zonën e pushtuar rishtas?
45. Në ç'zonë u-transferua komanda jonë?
46. Ç'vuri armiku aty-këtu në pritë?
47. Ku vuri armiku ushtarë në pritë?
48. Ku vuri ai armë antitank?
49. Kush përdori edhe gaze aty-këtu?
50. Me çfarë qëllimi vuri armiku aty-këtu ushtarë në pritë, armë antitank dhe përdori gaze?
51. Ç'sulm deshëtë përmbante armiku me këto masa që mori?
52. Kush i neutralizoi gazet që përdori armiku?
53. Ç'u bënë forcat tona gazeve dhe armëve antitank?
54. Cilat forca i shkatërruan armët antitank të armikut?
55. Si është toka mbrapa armëve që nuk zbrapen kur zbrazen?
56. Çfarë armësh kish përdorur armiku?
57. Nga se u-diktuan armët që nuk zbrapen kur zbrazen?
58. Ç'shkatërruan artileria dhe mortajat tona?
59. Ç'mjete i shkatërruan armët që nuk zbrapen kur zbrazen, të të cilat i kish përdorë armiku?
60. Nga se u-shkatërruan bazukat e armikut?
61. Ç'shkatërroi këmbësoria jonë?
62. Ç'vazhdoi të vente mbarë dhe të dërmonte çdo qëndresë?
63. Si vazhdoi të vente sulmi?

## FJALOR

për t'u-asgjësuar (unë asgjësohem)	(v.)	to be annihilated, wiped out, exterminated
binar, -i binarë, -t	(m.)	rafter, scantling; two-by-four; rail (railroad)
dëgjim, -i	(m.)	hearing, listening
për të dërmuar (unë dërmoj)	(v.)	to crush, smash, shatter; to overwhelm
gaz, -i gaze, -t	(m.)	gas; laughter, joy
për së gjeri	(adv.)	widthwise
kollaj	(adv.)	easily
për t'u-lënë (unë lihem)	(v.)	to be left
manevrim, -i manevrime, -t	(m.)	maneuvering, maneuverability
mbarë	(adv.)	satisfactorily; all right; smoothly; on the right side of....
ndërkohë, -a	(f.)	meantime (the intervening time)
në këtë ndërkohë	(adv.)	meanwhile, meantime
i, e, të ndihmuar të ndihmuara	(adj. m. & f.)	helped, aided
nesërejt	(adv.)	next day
për të neutralizuar (unë neutralizoj)	(v.)	to neutralize

për të organizuar (unë organizoj)	(v.)	to organize
i, e, të përzhitur të përzhitura	(adj. m. & f.)	scorched, singed
pikëmbështetje, -a pikëmbështetje, -t	(f.)	line of departure
pritë, -a prita, -t	(f.)	ambush
pusi, -a pusi, -të	(f.)	ambush
për të pushtuar (unë pushtoj)	(v.)	to invade, occupy, conquer
për të rrethuar (unë rrethoj)	(v.)	to encircle, siege, surround
për t'u-rrethuar (unë rrethohem)	(v.)	to be surrounded, encircled, sieged, besieged
sipër	(adv. & prep.)	upstairs; above, on top of, on, over
specialitet, -i specialitete, -t	(m.)	specialty
shkak, -u shkaqe, -t	(m.)	cause, reason; pretext
shtresë, -a shtresa, -t	(f.)	pavement; layer, stratum; mattress and/or mat
për t'u-shtyrë (unë shtyhem)	(v.)	to go farther; to push (one another); to be postponed; to be instigated
taktikë, -a taktika, -t	(f.)	tactics

L. 100

tra, -u trrerë, -t	(m.)	beam (construction)
për t'u-transferuar (unë transferohem)	(v.)	to be transferred
xhenier, -i xhenierë, -t	(m.)	soldier of the Engineer Corps

#### SHËNIME

armë që nuk zbrapen kur zbrazen		recoilless weapons
për t'u-vënë në gjendje (unë vihem në gjendje)	(v.)	to be in a position to
në zhvillim e sipër		taking place, going on, in process

#### DETYRË SHTRËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. The discussion was postponed until next week.
2. The enemy was surrounded and finally surrendered.
3. Italy invaded Albania on April 7, 1939.
4. He was killed in an ambush.
5. This board (plank) is wider than the other one.
6. We need some rope in order to tow the car; otherwise we are stuck here.
7. The Mati bridge is long and beautiful and it was built in the twenties.
8. The cause of the fire is not known yet.
9. Take it out of here!
10. This beam is about to fall. Watch out!

Mësimi i 101-të

TË MARRURIT NË PYETJE TË ROBËVE TË LUFTËS





DIALOGU

1. Hajde! Silli robët një nga një.
2. Si urdhëroni, Zoti Toger!
3. Si të quajnë?
4. Shihe emrin tim në pllakë; aty i ke të gjitha ç'duhet të dish.
5. Ç'gradë ke?
6. Tani jam ushtar i thjeshtë; ca kohë më parë më kanë degraduar.
7. Pse?
8. E kam zakon të dehem shpesh.
9. Të pashë kur hyre se po çaloje; ç'ke mos je i plagosur?
10. Po, jam plagosur në kofshë dhe më dhëmb shumë.
11. Mos u-bën merak. Sa të mbaroj pyetjet do të të shpie ke mjeku. Urdhëro një cigare!
12. Të falem nderit, dua edhe pak ujë.
13. Ku të zunë rob?
14. Isha fshehur në një kasolle, meqë kur u-tërhoq njësia ime nuk isha në gjendje të ecja.
15. A ju do populli i krahinës që keni zaptuar?
16. Jo, sidomos punëtorët bëjnë grevë herë pas here.
17. Po ju, ç'bëni kur ata bëjnë grevë?
18. Pushkatojmë agjitorët dhe kryetarët; tjerët i burgosim.
19. A betohe se këto që thua janë të vërteta?
20. Po. Po të duash t'i jap me shkrim. Nuk duhet të dyshosh në përgjegjet e mia.
21. Ku është komanda e përgjithshme e ushtrisë në front?
22. Se ku është tani nuk e di; para se të dëmtohej nga bombardimet ka qenë në bodrumet e fortesës.

L. 101

23. A guxonin të flisnin kundër regjimit në vendin tënd?
24. Haptas jo, por ne ankoheshim me njeri tjetrin. Di se shumë ushtarë janë akuzuar për sabotim.
25. Tani shko ke mjeku!
26. Të falem nderit.





LEXIM E PËRKTHIM

Një oficer i Shërbimit të Zbulimit të Ushtrisë, që e kish zyrën në një njësi pak a shumë larg nga zona ku po bëhej sulmi, mori në pyetje një rob lufte. Oficeri i zbulimit u-mundua të nxirte nga rob i ndonjë informatë me rëndësi mbi operacionet në zhvillim e sipër.

Së pari ai u bëri një kontrollim tjetër të tëra gjërave që rob i kish me vete me qëllim se mos vallë kish shpëtuar ndonjë gjë pa parë në çastin kur ish zënë rob. Zakonisht këto sende janë: pllaka e metalit ku është shënuar numri ushtarak, letërnjoftimi, letrat që ka marrë me postë ushtarake, të hollat etj. Oficeri shqyrtoi pastaj dokumentat që rob i kish me vete dhe i bëri ca pyetje rreth tyre.

Oficeri i zbulimit filloi të tregohej i përzemërt me robin: i ofroi cigare, e pyeti në se kish ndonjë plagë dhe në se dëshironte të mjekohej. Kjo sjellje pati efekt të mirë psikologjik dhe oficeri i arriti qëllimit duke fituar besimin e robit. Kështu ai mori informata mbi organizimin e njësisë në të cilën bënte pjesë rob i, mbi divizionet e ndryshme, si edhe mbi regjimentet e batalionat që ishin në zonën e sulmit. Oficeri i zbulimit e di se ndoshta rob i gënjen dhe, para se t'i besojë, sigurohet nga burime tjera në se ç'thotë ai janë të vërteta ose jo.

Pastaj robi dërgohet në një fushë përqëndrimi, por mund të merret në pyetje përsëri, në qoftë se informatat që ka dhënë i përgjigjen së vërtetës. Robët e luftës zakonisht transferohen në prapavija, ku mbahen në fusha përqëndrimi gjersa të marrë fund lufta.

PYETJE

1. Ku e kish zyrën një oficer i Shërbimit të Zbulimit të Ushtrisë?
2. Ç'kish një oficer i Shërbimit të Zbulimit të Ushtrisë në një njësi pak a shumë larg nga zona ku po bëhej sulmi?
3. Zyra e kujt ndodhej pak a shumë larg nga zona ku po bëhej sulmi?
4. Kush mori në pyetje një rob lufte?
5. Kë mori në pyetje oficeri i Zbulimit të Ushtrisë?
6. Ç'informata u-mundua të nxirte oficeri nga robi i luftës?
7. Nga kush u-mundua oficeri të nxirte informata?
8. Mbi çfarë operacionesh u-mundua ai të nxirte informata me rëndësi?
9. Ç'ish në zhvillim e sipër?
10. Cilave gjëra u bëri kontrollim oficeri i Zbulimit të Ushtrisë?
11. Kur u bëri ai një kontrollim tjetër të tëra gjërave që kish robi me vete?
12. Ku i kish robi gjërat, të cilave u bëri kontrollim oficeri?
13. Gjërave të kujt u bëri kontrollim oficeri?
14. Ç'bëri oficeri?
15. Cili deshi të sigurohej se mos vallë kish shpëtuar ndonjë gjë pa parë?
16. Kur mund të kish shpëtuar ndonjë gjë pa parë?
17. Ç'mund të kish shpëtuar pa parë?
18. Zakonisht cilat janë sendet që kontrollohen në këtë rast?

19. Kur duhen kontrolluar pllaka e metalit me numrin ushtarak, letërnjoftimi, letrat, të hollat etj.?
20. Me çfarë poste i marrin letrat ushtarët?
21. Kush i merr letrat me postë ushtarake?
22. Ç'shënohet në pllakën e metalit?
23. Ç'keni të shënuar në letërnjoftimin tuaj, Z....?
24. Kush i shqyrtoi pastaj dokumentat që kish robi me vete?
25. Ku i kish robi dokumentat, të cilët i a shqyrtoi oficeri?
26. Ç'u bëri oficeri dokumentave që kish robi me vete?
27. Kujt i bëri oficeri ca pyetje rreth këtyre dokumentave?
28. Si filloi të tregojë oficeri i zbulimit me robin e luftës?
29. Kush u-tregua i përzemërt me të?
30. Ç'i ofroi oficeri robit të luftës?
31. Ç'e pyeti oficeri robin e luftës?
32. Cili e pyeti robin e luftës në se kish ndonjë plagë dhe në se dëshironte të mjekohet?
33. Çfarë efekti pati kjo sjellje?
34. Sjellja e kujt pati efekt të mirë psikologjik?
35. Cili i a arriti qëllimit?
36. Kush e fitoi besimin e robit të luftës me sjelljen e tij?
37. Në ç'mënyrë e fitoi besimin e robit të luftës oficeri i zbulimit të ushtrisë?
38. Mbi organizimin e njësisë së kujt mori informata oficeri?
39. Oficeri mori informata mbi divizionet, regjimentet dhe batalionat që ishin në cilën zonë?

40. Kush e di se ndoshta robi gënjen?
41. Ç'bën oficeri para se t'i besojë robit të luftës?
42. Kush sigurohet nga burime tjera para se t'i besojë robit të luftës?
43. Si e gjen oficeri i zbulimit të vërtetën mbi informatat që ka dhënë robi i luftës?
44. Kush dërgohet në një fushë përqëndrimi mbasi t'i ketë dhënë informatat?
45. Ku dërgohet pastaj robi i luftës?
46. Ç'bëjnë me robin e luftës pasi t'i a ketë dhënë informatat e duhura oficerit të zbulimit?
47. Kush mund të merret në pyetje përsëri?
48. Ç'mund t'i bëjnë robit të luftës përsëri?
49. Kë mund të marrin në pyetje përsëri, në qoftë se informatat që ka dhënë i përgjigjen së vërtetës?
50. Kur mund t'a marrin robin e luftës në pyetje përsëri?
51. Zakonisht, ku transferohen robët e luftës?
52. Kush transferohet zakonisht në prapavija?
53. Në çfarë fushash mbahen robët e luftës gjersa të marrë fund lufta?
54. Gjer kur i mbajnë robët e luftës në fusha përqëndrimi?
55. Kë mbajnë në fusha përqëndrimi gjersa të marrë fund lufta?
56. Zakonisht nga kush nxiren informatat mbi armikun gjatë luftimeve?
57. A jemi ne në mësim e sipër tani?
58. Cilët janë tani në punë e sipër?
59. Çfarë gjërash keni mbi tryezë në këtë çast?
60. Kur t'a mbaroni këtë kurs, a mund të thoni se i a arritët qëllimit, për të cilin keni ardhë këtu?

## FJALOR

agjikator, -i agjikatorë, -t	(m.)	agitator
për t'u-akuzuar (unë akuzohem)	(v.)	to be accused
për të burgosur (unë burgos)	(v.)	to imprison, to put in jail
cigare, cigarja cigare, -t	(f.)	see "cingare"
për të çaluar (unë çaloj)	(v.)	to limp; to be deficient
çast, -i çaste, -t	(m.)	see "ças"
për të degraduar (unë degradoj)	(v.)	to demote
për t'u-dehur (unë dehem)	(v.)	to get drunk, to be intoxicated
dokument, -i dokumenta, -t	(m.)	document
efekt, -i efekte, -t	(m.)	effect
grevë, -a grevë, -t	(f.)	strike (act of quitting work)
për të guxuar (unë guxoj)	(v.)	to dare
haptas	(adv.)	openly, publicly
kasolle, kasollja kasolle, -t	(f.)	hut
kofshë, -a kofshë, -t	(f.)	thigh

meqë	(conj.)	since
metal, -i metale, -t	(m.)	metal
për t'u-mjekuar (unë mjekohem)	(v.)	to be treated (medically)
për të ofruar (unë ofroj)	(v.)	to offer
për t'u-plagosur (unë plagosem)	(v.)	to be or to get wounded
i plagosur, -i të plagosur, -it	(m.)	see "i plaguem"
pllakë, -a pllaka, -t	(f.)	identification tag (dog tag); phonograph record; plaque
prapavijë, -a prapavija, -t	(f.)	rear line (mil.)
psikologjik, -e	(adj. m. & f.)	psychological
për të pushkatuar (unë pushkatoj)	(v.)	to execute by a firing squad
sjellje, -a sjellje, -t	(f.)	behavior, conduct, manners
për t'u-shënuar (unë shënohem)	(v.)	to be marked, noted, indicated
shkrim, -i shkrime, -t	(m.)	writing, handwriting
për të shqyrtuar (unë shqyrtoj)	(v.)	to examine, to study (except at school)
për të zaptuar (unë zaptoj)	(v.)	to invade, occupy, conquer



## SHËNIME

për t'i arritur qëllimit (unë i (a) arrij qëllimit)	(v.)	to reach the goal
për të bërë grevë (unë bëj grevë)	(v.)	to strike (to quit work)
të marrurit në pyetje		interrogation, interrogating
i përgjigjen së vërtetës		they are true
shërbim zbulimi		military intelligence

## DETYRË SHTRËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. Take it easy; it hurts very much!
2. He cheated me with this car; it doesn't run.
3. He lost all his savings during the last war.
4. Do you have ID papers with you? If not, you can't go in.
5. You are limping; what's the matter with you?
6. I don't understand his handwriting; do you?
7. Don't worry; I will not get drunk.
8. He was in a concentration camp for some time and then they put him in jail.
9. Erdhi të më merrte jashtëzakonisht heret.
10. Kisha nevojë për mjekim të shpejtë, por s'kishim mjek me vete.








L. 101

## Mësimi i 102-të

### DEPËRTIM NË VIJËN E FRONTIT TË ARMIKUT

#### DIALOGU

1. Pa më thuaj Agim, pasi kaluat urën, ç'taktikë ndoqi komanda juaj për të thyer armikun?
2. Urdhëroi që forcat tona së pari të depërtonin në një pikë të caktuar në mes të frontit.
3. Si një pykë në një plasë druri do të thuash.
4. Po. Të gjitha shtirjet tona me artileri dhe bombardimet e aviacionit u-përqëndruan në një zonë të ngushtë.
5. Ç'njësi e filluan sulmin?
6. Tanket të përcjellur nga detashmente të këmbësorisë. Në një farë pike trupat tona u-ndanë në dy krahë.
7. Për ç'arsye u-ndoq kjo taktikë?
8. Në mënyrë që armiku të kishte dy fronte për të mbrojtur: një para dhe një prapa; kështu ish fare e lehtë t'a rrethonim.
9. A i a arritët qëllimit?
10. Jo, sepse armiku, tamam për t'i u-shmangur rrethimit u-tërhoq ca kilometra dhe organizoi për ngut një tjetër vijë mbrojtëse.
11. Më mirë të tërhiqej se sa të mbaronte si miu në kurth.
12. Po, por fuqitë tona e ndoqën armikun këmba-këmbës dhe qe fare e lehtë t'a thyenim atë front të ri.
13. Paskeni rënë mbi armikun si rrufe!
14. Aq i shpejtë qe përparimi i njësive tona sa që praparojat e koracuara mezi i ndiqnin. Në një farë pike u-ndalën.
15. Pse, a mos takuan rezistencë?
16. Jo. Kishin nevojë për furnizime: si benzinë, naftë, municion e të ndreqnin automjetet dhe armët që ishin prishur.
17. Ç'bëri aviacioni?
18. Aviacioni bombardoi qendra industriale, d.m.th. fabrika, uzina, centrale elektriku etj., e natyrisht edhe frontin.



## LEXIM E PËRKTHIM

Forcat tona e çanë vijën e frontit të armikut me anë të një përqëndrim zjarri dhe të një veprimi të koordinuar të tankeve dhe të këmbësorisë.

Njësi të këmbësorisë së divizionit, pasi depërtuan në mes të frontit, u-ndanë më dysh: një pjesë bëri një kthesë nga e djathta dhe tjetra nga e majta për t'i rënë armikut nga prapa dhe për t'a rrethuar.

Forcat e koracuara qëndronin gati kur filloi depërtimi. Një kolonë trupash së koracuara, duke pasur përpara patrulla dhe pararoja, filloi të përparonte me të shpejtë nga zona që armiku kish pas krahësh. Për t'i bërë ballë kësaj gjendje së re, armiku u-tërhoq disa kilometra, por forcat tona e ndoqën këmba-këmbës dhe i asgjësuan njësitë e tija të organizuara shpejt e shpejt për mbrojtje. Ndërlidhja ndërmjet njësive të kolonës u-mbajt me radio. Në përparim e sipër trupat tona u-ndeshën aty-këtu me grupe rezistence, që zakonisht të bëjnë të humbasësh kohë; prandaj u-lanë pas për t'u-spastruar nga njësi të veçanta.

Kur u-ndaluan forcat tona për furnizime të ndryshme e mirëmbajtje, ato organizuan edhe një mbrojtje të lëvizëshme. Këtë e bënë që të siguroheshin nga çdo e papritur. Në të njëjtën

kohë u-dërguan aeroplana për të bombarduar qendra industriale në prapavijat e armikut. Sulmet e vazhdueshme ajrore i a ulën moralin armikut. Shumë aeroplana u-caktuan për të mbrojtur kolonën e gjatë që drejtohej nga fronti i formuar rishtas; këta kryenin një shërbim të dyfishtë: mbronin krahët tonë dhe shërbenin si vëzhgues.

Aviacioni shkatërroi si aeroportet, ashtu edhe aeroplanat që gjendeshin ndër to, në mënyrë që armiku të mos ish në gjendje të sulmonte dhe të bombardonte forcat tona që kishin përparuar.

Gjatë tërheqjes armiku u-detyrua të braktiste ose të shkatërronte një sasi të madhe material lufte. Pengesat prej betoni u-shkatërruan lehtësisht nga forcat e koracuara dhe nga bombardimet e aeroplanave. Aq i shpejtë qe sulmi, sa që praparojat e forcave tona të koracuara mezi i ndiqnin.

## PYETJE

1. Cilat forca e çanë vijën e frontit të armikut me anë të një përqëndrim zjarri?
2. Ç'bënë forcat tona me anë të një përqëndrim zjarri?
3. Me çfarë mënyre e çanë forcat tona vijën e frontit?
4. Edhe me çka tjetër e çanë forcat tona vijën e frontit të armikut?
5. Ç'bënë forcat tona me anë të një veprimi të koordinuar të tankeve dhe të këmbësisë?
6. Si qe veprimi i tankeve dhe i këmbësisë që çau vijën e frontit të armikut?
7. Cilat njësi të divizionit u-ndanë më dysh pasi depërtuan në mes të frontit?
8. Ç'bënë ca njësi të këmbësisë së divizionit pasi depërtuan në mes të frontit?
9. Ku depërtuan ca njësi të këmbësisë së divizionit?
10. Kur u-ndanë më dysh njësitë e këmbësisë së divizionit?
11. Nga ç'anë bëri kthesë një pjesë e trupave tona?
12. Po tjetra njësi, nga ç'anë bëri kthesë?
13. Kujt duhej t'i binin nga prapa dhe kë duhej të rrethonin?
14. Pse bënë dy kthesa njësitë e divizionit?
15. Cilat forca qëndronin gati kur filloi depërtimi?
16. Si qëndronin forcat e koracuara kur filloi depërtimi?
17. Ç'kish përpara kolona e trupave të koracuara?
18. Ku i kish kolona e trupave të koracuara patrullat dhe pararojet?

19. Cila kolonë filloi të përparonte me të shpejtë nga zona që armiku kish pas krahësh?
20. Nga ç'zonë filloi të përparonte me të shpejtë kolona e trupave të koracuara?
21. Ç'filloi të bënte kjo kolonë?
22. Në ç'mënyrë filloi të përparonte kolona e trupave të koracuara?
23. Kush u-tërhoq disa kilometra për t'i bërë ballë kësaj gjendje së re?
24. Ç'bëri armiku për t'i bërë ballë kësaj gjendje së re?
25. Sa kilometra u-tërhoq armiku në këtë rast?
26. Pse u-tërhoq armiku disa kilometra?
27. Kë ndoqën këmba-këmbës forcat tona?
28. Si e ndoqën armikun forcat tona?
29. Njësitë e kujt asgjësuan njësitë tona duke i ndjekur këmba-këmbës?
30. Ç'u bënë forcat tona njësite të armikut, të cilat ishin organizuar shpejt e shpejt për mbrojtje?
31. Në ç'mënyrë ishin organizuar njësitë e armikut për mbrojtje?
32. Cilat njësi ishin organizuar shpejt e shpejt për mbrojtje?
33. Me çfarë mjeti u-mbajt ndërlihdhja ndërmjet njësite të kolonës?
34. Ndërmjet cilave njësi u-mbajt ndërlihdhja me radio?
35. Ku u-ndeshën trupat tona në përparim e sipër me grupe rezistence?
36. Kur u-ndeshën trupat tona me grupet e rezistencës?
37. Ç'ngjau aty-këtu me grupet e rezistencës?
38. Zakonisht, ç'të bëjnë grupet e rezistencës të humbasësh gjatë luftës?



39. Prandaj cilat grupe u-lanë pas?
40. Pse u-lanë pas grupet e rezistencës?
41. Çfarë njësisish do t'i spastronin grupet e rezistencës më vonë?
42. Kur do t'i spastronin grupet e rezistencës njësitë e veçanta?
43. Ç'do të bënin më vonë njësitë tona të veçanta?
44. Cilat forca u-ndaluan për furnizime të ndryshme dhe mirëmbajtje?
45. Pse u-ndaluan forcat tona?
46. Çfarë mbrojtje organizuan forcat tona në atë rast?
47. Pse organizuan forcat tona një mbrojtje të lëvizëshme?
48. Nga se do të siguroheshin forcat tona?
49. Në të njëjtën kohë ç'u-dërgua për të bombarduar qendra industriale?
50. Ku ishin qendrat industriale që duhej të bombardoheshin?
51. Ç'kishte në prapavijat e armikut?
52. Kur u-dërguan aeroplanat për të bombarduar qendra industriale në prapavijat e armikut?
53. Çfarë sulmesh i a ulën moralin armikut?
54. Si ishin sulmet ajrore që i a ulën moralin armikut?
55. Sa aeroplana u-caktuan për të mbrojtur kolonën e gjatë që drejtohej nga fronti i formuar rishtas?
56. Ç'u-caktuan të bënin ca aeroplana?
57. Kur ish formuar kolona e gjatë që drejtohej nga fronti?
58. Çfarë shërbimi kryenin këta aeroplana?
59. Cilët aeroplana kryenin një shërbim të dyfishtë?

60. Krahët e kujt mbronin dhe si çka shërbenin këta aeroplana?
61. Ç'u bëri aviacioni ynë si aeroporteve, ashtu edhe aeroplave që gjendeshin në to?
62. Ç'shkatërroi aviacioni ynë?
63. Ku gjendeshin aeroplanat që shkatërroi aviacioni ynë?
64. Pse i shkatërroi aviacioni ynë si aeroportet, ashtu edhe aeroplanat e armikut?
65. Ç'bëri aviacioni ynë në mënyrë që armiku të mos ish në gjendje të sulmonte dhe të bombardonte forcat tona?
66. Ç'kishin bërë forcat tona kur u-bombarduan aeroplanat dhe aeroportet e armikut?
67. Cilat forca kishin përparuar kur u-bënë këto bombardime?
68. Kush u-detyrua gjatë tërheqjes të braktiste një sasi të madhe material lufte?
69. Kur u-detyrua armiku të braktiste ose të shkatërronte një sasi të madhe material lufte?
70. Sa material u-detyrua armiku të shkatërronte ose të braktiste gjatë tërheqjes?
71. Si u-shkatërruan pengesat prej betoni?
72. Ç'u-shkatërrua lehtësisht nga forcat e koracuara dhe nga bombardimet ajrore?
73. Nga se u-shkatërruan lehtësisht pengesat prej betoni?
74. Ç'qe shumë i shpejtë?
75. Si qe sulmi ynë?
76. Cilat praparoja memzi e ndiqnin sulmin e shpejtë?
77. Pse kishin vështirësi t'a ndiqnin sulmin praparojat e forcave tona të koracuara?

## FJALOR

beton, -i	(m.)	concrete (building material)
për të braktisur (unë braktis)	(v.)	to abandon, forsake
central elektriku	(m.)	power station
i, e, të çarë të çara	(adj. m. & f.)	cracked, split
depërtim, -i depërtime, -t	(m.)	penetration, breakthrough
detachment, -i detashmente, -t	(m.)	detachment (mil.)
për t'u-detyruar (unë detyrohem)	(v.)	to be obliged, compelled
i, e, të dyfishtë të dyfishta	(adj. m. & f.)	twofold
më dysh	(adv.)	in two parts, in half; undecided
elektrik, -u elektrikë, -t	(m.)	electricity, electric; flash light
i, e, të formuar të formuara	(adj. m. & f.)	formed
furnizim, -i furnizime, -t	(m.)	provisions, supplies
për të humbur (unë humbas)	(v.)	see "me humbë"
industrial, -ë industriale	(adj. m. & f.)	industrial

lehtësisht	(adv.)	easily, lightly
i, të lëvizëshëm e, të lëvizëshme	(adj. m. & f.)	movable, mobile
mezi	(adv.)	see "memzi"
mi, -u minj, -të	(m.)	mouse, rat
mirëmbajtje, -a	(f.)	maintenance
moral, -i	(m.)	moral, morals, morality; morale
ndërlidhje, -a ndërlidhje, -t	(f.)	liaison, communication(s)
ndërmjet	(prep. & adv.)	between; among
për t'u-ndjekur (unë ndiqem)	(v.)	to be followed, pursued
për ngut	(adv.)	in a hurry
pa	(particle)	a particle used with a verb in the imperative (first person singular and plural, only)
e papritur, -a të papritura, -t	(f.)	surprise, the unexpected
i, e, të përcjellur të përcjellura	(adj. m. & f.)	accompanied, escorted
plasë, -a plasa, -t	(f.)	crack
prapa	(adv. & prep.)	see "mbrapa"
praparojë, -a praparoja, -t	(f.)	rear guard

pykë, -a pyka, -t	(f.)	wedge
rrufe, -ja rrufe, -të	(f.)	thunderbolt
sasi, -a sasi, -të	(f.)	quantity
për t'u-spastruar (unë spastrohem)	(v.)	to be purged; to be mopped up
për t'u-shmangur (unë shmangem)	(v.)	to avoid, avert
veprim, -i veprime, -t	(m.)	action

## SHËNIME

për t'i (u) bërë ballë (unë i (u) bëj ballë)	(v.)	to confront; to afford
këmba-këmbës		closely, on the heels of...
pas krahësh		behind one's back
sa që		so that, that
shpejt e shpejt		hastily, quickly, in a hurry
me të shpejtë		hastily, quickly, in a hurry

DETYRË SHTËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:






1. Don't hurry! Take them out one by one.
2. I'm in charge for the maintenance of both buildings.
3. Most of the trucks run on diesel oil.
4. Look behind your back!
5. Go immediately and call the captain!
6. Po vete në pazar të blej një elektrik dore.
7. Të tëra dërrasat që blemë ishin të çara.
8. Nga plasa e murit shihej drita përjashta.
9. S'më ka detyruar njeri; e bëra me dëshirën time.
10. Shtëpisë së tij i ra rrufeja mbrëmë.

Mësimi i 103-të

KARVAN ANIJESH NË LUNDRIM

DIALOGU

1. Mirë Agim, ti më tregove ç'ngjau në operacionet tokësore....
2. Është e vërtetë. S'duhet të harrosh se unë jam ushtar i këmbësisë.
3. Desha të thoja në se ke bërë pjesë në ndonjë ekspeditë ushtarake në brigjet e armikut.
4. Po, kam marrë pjesë një herë në bashkëpunim me marinën, por mjerisht na u-desh të tërhiqemi.
5. A ish i madh karvani që ju shpuri në brigjet e armikut?
6. Po, përveç anijeve të transportit kish aeroplanbajtëse, destroyerë, torpediniera, dragamina, katera siluruese, anije cisternë etj.
7. A e dinin trupat kur u-nisën se ku do të shkonin?
8. Jo, vetëm admirali i flotës dhe shtabi i tij e dinin.
9. A gjeti karvani udhës ndonjë vështirësi?
10. Po, një anije cisternë hasi në një minë uji dhe pas pak minutash u-fundos pingul në fund të detit. Humbëm anijen dhe karburantin.
11. Ç'ngjau pastaj?
12. Pastaj na sulmoi një nëndetëse, por torpedinierat tona e fundosën menjëherë.
13. Si e morët vesh se u-fundos nëndetësja? Ajo sulmon nën ujë.
14. Nga dallgët që u-ngrenë drejt qiellit; pastaj dollën mbi ujë copa të nëndetëses, plaçka etj.
15. Do të ketë qenë një pamje e tmershme!
16. Po. Mjerisht as marinarët e cisternës sonë as ata të nëndetëses armike nuk patën kohë të përdornin mjete shpëtimi dhe të gjithë u-mbytën.
17. Kështu e ka lufta; dikush vdes e dikush shpëton. Shyqyr Perëndisë, ti je gjallë dhe shëndoshë e mirë.
18. Po, është shumë e vërtetë ajo që thua.





## LEXIM E PËRKTHIM

Agimi mori pjesë në një ekspeditë ushtarake që u-dërgua në brigjet e një shteti aleat për t'a çliruar atë shtet nga pushtimi i armikut. Kur arriti ekspedita aty, armiku kish qenë shkatërruar ose zënë rob; kështu që njësia, në të cilën bënte pjesë Agimi, pati rast të pushonte. Kjo njësi plotësoi gjithashtu edhe boshllëqet që kishin qenë shkaktuar nga luftimet e mëparshme. Kështu në pak kohë divizioni u-riorganizua dhe u-stërvit mirë.

Shtabi i komandës së përgjithëshme dha urdhër për një operacion të ushtrisë në bashkëpunim me marinën dhe divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi u-ngarkua në anijet e transportit. Karvani përbëhej nga anije aeroplanbajtëse, nga koracata, destroyerë, torpediniera, dragamina, katera siluruese, anije cisternë e anije tjera shoqëruese. Pasi çdo gjë ish përgatitur më së miri, karvani i luftanijeve dhe i anijeve të transportit u-nis. Kur ishin larguar nga bregu i detit dhe e kishin lënë skelen ca mila prapa, admirali, komandanti i këtij karvani, hapi zarfin e vulosur me dyllë të kuq, që përmbante urdhërat sekretë. Sipas urdhërave të marrur, karvani do të sulmonte një pikë në bregdetin e armikut dhe do të drejtohej nga ky objektiv sa më shpejt që të ish e mundur.

Një nga anijet e karvanit hasi në një minë që qëndron pezull në ujë dhe u-fundos pak para se t'i afrohej bregut. Ekipazhi dhe trupat që mbarte u-transportuan me barka në një anije tjetër dhe karvani vazhdoi udhën drejt misionit të vet.

Natën u-morën masa të ndryshme që të mos shihej karvani, si p.sh. u-shuan dritat që mund t'i shihte armiku, u-mbuluan mirë dritaret dhe u-hoq nga jashtë çdo gjë që mund të shkëlqente.

Me gjithë këtë, një nëndetëse e armikut e zbuloi karvanin dhe lajmëroi me radio komandën e bazës së vet. Nëndetësja u-mundua të qëllonte me torpilë një nga anijet e karvanit; mirëpo, jo vetëm që nuk e drejtoi mirë torpilën, por edhe u-zbulua. Kështu disa nga torpedinierat tona u-lëshuan menjëherë drejt pozicionit të nëndetëses armike. Torpedinierat e përcaktuan vendin ku gjendej nëndetësja me anën e një aparati të posaçëm që zbulon zhurmën, dhe kështu hodhën disa bomba që pëlcastin në thellësi. Një nga këto bomba e qëllloi keq nëndetësen, një pjesë e së cilës, para se të fundosej definitivisht, doli mbi sipërfaqen e ujit.

Kur karvani i u-afrua bregut të detit, nga aeroplanbajtëset u-ngritën fluturim një shumicë aeroplanash, të cilët bombarduan fortifikatat dhe instalimet e ndryshme të armikut.

## PYETJE

1. Kush mori pjesë në një ekspeditë ushtarake që u-dërgua në brigjet e një shteti aleat?
2. Ku u-dërgua ekspedita ushtarake, në të cilën mori pjesë Agimi?
3. Çfarë shteti ishte ai, në të cilin u-dërgua ekspedita ushtarake?
4. Pse u-dërgua ekspedita ushtarake në brigjet e shtetit aleat?
5. Nga pushtimi i kujt duhej shpëtuar shteti aleat?
6. Kush kish qenë shkatërruar ose zënë rob kur arriti ekspedita aty?
7. Ç'i kish ndodhur armikut kur arriti ekspedita ushtarake në brigjet e shtetit aleat?
8. Ç'njësi pati rast të pushonte?
9. Ç'pati rast të bënte njësia e Agimit?
10. Çfarë vendesh plotësoi kjo njësi?
11. Ç'u kish ndodhur ca vendeve që plotësoi njësia e Agimit?
12. Kur ishin shkaktuar ca boshllëqe?
13. Ç'kish ndodhur gjatë luftimeve të mëparshme?
14. Cili divizion u-riorganizua dhe u-stërvit mirë?
15. Ç'bëri divizioni, në të cilin bënte pjesë Agimi, në pak kohë?
16. Shtabi i cilës komandë dha urdhër për një operacion të ushtrisë në bashkëpunim me marinën?
17. Ç'urdhër dha shtabi i komandës së përgjithëshme?
18. Në bashkëpunim me kë do të bënte një operacion ushtria?
19. Si do t'a bënte ushtria operacionin?

20. Në ç'anije u-ngarkua divizioni ku bënte pjesë Agimi?
21. Ç'u-ngarkua në anijet e transportit?
22. Në çfarë anijesh u-ngarkua divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi?
23. Nga çfarë anijesh përbëhej karvani?
24. Ç'përbëhej nga anije aeroplanbajtëse, nga koracata, destroyerë, torpediniera, dragamina, katera siluruese, anije cisternë e anije shoqëruese?
25. Si ish përgatitur çdo gjë?
26. Ç'ish përgatitur më së miri?
27. Ç'ndodhi pasi çdo gjë u-përgatit më së miri?
28. Kur u-nis karvani i luftanijeve dhe i anijeve të transportit?
29. Kush e hapi zarfin e vulosur me dyllë të kuq?
30. Ç'bëri admirali kur ishin larguar nga bregu i detit dhe e kishin lënë skelen ca mila prapa?
31. Ç'gradë kish komandanti i karvanit?
32. Cili zarf përmbante urdhëra sekretë?
33. Me çka ish vulosur zarfi që përmbante këta urdhëra?
34. Kur e hapi admirali zarfin me urdhërat sekretë?
35. Ç'do të sulmonte karvani sipas urdhërave të marrur?
36. Sa pika dhe në ç'bregdet do të sulmonte ky karvan?
37. Nga ç'objektiv ish i urdhëruar të drejtohej karvani sa më shpejt që të ish e mundur?
38. Kur duhej të drejtohej karvani nga ky objektiv?
39. Ç'duhej bërë sa më shpejt që të ish e mundur?
40. Cila anije hasi në një minë që qëndron pezull në ujë?

41. Ç'i ngjau njerës nga anijet e karvanit pak para se t'i afrohej bregut?
42. Në çfarë mine hasi njera nga këto anije?
43. Cila anije u-fundos?
44. Kush dhe çka u-transportua me barka në një anije tjetër?
45. Me çfarë mjetesh u-transportuan ekipazhi dhe trupat që mbarte anija?
46. Drejt cilit mision e vazhdoi udhën karvani?
47. Ç'masa u-morën natën që të mos shihej karvani?
48. Pse u-morën masa të ndryshme?
49. Pse u-shuan dritat natën?
50. Si u-mbuluan dritaret?
51. Nga ku u-hoq çdo gjë që shkëlqente?
52. Ç'u-hoq nga jashtë?
53. Me gjithë këtë, ç'e zbuloi karvanin dhe me radio lajmëroi komandën e bazës së vet?
54. Ç'bëri nëndetësja e armikut pasi e zbuloi karvanin?
55. Me çka e lajmëroi ajo komandën e bazës së vet?
56. Ç'u-mundua të qëllonte me torpilë nëndetësja e armikut?
57. Si e drejtoi torpilën ajo nëndetëse?
58. Ç'i ngjau nëndetëses armike pasi nuk e drejtoi mirë torpilën?
59. Cila nëndetëse u-zbulua nga karvani ynë?
60. Cilat torpediniera e përcaktuan vendin ku gjendej nëndetësja e armikut?
61. Me çfarë aparati e zbuluan zhurmën dhe përcaktuan vendin torpedinierat tona?

62. Çfarë bombash hodhën torpedinierat tona kundër nëndetëses armike?
63. Cilat bomba pëlcastin në thellësi?
64. Cila bombë e qëllloi keq nëndetësen e armikut?
65. Ç'dolli mbi sipërfaqen e ujit para se të fundosej definitivisht kjo nëndetëse?
66. Ç'bëri një pjesë e nëndetëses para se të fundosej definitivisht?
67. Nga u-ngritën fluturim një shumicë aeroplanash?
68. Ç'ngjau kur karvani i u-afrua bregut të detit?
69. Kur u-ngritën fluturim aeroplanat nga aeroplanbajtëset?
70. Ç'bombarduan aeroplanat që u-ngritën fluturim nga aeroplanbajtëset?
71. Cilët aeroplana bombarduan fortifikatat dhe instalimet e ndryshme të armikut?

## FJALOR

admiral, -i admirala, -t	(m.)	admiral
aeroplanbajtëse, aeroplanbajtësja aeroplanbajtëse, -t	(f.)	aircraft carrier
aleat, -e	(adj. m. & f.)	allied
armik, -e armiq	(adj. m. & f.)	enemy
boshllëk, -u boshllëqe, -t	(m.)	vacuum, emptiness
i, e, të cekët të cekta	(adj. m. & f.)	shallow
për të çliruar (unë çliroj)	(v.)	to liberate
definitivisht	(adv.)	definitely, definitively, permanently
destrojer, -i destrojerë, -t	(m.)	destroyer
dragaminë, -a dragamina, -t	(f.)	mine sweeper, mine layer
ekipazh, -i ekipazhe, -t	(m.)	crew (of a ship or an airplane only)
ekspeditë, -a ekspedita, -t	(f.)	expedition
flotë, -a flota, -t	(f.)	fleet
fluturim	(adv.)	in flight; hurriedly

për të fundosur (unë fundos)	(v.)	to sink
për t'u-hequr (unë hiqem)	(v.)	to be removed
instalim, -i instalime, -t	(m.)	installation, installing; building
karburant, -i karburante, -t	(m.)	fuel
keq	(adv.)	see "keqas"
për t'u-lëshuar (unë lëshohem)	(v.)	to be released; to attack, charge, go for
luftanije, -a luftanije, -t	(f.)	warship
lundrim, -i lundrime, -t	(m.)	navigation, sailing
i, e, të marrur të marrura	(adj. m. & f.)	received, taken
për të mbartur (unë mbar)	(v.)	see "me bajtë"
për t'u-mbuluar (unë mbulohem)	(v.)	to cover oneself, to be covered
i, të mëparshëm e, të mëparshme	(adj. m. & f.)	previous, former
milë, -a mila, -t	(f.)	mile
nëndetëse, nëndetësja nëndetëse, -t	(f.)	submarine
për t'u-ngarkuar (unë ngarkohem)	(v.)	to be loaded; to be put in charge



njollë, -a njolla, -t	(f.)	spot, stain
i, të panevojshëm e, të panevojshme	(adj. m. & f.)	unnecessary
për t'u-përbërë (unë përbëhem)	(v.)	to be formed, to be made up (of)
për të përcaktuar (unë përcaktoj)	(v.)	to define; to pinpoint, to identify (with precision)
pingul	(adv.)	vertically
për të plotësuar (unë plotësoj)	(v.)	to complete, fulfill, fill out
pushtim, -i pushtime, -t	(m.)	occupation, invasion
për t'u-riorganizuar (unë riorganizohem)	(v.)	to be reorganized
shëndoshë	(adv.)	healthy, fit, sound (in health)
për t'u-shkaktuar (shkaktohet)	(v.)	to be caused
shoqërues, -e	(adj. m. & f.)	escort, accompanying
për t'u-shuar (unë shuhem)	(v.)	to be extinguished, put out; to be erased, effaced; to be wiped out
i, të tmershëm e, të tmershme	(adj. m. & f.)	terrible
torpedinierë, -a torpediniera, -t	(f.)	torpedo-boat destroyer
torpilë, -a torpila, -t	(f.)	torpedo

për t'u-transportuar (unë transportohem)	(v.)	to be transported
thellësi, -a thellësi, -të	(f.)	depth
udhës	(adv.)	see "rrugës"
i, të vulosur e, të vulosura	(adj. m. & f.)	sealed; rubber stamped

#### SHËNIME

anije cisternë	(f.)	oil tanker
katerë siluruese katera siluruese	(f.)	PT boat (a very small one)
më së miri		very well, excellently
mjete shpëtimi		life preservers, lifesaving means
sa më shpejt		as soon as possible

#### DETYRË SHTEPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. We need his collaboration; otherwise we can't do a thing.
2. The United States of America have more aircraft carriers than any other country in the world.
3. This river is shallow; I think we can cross it.
4. I left it right here; where is it?
5. Cover yourself because it's cold.
6. I have seen submarines in this bay many times.

7. He was put in charge of this job.
8. You have a spot on your coat. You had better go and change coats.
9. I completed it even though it was unnecessary.
10. Last night the lights went out for half an hour.

L. 103


DËSHTIMI I ZBARKIMIT

DIALOGU

1. Hej Agim! Më trego si qe puna që dështoi zbarkimi.
2. Kur arriti karvani i anijeve afër një limani, artileria detare filloi të bombardonte instalimet e bregut.
3. Si mund të dalloheshin instalimet nga anijet?
4. Shtirjet i rregullonin sipas njoftimeve që jepnin aeroplanat që fluturonin mbi instalimet.
5. Pasi u-krye kjo fazë, si vepruat?
6. Njësitë e para zbarkuan dhe menjëherë pushtuan një rryp toke.
7. Ç'njësi zbarkuan pas tyre?
8. Trupa në masë dhe tanke. Njëkohësisht nga aeroplanbajtëset u-çuan bombardues.
9. Gjer këtu duket se paska shkuar mirë.
10. Po, por këtu filloi pengesa e parë: forcat e kryeurës ndeshën në një fushë të minuar, gjë që i shkaktoi vonesë të shkuarit përpara.
11. Natyrisht armiku pati kohë të organizohej dhe të sillte forcat e nevojshme për të zbrapur invadimin.
12. Po, tamam ajo ngjau. Në zonën e limanit armiku solli trupa, tanke dhe artileri dhe në pak orë forcat tona u-detyruan të tërhiqeshin me humbje.
13. Si u-bë tërheqja?
14. Në rregull. Ndër anije personeli mjeksor pati mjaft punë me të plagosurit: dikujt i bënë operacion, dikujt shiringë dhe dikë mjekonin.
15. Me fjalë tjera invadimi dështoi.
16. Jo, nuk është për t'u-quajtur dështim. Më vonë morëm vesh se ne kishim pasë zbarkuar vetëm për diversion.

L. 104

17. Nuk e kuptoj, spiegoju më mirë.
18. D.m.th. ne kishim zbarkuar në atë vend me qëllim që të tërhiqnim vemendjen dhe një pjesë të forcave të armikut.
19. Kurse invadimi kryesor po bëhej gjetiu.
20. Pikërisht; dhe zona që u-pushtua qe pothuaj e pambrojtur.



## LEXIM E PËRKTHIM

Karvani i anijeve arriti në vendin ku duhej të zbarkonte. Në këtë operacion zbarkimi, forcat tona detare u-orientuan në bazë të fotografive që i ishin bërë bregut të detit nga aeroplana vëzhgues. Artileria detare filloi të bombardonte instalimet e bregut të detit, duke i rregulluar shtirjet në bazë të informatave që i jepnin me radio aeroplanat vëzhgues. Njësitë e para të forcave të zbarkimit zbarkuan nga anijet dhe pushtuan një rryp toke në breg të detit duke formuar kështu një kryeurë. Posa u-sigurua kryeura, një oficer u-ngarkua me detyrën e komandantit të forcave zbarkuese. Nga anijet e transportit u-shkarkuan gjithashtu tanke e trupa për t'u ardhë në ndihmë forcave të para që kishin zbarkuar. Nga anijet aeroplanbajtëse u-çuan bombardues me qëllim që të ndihmonin forcat e kryeurës dhe të bombardonin objektive që duheshin shkatërruar sa më parë. Ky bombardim u-bë në bazë të kërkesave të oficerëve ndërlihdës në tokë. Forcat tona ndeshën në një fushë të minuar, por minat u-zbuluan me anë të një aparati të posaçëm magnetik. Pasi u a hoqën kapsollat minave, njësitë tona vajtën përpara.

Me qëllim që të zmbapte invadimin, armiku solli me shpejtësi të madhe trupa, tanke dhe artileri në zonën e limanit. Komanda e forcave invaduese u dha urdhër trupave që të tërhiqeshin.



Tërheqja e trupave qe e rregullt dhe pa humbje të mëdha. Duke pasur një plan të mirë shtirjesh dhe duke e zbatuar atë me përpikni, trupat tona e përmbajtën armikun për një kohë të shkurtër. Në këtë ndërkohë trupat tona mundën të hypnin përsëri ndër anije dhe karvani mori udhën nga kish ardhur. Të plagosurit u-mjekuan nga infermierët dhe mjekët që ishin ndër anije.

Ndërsa karvani ish në lundrim e sipër, trupat u-njoftuan me anë të një radiogrami se sulmi i tyre nuk ish për t'u-konsideruar dështim, sepse zbarkimi kryesor në tokën e armikut ish kryer gjetiu me sukses dhe se zbarkimi ynë ish bërë për të gënjyer dhe për të hutuar armikun. Me fjalë tjera ky sulm ish bërë për diversion. Në këtë mënyrë një pjesë e madhe e forcave të armikut u-suall në limanin ku "dështoi" zbarkimi, dhe si pasojë, forcat e sulmit kryesor nuk gjetën veçse një qëndresë fare të dobët.

PYETJE

1. Në ç'vend arriti karvani i anijeve?
2. Ç'bëri karvani i anijeve?
3. Cilat forca u-orientuan në këtë operacion zbarkimi në bazë të fotografive që i ishin bërë bregut të detit nga aeroplanat vëzhgues?
4. Çfarë operacioni ish ky?
5. Në bazë të çfarë fotografish u-orientuan forcat tona?
6. Në ç'vend kishin bërë fotografi aeroplanat vëzhgues?
7. Çfarë aeroplanash i kishin bërë fotografi bregut të detit?
8. Cila artileri filloi të bombardonte instalimet e bregut të detit?
9. Ç'filloi të bënte artileria detare?
10. Cilat instalime filloi të bombardonte artileria detare?
11. Në bazë të cilave informata i rregullonte artileria detare shtirjet?
12. Ç'bënte artileria navale në bazë të informatave që i jepnin me radio aeroplanat vëzhgues?
13. Me çfarë mjeti i jepnin aeroplanat vëzhgues informatat?
14. Ç'i jepnin aeroplanat me radio artilerisë navale?
15. Pse i jepnin aeroplanat artilerisë navale informata me radio?
16. Njësitë e para të cilave forca zbarkuan nga anijet?
17. Nga ku zbarkuan njësitë e para të forcave të zbarkimit?
18. Ku pushtuan ato një rryp toke?
19. Ç'bënë ato në breg të detit?

20. Ç'formuan ato pasi pushtuan një rryp toke në breg të detit?
21. Kush u-ngarkua me detyrën e forcave zbarkuese posa u-formua kryeura?
22. Me ç'detyrë u-ngarkua një oficer?
23. Kur u-ngarkua një oficer me komandën e trupave zbarkuese?
24. Nga cilat anije u-shkarkuan gjithashtu tanke e trupa?
25. Pse u-shkarkuan tanke e trupa nga anijet e transportit?
26. Cilave forca duhej t'u vinin në ndihmë tanket dhe trupat që zbarkuan?
27. Nga cilat anije u-çuan bombardues me qëllim që të ndihmonin forcat e kryeurës?
28. Pse u-çuan bombardues nga anijet aeroplanbajtëse?
29. Cilat forca do të ndihmonin ata bombardues?
30. Ç'objektive do të bombardonin bombarduesit që u-çuan nga anijet aeroplanbajtëse?
31. Kur duheshin shkatërruar objektivet që bombarduan aeroplanat?
32. Ç'duhej bërë sa më parë me këto objektive armike?
33. Në bazë të kërkesave të cilëve oficerë u-bë ky bombardim?
34. Ç'u-bë në bazë të kërkesave të oficerëve ndërlidhës në tokë?
35. Cilat forca ndeshën në një fushë të minuar?
36. Në çka ndeshën forcat tona?
37. Me anë të çfarë aparati e diktuan forcat tona fushën e minuar?
38. Ç'zbuluar forcat tona me anë të një aparati të posaçëm magnetik?
39. Kur vajtën njësitë tona përpara?

40. Ç'bënë njësitë tona pasi u a hoqën kapsollat minave?
41. Kush solli në zonën e limanit trupa, tanke dhe artileri?
42. Pse solli armiku në zonën e limanit trupa, tanke dhe artileri?
43. Si i solli armiku në zonën e limanit trupat, tanket dhe artilerinë?
44. Cila komandë u dha urdhër trupave që të tërhiqeshin?
45. Ç'urdhër u dha trupave komanda e forcave invaduese?
46. Si qe tërheqja e trupave?
47. A pati humbje të mëdha tërheqja e trupave?
48. Kë përmbajtën trupat tona duke pasur një plan të mirë shtirjesh?
49. Ç'plan zbatuan me hollësi trupat tona që qenë në gjendje t'a përmbanin armikun?
50. Për sa kohë mundën t'a përmbanin armikun ato?
51. Kur mundën të hypnin ndër anije trupat tona?
52. Ç'bënë në këtë ndërkohë trupat tona?
53. Nga e mori udhën karvani pasi hypën trupat ndër anije?
54. Kush u-mjekua nga infermierët dhe nga mjekët që ishin ndër anije?
55. Kush i mjekoi të plagosurit?
56. Kush u-njoftua se sulmi nuk ish për t'u-konsideruar dështim?
57. Ku ish karvani kur u-njoftuan trupat se sulmi i tyre nuk ish për t'u-konsideruar dështim?
58. Me çfarë mjeti u-njoftuan trupat se sulmi i tyre s'ish për t'u-konsideruar dështim?
59. Në ç'vend ish kryer zbarkimi kryesor?

60. Si ish kryer zbarkimi kryesor në tokën e armikut?
61. Për të gënjyer dhe për të hutuar kë, ish bërë sulmi kryesor gjetiu?
62. Ç'sulm ish bërë për të gënjyer dhe për të hutuar armikun?
63. Me fjalë tjera, ç'sulm ish bërë për diversion?
64. Për çfarë qëllimi ish bërë sulmi në bregun e detit?
65. Ku u-suall një pjesë e madhe e forcave të armikut?
66. Ç'u-suall në limanin ku "dështoi" zbarkimi?
67. Kush e solli një pjesë të madhe të forcave të veta në limanin ku "dështoi" zbarkimi?
68. Si pasojë, cilat forca nuk gjetën veçse një qëndresë fare të dobët?
69. Çfarë qëndrese gjetën forcat e sulmit kryesor aty ku sulmuan?
70. Pse gjetën një qëndresë fare të dobët forcat e sulmit kryesor?

## FJALOR

dështim, -i dështime, -t	(m.)	failure; miscarriage
për të dështuar (unë dështoj)	(v.)	to fail; to miscarry
diversion, -i diversione, -t	(m.)	diversion (mil.)
i, e, të dobët të dobta	(adj. m. & f.)	weak, frail; poor (quality); bad; wicked
invadues, -e	(adj. m. & f.)	invading
kapsollë, -a kapsolla, -t	(f.)	fuse (of explosives only)
kërkesë, -a kërkesa, -t	(f.)	request, demand
për t'u-konsideruar (unë konsiderohem)	(f.)	to be considered
magnetik, -e	(adj. m. & f.)	magnetic
masë, -a masa, -t	(f.)	mass (of people)
i, e, të minuar të minuara	(adj. m. & f.)	mined
për të ndeshur (unë ndesh)	(v.)	to collide, encounter, bump into; to meet
ndërlidhës, -e	(adj. m. & f.)	liaison, communication
njoftim, -i njoftime, -t	(m.)	notification, communication; information

për t'u-orientuar (unë orientohem)	(v.)	to be oriented
i, e, të pambrojtur të pambrojtura	(adj. m. & f.)	unprotected, undefended
pasojë, -a pasoja, -t	(f.)	consequence
për t'u-pushtuar (pushtohet)	(v.)	to be invaded, occupied, conquered
radiogram, -i radiograme, -t	(m.)	radiogram
i, e, të rregullt të rregullta	(adj. m. & f.)	orderly, regular
për t'u-shkarkuar (unë shkarkohem)	(v.)	to be unloaded; to be discharged, released
të shkuar, -it	(neuter)	going
vemendje, -a	(f.)	attention
zbarkues, -e	(adj. m. & f.)	landing
për të zbatuar (unë zbatoj)	(v.)	to carry out, execute

## SHËNIM

për të tërhequr vemendjen (unë tërheq vemendjen)	to draw one's attention
---	----------------------------

DETYRË SHTEPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. The wounded were taken to the hospital.
2. He's very weak. I don't think he can walk anymore.
3. The bank refused my request for a loan.
4. You should look for it elsewhere. I don't think you'll find it here.
5. She is a nurse in an army hospital.
6. Po të kish ardhur më heret s'do të kisha vajtur fare.
7. Me anë të kësaj letre ju falënderoj për mikpritjen tuaj.
8. Udhëtarët një nga një filluan të zbresin nga aeroplani.
9. Do të shikoj gjetiu se mos e gjej.
10. Këto janë pasojat e sjelljes së tij.



## Mësimi i 105-të






### TRUPA PARASHUTISTËSH PRAPA VIJAVE TË FRONTIT

#### DIALOGU

1. Zoti Nëntoger, a jeni ju një nga parashutistët që morën pjesë në invadimin kryesor?
2. Po, kam qenë kryetar toge.
3. M'a përshkruani fazën e parë të invadimit, ju jutem.
4. Puna e parë që na u-paraqit pasi ramë në tokë që të liroheshim nga parashutat dhe të organizoheshim.
5. Me ç'mision u-ngarkua toga juaj?
6. Toga ime s'kish ndonjë mision të veçantë; tri kompani parashutistësh kishin një mision të përbashkët.
7. Atë mision dua të dij.
8. Të sulmonim dhe të shkatërronim një kryqëzim rrugësh që ish qendër komunikacionesh me rëndësi dhe pastaj të pushtonim aeroportin.
9. Si vajti puna?
10. Gjer në kryqëzim të rrugëve mirë, dhe udhës shkatërruam çdo gjë që kish vlerë ushtarake.
11. Ç'ngjau pastaj?
12. Ndërsa po drejtoheshim nga fusha e aeroplanave toga u-gjend para një mitralozi të rëndë të vënë në pozicion në një kullë.
13. A ish e mundur t'a shkatërronit me bomba dore?
14. Jo, ishim larg dhe zona ish fushë e nuk ish e mundur t'i afroheshim kullës.
15. Ç'bëtë atëhere?
16. Caktova vendin se ku gjendej kulla dhe i a njoftova me radio njësisë sime, duke kërkuar që t'a qëllonin me mortaja.
17. Pse donit t'a pushtonit fushën e aeroplanave?
18. Ai ish thelbi i misionit tonë ; pas dy orësh aty zbritën me qindra aeroplanash që sillnin trupa dhe armë.

L. 105

19. Tri kompani pushtuan fushën e aviacionit?
20. Po, duhej t'a pushtonim pa tjetër.



## LEXIM E PËRKTHIM

Sulmi kryesor u-krye nga trupa parashutistësh të hudhur prapa vijave të armikut në një zonë të caktuar më parë. Ky lloj invadimi bëhet nga trupa të stërvitura mirë, dhe ushtarët e këtyre trupave janë të zgjedhur për vetitë e shumta që kanë: guxim, gjakftohtësi dhe forcë fizike. Zakonisht, parashutistët përbëjnë një degë të këmbësorisë.

Parashutistët pasi u-hodhën nga aeroplanat e transportit, ranë në tokë dhe u-organizuan. Pas organizimit ata sulmuan një qendër komunikacionesh dhe kryqëzim rrugësh me rëndësi. Rrugës ata shkatërruan çdo gjë që paraqiste një objektiv ushtarak: shtylla dhe tela telefoni e telegrafi, instalime e fortifikata të ndryshme etj. Pastaj pushtuan fushën e aviacionit.

Në aerodrom filluan të arrinin trupat kryesore të invadimit me armë dhe material të nevojshëm, kurse helikopterat filluan të transportonin të plagosurit, të cilët silleshin aty në vigje ose kaliqafë. Transportimi në masë i trupave ish i organizuar në mënyrë që të mos kish kurrë ndërprerje; aeroplanat e transportit ishin të shoqëruar vazhdimisht nga aeroplana luftues.

Një nga togat tona që shkante përpara ndeshi në një pengesë serioze: armiku kish vendosur një mitraloz të rëndë në një

pozicion brenda një kulle dhe nuk e lejonte togën të shkonte më tej. Komandanti i togës caktoi vendin ku gjendej kulla, lajmëroi me radio njësinë e tij prapa dhe kërkoi që t'a qëllonin me mortaja. Predhat e mortajave, të drejtuara sipas njoftimeve që dha komandanti i togës, e hodhën kullën në ajr. Kështu, pasi u-sheshua udha, toga vazhdoi të përparonte.

PYETJE

1. Cili sulm u-krye nga trupa parashutistësh?
2. Nga kush u-krye sulmi kryesor?
3. Ç'u-krye nga trupat e parashutistëve?
4. Prapa cilave vija u-hodhën trupat e parashutistëve?
5. Kur ish caktuar zona në të cilën u-hodhën trupat e parashutistëve?
6. Ç'ish caktuar më parë prapa vijave të armikut?
7. Si duhet të jenë trupat e parashutistëve që bëjnë këtë lloj invadimi?
8. Për çfarë vetish duhet të zgjidhen ushtarët e këtyre trupave?
9. Cilët duhet të zgjidhen për veti të shumta?
10. Ç'veti duhet të kenë parashutistët?
11. Kush duhet të ketë guxim, gjakftohtësi dhe forcë fizike?
12. Vetitë e cilëve ushtarë janë guximi, gjakftohtësia dhe forca fizike?
13. Cilët përbëjnë zakonisht një degë të këmbësisë?
14. Në ç'degë bëjnë pjesë parashutistët?
15. Ç'bënë parashutistët pasi ranë në tokë?
16. Nga cilët aeroplana u-hodhën parashutistët?
17. Kur u-organizuan ata?
18. Çfarë qendre sulmuan pasi u-organizuan?
19. Cilët sulmuan një qendër komunikacionesh dhe një kryqëzim rrugësh me rëndësi?
20. Ç'rëndësi kish vendi që sulmuan parashutistët?

21. Ç'i bënë ata çdo gjëje që paraqiste vlerë ushtarake?
22. Ç'shkatërrouan ata rrugës?
23. Cilët shkatërrouan shtylla dhe tela telefoni e telegrafi, instalime e fortifikata të ndryshme etj.?
24. Ç'paraqitin shtyllat, telat e telefonit dhe të telegrafit, instalimet e fortifikatat e ndryshme gjatë luftimeve?
25. Ç'u duhet bërë këtyre objekteve ushtarake?
26. Kur e pushtuan parashutistët fushën e aviacionit?
27. Ç'fushë pushtuan pastaj parashutistët?
28. Ç'trupa filluan të arrinin në aerodrom?
29. Ç'filluan të bënë trupat kryesore të invadimit me armë dhe material të nevojshëm?
30. Ç'kishin me vete trupat kryesore të invadimit që arritën në aerodrom?
31. Kë filluan të transportonin helikopterat?
32. Me çfarë mjetesh filluan të transportoheshin të plagosurit?
33. Si silleshin të plagosurit në aerodrom?
34. Cilët silleshin në aerodrom në vigje ose kaliqafë?
35. Si ish organizuar transportimi në masë i trupave?
36. Cili transportim ish organizuar në mënyrë që të mos kish kurrë ndërprerje?
37. Çka nuk duhej të kish kurrë transportimi i trupave?
38. Nga ç'aeroplana ishin të shoqëruar aeroplanat e transportit?
39. Ç'bënin aeroplanat luftues?
40. Si i shoqëronin aeroplanat luftues aeroplanat e transportit?
41. Cila nga togat tona ndeshi në një pengesë serioze?

42. Ç'i ngjau njerës nga togat tona që shkonte përpara?
43. Çfarë pengese ishte ajo, në të cilën ndeshi toga që shkonte përpara?
44. Ç'mitraloz kish vendosur armiku në pozicion brenda një kulle?
45. Ku kish vendosur armiku një mitraloz të rëndë?
46. Çka nuk e lejonte togën të shkonte më tej?
47. Kush e caktoi vendin ku gjendej kulla?
48. Kush e lajmëroi me radio njësinë e vet se ku gjendej kulla?
49. Me çfarë mjeti e lajmëroi komandanti njësinë e vet se ku gjendej kulla?
50. Ku gjendej njësia, të cilën e lajmëroi komandanti?
51. Ç'kërkoi komandanti nga njësia e vet?
52. Me çfarë arme do t'a qëllonte njësia kullën?
53. Ç'do të qëllonte me mortaja njësia që gjendej prapa?
54. Cilat predha e hodhën kullën në ajr?
55. Ç'bënë predhat e drejtuara sipas njoftimeve që dha komandanti i togës?
56. Sipas njoftimeve të kujt u-drejtuat predhat që hodhën kullën në ajr?
57. Nga se u-sheshua udha?
58. Ç'bëri toga pasi u-sheshua udha?
59. Kur vazhdoi të përparonte toga?
60. Ç'veti duhet të ketë një parashutist?
61. A keni mbartur ndonjë herë njeri në vig ose kaliqafë?



62. Kush ju shoqëronte në shkollë kur ishit i vogël?
63. A e sheshojnë punëtorët vendin para se të fillojnë ndërtimin e një shtëpie?

## FJALOR

i, e, të drejtuar të drejtuara	(adj. m. & f.)	directed; straightened
guxim, -i	(m.)	courage, guts
gjakftohtësi, -a	(f.)	calmness; cold-bloodedness
helikopter, -i helikoptera, -t	(m.)	helicopter
i, e, të hudhur të hudhura	(adj. m. & f.)	thrown, tossed, cast
kaliqafë	(adv.)	piggyback
luftues, -e	(adj. m. & f.)	fighting
ndërprerje, -a ndërprerje, -t	(f.)	interruption
parashutist, -i parashutistë, -t	(m.)	parachutist, paratrooper
i, e, të stërvitur të stërvitura	(adj. m. & f.)	trained; experienced
për t'u-sheshuar (sheshohet)	(v.)	to be leveled, flattened
i, e, të shoqëruar të shoqëruara	(adj. m. & f.)	accompanied, escorted
shtyllë, -a shtylla, -t	(f.)	pole, pillar, column
tej	(prep.)	beyond
(më) tej	(adv.)	farther, further
telegraf, -i telegrafe, -t	(m.)	telegraph

transportim, -i transportime, -t	(m.)	transportation
për të transportuar (unë transportoj)	(v.)	to transport
thelb, -i thelbe, -t	(m.)	pit, kernel; the meat of a nut; essence; core
i, e, të vënë të vëna	(adj. m. & f.)	put, laid

## SHËNIME

aeroplana luftues	fighter planes
kryqëzim rrugësh	crossroad, intersection, junction

## DETYRË SHTRËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. His calmness surprised everybody.
2. He talked for two hours without interruption.
3. They were escorted by two policemen; they must have done something wrong.
4. They are putting new telephone poles on the main street.
5. He didn't have guts to tell him.
6. They have put signal lights at this intersection recently.
7. Don't go any farther; it's dangerous.
8. We are trained for this kind of work.
9. I had to carry him piggyback because he couldn't walk.
10. Our forces have advanced beyond that river.

L. 105

Mësimi i 106-të






ARRESTIMI DHE EKZEKUTIMI I NJË SPIUNI

DIALOGU

1. Hej Hasan! Pse vishe me rrobe civile gjatë orëve të shërbimit?
2. Tani jam i ngarkuar me shërbim të posacëm në Forcat e Zbulimit.
3. Ç'mision kanë këto forca?
4. Të ndjekin spiunët, sabotatorët, diversantët dhe armiqtë tjerë të atdheut; me pak fjalë të jenë vigjilentë.
5. A ekziston ndonjë rjetë spiunazhi këtu në këtë zonë?
6. Si jo! Tani së fundi kemi zbuluar një rjetë shumë të rëndësishme për armikun, anëtarët e së cilës mbledhnin informata dhe sabotonin.
7. Si e zbuluat?
8. Nuk mund të ju a them të gjitha, por vetëm ato që dihen botërisht; a nuk e keni ndjekur gjyqin e fundit?
9. Jo, më trego po të jetë e mundur se më intereson.
10. Patëm njoftime se në një laborator u-zhdukën ca dokumenta e projekte me rëndësi. Gjithashtu na dhanë edhe emrat e ca personave të dyshimtë.
11. A ishin njerëz që vinin nga jashtë posaçërisht për të vjedhur dokumenta?
12. Jo, të papunëve u ish e ndaluar hyrja në laborator.
13. Po si atëherë?
14. Vendosëm një aparat televizioni dhe pamë një nëpunës duke fotografuar ca shkresa.
15. A e arrestuat?
16. Jo. E ndoqëm gjer në bibliotekë. Aty vuri dokumenta në një libër; pastaj një tjetër erdhi dhe i mori.
17. Pastaj?
18. E ndoqëm edhe këtë gjer në shtëpi dhe pasi kontrolluam shtëpinë gjetëm një aparat radiodhënës.

L. 106

19. Natyrisht nuk është e kollajtë të gjenden të gjitha provat pasi punët e spiunazhit janë të ndërlikuara.
20. Pasi mblodhëm provat i arrestuam dhe i dërguam në gjyq ushtarak.
21. Ç'vendim mori gjyqi?
22. Njerin e dënuan me pushkatim dhe dy tjerët u-dënuan më vonë me burgim të përjetshëm.



## LEXIM E PËRKTHIM

Kur u-kthye në bazë karvani i luftanijeve dhe anijeve të transportit, njësia në të cilën bënte pjesë Agimi u-caktua me shërbim të posaçëm si Forcë Zbulimi në një zonë komunikacioni. Aty vepronte një rjetë spiunazhi që mblidhte gjithfarë lloj informatash në favor të armikut dhe sabotonte përpjekjet e luftës në atë zonë.

Në një laborator, që kish në projekt zbulime me rëndësi, u-fsheh një aparat televizioni, me anë të të cilit u-pa duke marrë në fotografi dokumenta sekretë një nga ata që dyshohej si spiun. Agjentët tonë të Forcave të Zbulimit nuk e arrestuan aty-për-aty, por e ndoqën gjer në bibliotekë. Aty njeriu i dyshimtë ra në kontakt me një tjetër, jo drejtpërdrejt, por duke përdorur librat në raft. Edhe ky i fundit, si i dyshimtë, u-ndoq nga agjentë tjerë, të cilët e panë duke hyrë në një ndërtesë, në të cilën, siç u-muar vesh më vonë, ish në veprim një stacion transmetues (stacion radiodhënës) i armikut. Një spiun i tretë u-zu flagrant duke marrë fotografi në një zonë instalimesh ushtarake, rreth së cilës ish i ndaluar të sjellurit e të papunëve.

Me kapjen e tre spiunëve dhe me zbulimin e stacionit radiodhënës kjo rjetë spiunazhi mori fund. Një nga spiunët u-suall për gjykim para gjyqit ushtarak. Gjykatësit, pasi



shqyrtuan akt-akuzën, dëgjuan dëshmitarët dhe, pasi peshuan rrezikun që mund të kish pasur atdheu nga vepra e tij, e dënuan të akuzuarin me vdekje me pushkatim pas shpine. Vendimin e gjyqit e zbatoi të nesërmen, në të zbardhur të dritës, një skuadër pushkatarësh.

Dy të tjerët u-dënuan më vonë me burgim të përjetshëm.

PYETJE

1. Ç'bëri karvani i anijeve dhe i anijeve të transportit?
2. Cili karvan u-kthye në bazë?
3. Me çfarë shërbimi u-caktua njësia në të cilën bënte pjesë Agimi kur u-kthye në bazë ky karvan?
4. Cila njësi u-caktua me shërbim të posaçëm si Forcë Zbulimi?
5. Kur u-caktua njësia e Agimit me shërbim të posaçëm si Forcë Zbulimi në një zonë komunikacioni?
6. Në ç'zonë u-caktua ajo njësi si Forcë Zbulimi?
7. Si çfarë force u-caktua të shërbente në një zonë komunikacioni njësia e Agimit?
8. Çfarë rjete vepronte në atë zonë?
9. Çfarë informatash mblidhte rjeta e spiunazhit që vepronte në atë zonë?
10. Ç'bënte rjeta e spiunazhit në atë zonë?
11. Në favor të kujt i mblidhte informatat rjeta e spiunazhit?
12. Çfarë përpjekjesh sabotonte ajo rjetë në atë zonë lufte?
13. Ku i sabotonte ajo rjetë përpjekjet tona të luftës?
14. Ç'informata mblidhte dhe ç'sabotonte rjeta e spiunazhit që vepronte në atë zonë komunikacioni?
15. Ç'u-fsheh në një laborator që kish projekte me rëndësi?
16. Ku u-fsheh një aparat televizioni?
17. Kush u-pa me anë të televizionit duke marrë në fotografi dokumenta sekretë?
18. Çfarë dokumentash ish duke marrë në fotografi një nga ata që dyshohej si spiun.

19. Në ç'vend ish duke i marrë në fotografi dokumentat sekretë një nga ata që dyshohej si spiun?
20. A e arrestuan aty-për-aty agjentët tonë të Forcave të Zbulimit?
21. Kë nuk arrestuan aty-për-aty agjentët tonë të Forcave të Zbulimit?
22. Gjer ku e ndoqën ata njeriun e dyshimtë?
23. Kë ndoqën ata gjer në bibliotekë?
24. Me kë ra në kontakt njeriu i dyshimtë në bibliotekë?
25. Ç'bëri ai në bibliotekë me një tjetër njeri të dyshimtë?
26. Në ç'mënyrë ra ai në kontakt me një tjetër njeri të dyshimtë?
27. Cili nuk ra në kontakt të drejtpërdrejtë me njeriun e dyshimtë?
28. Ç'përdori ai për të rënë në kontakt me njeriun tjetër?
29. Pse i përdori librat në raft njeri nga ata që dyshohej si spiun?
30. Edhe cili njeri u-ndoq nga agjentët tjerë?
31. Cilët agjentë e ndoqën këtë të fundit?
32. Ç'i bënë këtij të fundit agjentët tjerë?
33. Ku e panë duke hyrë këtë të fundit agjentët tjerë?
34. Cilin njeri të dyshimtë panë agjentët tjerë duke hyrë në një ndërtesë?
35. Çfarë stacioni ish në veprim në këtë ndërtesë?
36. Ku ish në veprim një stacion radiodhënës i armikut?
37. Kur u-muar vesh se në atë ndërtesë ish në veprim një stacion transmetues?
38. I kujt ish stacioni që vepronte në atë ndërtesë?

39. Kush u-zu flagrant duke marrë fotografi në një zonë instalimesh ushtarake?
40. Në ç'vend u-zu flagrant një spiun i tretë?
41. Ç'ish duke bërë spiuni i tretë kur u-zu flagrant?
42. Ç'ish i ndaluar rreth zonës së instalimeve ushtarake?
43. Ku ish i ndaluar të sjellurit e të papunëve?
44. Kur mori fund kjo rjetë spiunazhi?
45. Ç'i ngjau rjetës së spiunazhit me kapjen e tre spiunëve dhe me zbulimin e stacionit radiodhënës?
46. Cila rjetë mori fund me kapjen e tre spiunëve dhe me zbulimin e stacionit radiodhënës?
47. Para çfarë gjyqi u-suall për gjykim njeri nga spiunët?
48. Ç'i ngjau njerit nga tre spiunët?
49. Sa spiunë u-sollën për gjykim para gjyqit ushtarak?
50. Pse u-suall njeri nga të tre spiunët para gjyqit ushtarak?
51. Cilët shqyrtuan akt-akuzën, dëgjuan dëshmitarët dhe dënuan të akuzuarin me vdekje?
52. Ç'bënë gjykatësit pasi peshuan rrezikun që mund të kish pasur atdheu nga vepra e tij?
53. Ç'rrezik peshuan gjykatësit?
54. Si e dënuan gjykatësit ushtarakë të akuzuarin?
55. Kë dënuan gjykatësit me vdekje me pushkatim pas shpine?
56. Kur e zbatoi vendimin e gjyqit një skuadër pushkatarësh?
57. Çfarë vendimi zbatoi të nesërmen, në të zbardhur të dritës, një skuadër pushkatarësh?
58. Ç'ngjau të nesërmen në të zbardhur të dritës?

59. Kur u-dënuan dy të tjerët?
60. Çfarë dënimi morën dy spiunët tjerë?
61. Cilët u-dënuan më vonë me burgim të përjetshëm?
62. Ç'u ngjau më vonë dy të tjerëve?
63. A mbani mend ndonjë nga zbulimet shkencore të fundit?
64. Kush dyshon se i sëmuri mund të ketë sëmundje ngjitëse?
65. A keni biseduar ndonjëherë drejtpërdrejt me Komandantin e shkollës?
66. A është i ndaluar të sjellurit e të papunëve në oborrin e shkollës sonë?
67. Zakonisht, kush e shqyrton një akt-akuzë?
68. Ç'vepra të mira ka bërë ai?
69. Në ç'orë zbardh drita tani?
70. A njihni ndonjë njeri që është dënuar me burgim të përjetshëm dhe pastaj është falur?

## FJALOR

agjent, -i agjentë, -t	(m.)	agent
akt-akuzë, -a akt-akuza, -t	(f.)	charge (law)
i akuzuar, -i të akuzuar, -it	(m.)	the accused
arrestim, -i arrestime, -t	(m.)	arrest
aty-për-aty	(adv.)	right then and there
burgim, -i burgime, -t	(m.)	imprisonment, jailing
për të dëgjuar (unë dëgjoj)	(v.)	see "me ndigjue"
për të dënuar (unë dënoj)	(v.)	to condemn, sentence, punish
për t'u-dënuar (unë dënohem)	(v.)	to be condemned, sentenced, punished
diversant, -i diversantë, -t	(m.)	a foreign agent (whose job is sabotage and espionage)
drejtpërdrejt	(adv.)	directly
i, e, të dyshimtë të dyshimta	(adj. m. & f.)	suspect, suspected; doubtful
për t'u-dyshuar (unë dyshohem)	(v.)	to be suspected
ekzekutim, -i ekzekutime, -t	(m.)	execution

favor, -i favore, -t	(m.)	favor
flagrant, -e	(adj. m. & f.)	flagrant
për të fotografuar (unë fotografoj)	(v.)	to photograph, to take a picture
gjykim, -i gjykime, -t	(m.)	judgment; trial
hyrje, -a hyrje, -t	(f.)	entrance; introduction (of a book)
kapje, -a	(f.)	arrest; seizure
i, e, të kollajtë të kollajta	(adj. m. & f.)	easy
laborator, -i laboratore, -t	(m.)	laboratory
i, e, të ndërlikuar të ndërlikuara	(adj. m. & f.)	complicated, complex
i, e, të papunë	(adj. m. & f.)	unemployed, jobless; idle
person, -i persona, -t	(m.)	person
i, të përjetshëm e, të përjetshme	(adj. m. & f.)	lifelong; eternal
përpyjekje, -a përpyjekje, -t	(f.)	effort; clash
posaçërisht	(adv.)	especially, particularly
projekt, -i projekte, -t	(m.)	project
sabotator, -i sabotatorë, -t	(m.)	saboteur

për të sabotuar (unë sabotoj)	(v.)	to sabotage
spiun, -i spiunë, -t	(m.)	spy
spiunazh, -i spiunazhe, -t	(m.)	espionage
televizion, -i	(m.)	television
transmetues, -e	(adj. m. & f.)	broadcasting, transmitting
vigjilent, -ë vigjilente	(adj. m. & f.)	vigilant
për të vjedhur (unë vjedh)	(v.)	to steal

## SHËNIME

aparaturë radiodhënës	transmitter, a transmitting set
burgim i përjetshëm	life imprisonment
për të marrë vendim (unë marr vendim)	to give a decision, to decide
të sjellurit e të papunëve	loitering
stacion transmetues stacion radiodhënës	radio station radio station
tani së fundi	recently, lately
në të zbardhur të dritës	at dawn
u-zu flagrant	he was caught red-handed



## DETYRË SHTEPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. He was sentenced by a military court.
2. Listen to him first, and then decide.
3. He is suspected to have collaborated with the enemy.
4. Almost every town in the USA has a radio station.
5. Do you have any witnesses who saw him stealing your car?
6. I përjetshëm qoftë kujtimi i tij!
7. S'më duket aq e kollajtë sa thua ti.
8. I thash aty-për-aty se ish i gabuar.
9. Ndalohet hyrja e të papunëve!
10. U-zu flagrant duke nxjerrë mall pa lejë nga depoja.

L. 106

Mësimi i 107-të




GUERILJE DHE DIVERSANTË NË PRAPAVIJAT TONA

DIALOGU

1. Ndal! A nuk e shihni se këtu ka një postblok?
2. Po, keni të drejtë; nuk e vumë re tabelën.
3. Ku doni të veni?
4. S'kemi ndonjë drejtim të caktuar. Nuk na intereson se ku do të vemi mjaft që të jemi larg frontit.
5. A keni mjaft të holla të jetoni?
6. Jo, nuk kemi, por kemi dëgjuar se në këtë zonë ka një kamp refugjatësh.
7. Atëherë ju e dijtkeni se ku do të veni. Nga vini?
8. Unë vij nga një fshat që dy ditë më parë ish mu në vijë të frontit; për tjerët nuk di gjë, jemi bashkuar rrugës.
9. Ç'ke në atë deng?
10. Kam plaçka personale.
11. Hape të lutem!
12. Ju thash se kam vetëm plaçka personale.
13. Pse po zverdhe? Dëshiroj vetëm të sigurohem se ke plaçka personale e jo gjë tjetër. Hape!
14. Po mirë, urdhëroni!
15. Ç'janë këto?
16. Trakte.
17. Po këto dy pushkë automatike, ç'i do?
18. Ju lutem mos i mirrni në qafë të tjerët sepse ata nuk dijnë gjë; vetëm unë jam përgjegjës.
19. Kush je ti?
20. Jam kapter në ushtrinë, kundër së cilës jeni duke luftuar.
21. Si e vërteton këtë që thua?
22. Kam letërnjoftim. E kam fshehur ndër plaçka në deng.

L. 107

23. Me ç'mision të ka ngarkuar komanda jote?
24. Me organizimin e çetave.



## LEXIM E PËRKTHIM

Divizioni, në të cilin bënte pjesë Agimi, u-shkarkua nga detyra që kish si njësi Forcash Sigurimi dhe u-dërgua në një zonë lufte. Ushtria jonë kish hyrë thellë në tokën e armikut. Divizioni në fjalë u-ngarkua të luftonte çetat dhe të mirrte nën mbikëqyrje të vet lëvizjet e popullsisë civile. Për këtë arsye në të gjitha rrugët u-vunë postbloqe që të kontrollonin, të identifikonin dhe të drejtonin civilat nga zonat e brendshme, larg frontit dhe qyteteve që kishin sulmuar.

Civilat e shpërngulur nga banimet e tyre paraqesin një problem të madh për një shtet në luftë. Është punë e vështirë të organizosh lëvizjet e civilave nëpër rrugë, në mënyrë që të mos ngatërrojnë dhe të mos pengojnë trafikun. Zakonisht, Kryqi i Kuq organizon për ta kampe refugjatësh, ku ushqehen dhe strehohen përkohësisht.

Sa më tepër që përparonin forcat tona, aq më tepër shtoheshin robët e luftës. Mirëpo armiku filloi të dërgonte këtej vijave tona civila të maskuar si refugjatë, të cilët formuan çeta ndër prapavija. Një nga ata që ishin dërguar të organizonin civilat, të sabotonin mbarëvajtjen e luftës sonë ish edhe kapteri i maskuar si civil, për të cilin u-bisedua më parë.

Çetat e organizuara ndër prapavija sulmonin kolonat tona ndër shtiqe e gryka dhe ndër kryqëzime rrugësh. Ato mundën të hudhnin në ajr edhe një sasi urash hekurudhore. Divizioni që u-përmend më lart dërgoi detashmente dhe aeroplana vëzhgues që të asgjësonin çetat e armikut.

PYETJE

1. Cili divizion u-shkarkua nga detyra që kish si njësi forcash sigurimi?
2. Nga ç'detyrë u-shkarkua divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi?
3. Ku u-dërgua ai divizion?
4. Ç'ngjau pasi u-shkarkua divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi?
5. Ç'detyrë kish divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi, para se të dërgohej në një zonë lufte?
6. Cili divizion u-dërgua në një zonë lufte?
7. Cila ushtri kish hyrë thellë në tokën e armikut?
8. Ku kish hyrë thellë ushtria jonë?
9. Si kish hyrë ushtria jonë në tokën e armikut?
10. Në tokën e kujt kish hyrë thellë ushtria jonë?
11. Cili divizion u-ngarkua të luftonte çetat?
12. Me ç'detyrë u-ngarkua divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi?
13. Ç'duhej të bënte ky divizion?
14. Cili divizion duhej të mirrte nën mbikëqyrje të vet lëvizjet e popullsisë civile?
15. Lëvizjet e cilës popullsi duhej të mirrte nën mbikëqyrje divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi?
16. Për këtë arsye, ç'u-vu në të gjitha rrugët?
17. Ku u-vunë postbloqe?
18. Ku u-vunë postbloqet që të kontrollonin, të identifikonin dhe të drejtonin civilat nga zona e brendshme?



19. Pse u-vunë postbloqe në të gjitha rrugët?
20. Nga çfarë zonash do të drejtoheshin civilat?
21. Cilët do të drejtoheshin nga zonat e brendshme, larg frontit dhe qyteteve që kishin sulmuar?
22. Larg çfarë vendi do të drejtoheshin civilat?
23. Çfarë problemi paraqesin civilat e shpërngulur nga banimet e tyre për një shtet në luftë?
24. Cilët paraqesin një problem të madh për një shtet në luftë?
25. Për çfarë shteti paraqesin civilat e shpërngulur nga banimet e tyre një problem të madh?
26. Çfarë pune është të organizosh lëvizjet e civilave nëpër rrugë?
27. Ç'është vështirë të bësh, në mënyrë që civilat të mos e ngatërrojnë dhe të mos e pengojnë trafikun?
28. Ç'i bëjnë civilat trafikut gjatë luftës?
29. Zakonisht, kush organizon për civilat kampe refugjatësh?
30. Ç'bën Kryqi i Kuq për refugjatët?
31. Ku ushqehen dhe ku strehohen refugjatët përkohësisht?
32. Për sa kohë ushqehen dhe strehohen refugjatët ndër kampe refugjatësh?
33. Nga kush ushqehen dhe strehohen refugjatët përkohësisht?
34. Cilët robë shtoheshin sa më tepër që përparonin forcat tona?
35. Ç'ngjante sa më tepër që përparonin forcat tona?
36. Në ç'rast shtoheshin robët e luftës?
37. Ç'filloi të dërgonte armiku këtej vijave tona?
38. Kush dërgoi këtej vijave tona civila të maskuar si refugjatë?

39. Si ishin civilat që filloi të dërgonte armiku këtej vijave tona?
40. Në ç'vend filloi t'i dërgonte armiku civilat e maskuar si refugjatë?
41. Pse i dërgoi armiku këta civila të maskuar këtej vijave tona?
42. Cilët formuan çeta ndër prapavija?
43. Ç'bënë civilat e maskuar ndër prapavijat tona?
44. Në ç'pjesë të frontit formuan çeta civilat e maskuar që dërgoi armiku?
45. Cili ish njeri nga ata që u-dërgua nga ana e armikut të organizonte civilat?
46. Për çfarë qëllimi u-dërgua kapteri i maskuar si civil?
47. Ç'do të sabotonte kapteri me civilat?
48. Mbarëvajtjen e luftës së kujt do të sabotonte kapteri i maskuar si civil?
49. Kur u-bisedua për këtë kapter dhe për civilat që u-dërguan me të?
50. Cilat çeta i sulmonin kolonat tona?
51. Ç'bënin çetat e armikut të organizuara ndër prapavija?
52. Kë sulmonin këto çeta ndër shtiqe, gryka dhe ndër kryqëzime rrugësh?
53. Në ç'vende i sulmonin çetat e armikut kolonat tona?
54. Ç'mundën të hudhnin në ajr ato çeta?
55. Sa ura hekurudhore mundën të hudhnin në ajr çetat e organizuara të armikut?
56. Çfarë urash mundën të hudhnin në ajr ato çeta?

57. Cili divizion dërgoi detashmente dhe aeroplana vëzhgues që të asgjësonin çetat e armikut?
58. Ç'dërgoi divizioni që u-përmend më lart për t'i asgjësuar çetat e armikut?
59. Pse i dërgoi divizioni që u-përmend më lart detashmentet dhe aeroplanat vëzhgues?
60. Çfarë forcash dërgoi divizioni që u-përmend më lart për t'i asgjësuar çetat e armikut?

## FJALOR

për t'u-bashkuar (unë bashkohem)	(v.)	to join, unite, to get together
për t'u-biseduar (bisedohet)	(v.)	to be discussed
çetë, -a çeta, -t	(f.)	band, gang
deng, -u denga, -t	(m.)	bundle; bale
grykë, -a gryka, -t	(f.)	mountain pass; mouth of a river; mouth of a well, bottle, etc.; throat; muzzle of a gun
guerilje, -a guerilje, -t	(f.)	guerrilla
për të identifikuar (unë identifikoj)	(v.)	to identify
këtej	(adv. & prep.)	on this side; this way; this side of....
kryq, -i kryqe, -t	(m.)	cross, crucifix
i, e, të maskuar të maskuara	(adj. m. & f.)	disguised; camouflaged
mbarëvajtje, -a	(f.)	progress; welfare; success
mbikëqyrje, -a	(f.)	supervision
mu	(adv.)	right; exactly

për të ngatërruar (unë ngatërroj)	(v.)	to confuse; to snarl, entangle; to complicate; to muss up; to incite
përgjegjës, -e	(adj. m. & f.)	responsible, answerable
për t'u-përmendur (unë përmendem)	(v.)	to be mentioned; to come to (to regain consciousness)
postblok, -u postbloqe, -t	(m.)	check point
problem, -i probleme, -t	(m.)	problem
i, e, të shpërngulur të shpërngulura	(adj. m. & f.)	displaced
shtek, -u shtiçe, -t	(m.)	path, pass, passage
tabelë, -a tabela, -t	(f.)	sign (of a store, etc.); list (of prices); blackboard; slate
trafik, -u	(m.)	traffic
trakt, -i trakte, -t	(m.)	tract, leaflet
për t'u-ushqyer (unë ushqehem)	(v.)	to be fed, nourished
për të vërtetuar (unë vërtetoj)	(v.)	to prove, to verify; to confirm; to authenticate
për t'u-zverdhur (unë zverdhem)	(v.)	see "me u-verdhë"

SHËNIME

Divizioni në fjalë	The division in question
më lart	above; higher
për të marrë në qafë (unë marr në qafë)	to harm, to ruin somebody
mos i mirrni në qafë	don't harm them
sa më tepër...aq më tepër	the more...the more
për të vënë re (unë ve re)	to notice

DETYRË SHTEPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. Your name wasn't mentioned at all.
2. I am responsible, Sir, for all this damage. I'll pay for it, don't worry!
3. This is a personal matter and I don't want to talk about it.
4. We have another check point to go through; I hope this is the last one.
5. He lives on this side of the river.
6. He became pale because he was scared.
7. The refugees are being fed by the Red Cross.
8. The mountain pass is blocked by the snow that fell yesterday.
9. Can you prove that what you are saying is true?
10. He has ruined himself and his family with his drinking and gambling.

Mësimi i 108-të

SULMI I FUNDIT KUNDËR KRYEQYTETIT





DIALOGU

1. Ke luftuar ndonjëherë, Agim, nëpër rrugë të një qyteti?
2. Po, dhe të tilla luftime janë më të tmershme se betejat në front.
3. Në ç'pikëpamje janë më të tmershme?
4. Pikësëpari, armikun nuk e ke përballë si në front dhe vdekja mund të të vijë nga çdo anë; së dyti, armiku është i strehuar kurse forcat sulmuese jo.
5. Jam dakord me ty, por forcat sulmuese kanë më shumë mjete nga të cilat mund të përfitojnë.
6. A mos do të thuash tanke dhe topa?
7. Dua të them mjete tjera si aeroplana reaktivë, parashutistë etj. duke mos i përjashtuar as ato që përmende ti.
8. Ndonëse jam i bindur se për armikun nuk duhet të kemi mëshirë, duhet të mendojmë se ndër shtëpi ka gra, çilimi dhe pleq të pambrojtur.
9. Ç'do të thuash me këtë?
10. Dua të them se çilimitë, gratë e pleqtë janë pengim për ata që sulmojnë qytetin.
11. Me fjalë tjera duhet kursyer jeta e të pafajshëmvet.
12. Po, gjersa të jetë e mundur.
13. Ç'pamje ka një qytet në raste të tilla?
14. Të tmershme: syri nuk të sheh veçse gërmadha, të vdekur, godina duke u-djegur dhe s'dëgjohet tjetër veçse krismat e armëve.
15. Si bëjnë njerëzit për t'u-ushqyer?
16. Ky nuk është problemi kryesor i popullsisë së qytetit; rrezikun më të madh e paraqesin epidemitë, që shkaktohen nga mungesa e ujit dhe e higjienës.

L. 108

17. A ju ka qëlluar të rrethonit ndonjë shtëpi dhe armiku të mos jetë dorëzuar?
18. Po, nganjëherë ndodh, sidomos me anëtarët fanatikë të partisë. Në atë rast i jep zjarr shtëpisë për t'i asgjësuar ose për t'i zënë robë.





## LEXIM E PËRKTHIM

Divizioni, në të cilin bënte pjesë Agimi, u-kthye më në fund në vijën e frontit për të marrë pjesë, bashkë me trupat tjera, në sulmin e fundit që do të bëhej kundër kryeqytetit të shtetit armik.

Nga e majta kryeqyteti u-sulmua prej parashutistësh dhe nga e djathta nga një regjiment i këmbësisë, i cili ish i ndihmuar nga një batalion artilerie, nga një kompani xhenioje dhe nga një kompani kundërajrore. Sulmi frontal kundër kryeqytetit u-bë nga trupat kryesore të përbëra nga këmbësoria dhe nga forca të koracuara.

Njësia, në të cilën bënte pjesë Agimi, e ndihmuar nga tanke, qe e para që hyri në kryeqytet. Armiku i priti këto me të shtira nga çatitë dhe nga dritaret e ndërtesave. Nëpër rrugë u-zhvilluan luftime të ashpra. Çdo ndërtesë dhe çdo rrugë duhej spastruar mirë para se trupat tona të përparonin drejt qendrës së qytetit. Trupat tona të këmbësisë adaptuan taktikën e sulmit në dy grupe: një pjesë e tyre sulmonte dhe tjetra e ndihmonte me të shtira të dendura për t'a ruajtur nga çdo befasi.

Pasi u-spastruan disa nga ndërtesat, u-suall atje një tank që kish një megafon, me anë të të cilit armiku u-ftua të

dorëzohej dhe të mos shkaktonte më gjakderdhje të kotë. Thirrja pati përfundim të mirë, sepse pothuajse të tëra luftimet nëpër rrugë pushuan. Pa humbur kohë u-vendos një qeveri ushtarake. Kjo u lëshoi banorëve letërnjoftime, kështu që forcat tona të ishin në gjendje t'i kontrollonin lëvizjet e tyre.

Ca nga ushtarët tanë, të cilëve s'u pritej të kishin sa më shumë kujtime nga qyteti që pushtuan, u-plagosën ose u-vranë ndër grackat që kish vënë armiku para se të braktiste qytetin.

PYETJE

1. Cili divizion u-kthye, më në fund, në vijën e frontit?
2. Ku u-kthye, më në fund, divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi?
3. Ç'bëri, më në fund, divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi?
4. Kur u-kthye në front divizioni në të cilin bënte pjesë Agimi?
5. Bashkë me cilat trupa do të merrte pjesë ai divizion në sulmin e fundit?
6. Ç'do të bënte ai divizion bashkë me trupat tjerë në sulmin e fundit?
7. Në cilin sulm do të merrte pjesë divizioni i Agimit?
8. Pse u-kthye ai divizion në vijën e frontit?
9. Kundër cilit qytet do të bëhej sulmi i fundit?
10. Ç'do të bëhej kundër kryeqytetit të shtetit armik?
11. Nga çfarë forcash u-sulmua kryeqyteti nga e majta?
12. Nga cila anë e sulmuan kryeqytetin parashutistët?
13. Nga cila anë e sulmoi kryeqytetin një regjiment i këmbësisë?
14. Çfarë regjimenti e sulmoi kryeqytetin nga e djathta?
15. Nga çfarë forcash u-ndihmua regjimenti i këmbësisë që e sulmoi kryeqytetin nga e djathta?
16. Cilin regjiment ndihmuan një batalion artilerie, një kompani xhenioje dhe një kompani kundërajrore?
17. Ç'bënë një batalion artilerie, një kompani xhenioje dhe një kompani kundërajrore?
18. Nga cilat trupa u-bë sulmi frontal kundër kryeqytetit?

19. Ç'bënë trupat kryesore kundër kryeqytetit?
20. Nga çfarë forcash ishin të përbëra trupat kryesore që bënë sulmin frontal?
21. Cilat trupa ishin të përbëra nga këmbësoria dhe nga forca të koracuara?
22. Cila njësi qe e para që hyri në kryeqytet?
23. Nga se ish e ndihmuar njësia e Agimit që hyri e para në kryeqytet?
24. E sata qe njësia e Agimit që hyri në kryeqytet?
25. Kush i priti forcat tona me të shtira nga çatitë dhe nga dritaret e ndërtesave?
26. Nga ku shtinte armiku kundër forcave tona që hynë të parat në kryeqytet?
27. Ç'bëri armiku nga çatitë dhe nga dritaret e ndërtesave?
28. Çfarë luftimesh u-zhvilluan nëpër rrugë?
29. Ku u-zhvilluan luftime të ashpra?
30. Ç'duhej spastruar mirë para se trupat tona të përparonin drejt qendrës së kryeqytetit?
31. Kur duhej spastruar mirë çdo ndërtesë dhe çdo rrugë?
32. Pse duhej spastruar mirë çdo ndërtesë dhe çdo rrugë?
33. Çfarë taktike adaptuan trupat tona të këmbësorisë?
34. Ç'bënë trupat tona të këmbësorisë?
35. Cilat trupa adaptuan taktikën e sulmit në dy grupe?
36. Ç'bënte një pjesë e këtyre trupave?
37. Me çfarë të shtirash ndihmonte tjetra pjesë?
38. Cila pjesë e këmbësorisë ndihmonte me të shtira të dendura?

39. Pse ndihmonte pjesa tjetër me të shtira të dendura?
40. Cilën pjesë ruante ajo nga çdo befasi?
41. Nga se e ruante pjesën e këmbësorisë që sulmonte pjesa që shtinte?
42. Ç'u-suall atje pasi u-spastruan disa nga ndërtesat?
43. Ku u-suall një tank që kish një megafon?
44. Çfarë mjeti kish tanksi që u-suall atje?
45. Kush u-ftua me anë të këtij megafoni që të dorëzohej dhe të mos shkaktonte më gjakderdhje të kotë?
46. Ç'u-ftua të bënte armiku?
47. Çfarë gjakderdhje ish ajo që do të bënte armiku, po të mos dorëzohej?
48. Çfarë përfundimi pati thirrja?
49. Ku pushuan pothuajse të tëra luftimet?
50. Ç'pushoi pothuajse nëpër të tëra rrugët?
51. Çfarë qeverie u-vendos pa humbur kohë?
52. Kur u-vendos një qeveri ushtarake?
53. Ç'u lëshoi kjo qeveri banorëve?
54. Kujt i lëshoi letërnjoftime qeveria ushtarake që u-vendos?
55. Kush u lëshoi banorëve letërnjoftime?
56. Cilat forca ishin në gjendje t'i kontrollonin lëvizjet e banorëve, të cilëve u ishin lëshuar këto letërnjoftime?
57. Pse u lëshoi kjo qeveri letërnjoftime banorëve?
58. Lëvizjet e kujt ish në gjendje të kontrollonte kjo qeveri?
59. Cilët u-plagosën ose u-vranë ndër grackat që kish ngrehur armiku?

60. Cilëve s'u pritej të kishin sa më shumë kujtime nga qyteti që pushtuan?
61. Ç'donin të kishin ushtarët nga qyteti që pushtuan?
62. Ç'kish bërë armiku para se t'a braktiste qytetin?
63. Kush kish vënë gracka para se t'a braktiste qytetin?
64. Me ç'rast u-vranë ose u-plagosën ca nga ushtarët tanë?
65. Kë keni nga e majta dhe kë keni nga e djathta?
66. Kush duhet të ruhet nga çdo befasi kur është në front?
67. Kur ftohet armiku që të dorëzohet?
68. Kujt s'i pritet të vejë në Europë?
69. Zakonisht, ç'bien turistët me vete kur kthehen nga vendet e huaja?
70. A njihni ndonjë njeri që ka rënë në ndonjë grackë?

## FJALOR

për të adaptuar (unë adaptoj)	(v.)	to adapt
befasi, -a	(f.)	surprise
i, e, të bindur të bindura	(adj. m. & f.)	convinced; obedient
çilimi, -u çilimi, -të	(m.)	a small child
për t'u-dëgjuar (unë dëgjohem)	(v.)	see "me u-ndigjue"
për t'u-djegur (unë digjem)	(v.)	to get burned, to burn
fanatik, -ë fanatike	(adj. m. & f.)	fanatic, fanatical
më në fund	(adv.)	finally, at last
gërmadhë, -a gërmadha, -t	(f.)	ruin, debris
godinë, -a godina, -t	(f.)	building
grackë, -a gracka, -t	(f.)	trap, booby trap
gjakderdhje, -a gjakderdhje, -t	(f.)	bloodshed
higjienë, -a	(f.)	hygiene
i, e, të kotë të kota	(adj. m. & f.)	useless, futile, vain
krismë, -a krisma, -t	(f.)	bang; report (of a gun), shot





megafon, -i megafona, -t	(m.)	megaphone
për t'u-ndihmuar (unë ndihmohem)	(v.)	to be helped, aided
ndonëse	(conj.)	although, even though
i pafajshëm, -i të pafajshëm, -it	(adj. m. & f.)	the innocent
pengim, -i pengime, -t	(m.)	obstacle, hindrance, impediment
për të përjashtuar (unë përjashtoj)	(v.)	to exclude, exempt, except; to expel
pikësëpari	(adv.)	first of all
i sati, e sata të satët, të satat	(adj. m. & f.)	which (in numerical order)
i, e, të strehuar të strehuara	(adj. m. & f.)	sheltered, harbored
për t'u-sulmuar (unë sulmohem)	(v.)	to be attacked
sulmues, -e	(adj. m. & f.)	attacking, aggressive
e shtirë, -a të shtira, -t	(f.)	charge, report (of a gun); shooting
thirrje, -a thirrje, -t	(f.)	call, appeal; invitation; summons
i vdekur, -i të vdekur, -it	(m.)	the dead

SHËNIME

jam dakord me ty		I agree with you
për të qenë dakord (unë jam dakord)	(v.)	to agree
...të cilëve s'u pritej		...who were eager
...i jep zjarr shtëpisë		...you set fire to the house

DETYRË SHTËPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. I am convinced that he is hiding somewhere in this building.
2. We all agreed with his point of view.
3. It's useless to talk to him; he won't listen to you.
4. I haven't received any summons from the court yet.
5. We have a great deal of obstacles before we reach that point.
6. His house burned down; nobody knows what caused the fire.
7. Watch out for booby traps!
8. I caught him by surprise.
9. I thought I heard some shots.
10. He behaves like a small child.

Mësimi i 109-të






KREMTIMI I FITORES

DIALOGU

1. Kur u-bind armiku se e kish humbur luftën?
2. Ndofta ish bindur më parë, por u-dorëzua kur kryeqyteti ra në dorë tonë.
3. A pati dezertime dhe arratisje, gjatë luftës, nga ana e armikut?
4. Po, veçanërisht javët e fundit; përveç ushtarëve janë arratisur edhe një shumicë nëpunësish e funksionarësh të lartë.
5. Ç'kremtim u-organizua ditën që u-nënshkrua armëpushimi?
6. Komanda e Përgjithshme, që kish transferuar qendrën në kryeqytetin e armikut, organizoi një parakalim.
7. Kur hyri në fuqi armëpushimi?
8. Armëpushimi hyri në fuqi në mesnatë të asaj dite.
9. Me kaq, a mbaron detyra juaj në ushtri?
10. Jo, tani jemi duke zhvilluar një vepër tjetër krejt të ndryshme.
11. Ç'do të thoni me këtë?
12. Jemi duke u vënë fre vjedhjeve e abuzimeve të ndryshme dhe jemi duke u-munduar të ndihmojmë ish-armikun që të formojë një qeveri të mirë për popullin e vet dhe për shtetet fqinjë.
13. Me fjalë tjera jeni duke zhdukur qeverinë totalitare.
14. Jo vetëm këtë, por duhet të kujdesohemi që popullësia të mos ahmerret me ndëshkime arbitrare.
15. Nuk ju kuptoj; ç'doni të thoni?
16. Populli e ka urrejtur regjimin e mëparshëm, prandaj kemi frikë se mos ekzekutohet ndonjë pa gjyq.
17. A nuk janë arrestuar këta njerëz?
18. Jo të gjithë, natyrisht; populli kujton se është e drejta e tij të ekzekutojë njerëz në banimet e tyre.

L. 109

19. A i a keni arritur qëllimit t'a ndaloni një gjë të tillë?
20. Jo gjithmonë; është punë e vështirë kjo, meqë shumë qytetarë mbajnë armë pa lejë.



## LEXIM E PËRKTHIM

Me pushtimin e kryeqytetit, armiku nuk tregoi më asnjë vullnet për t'a vazhduar luftën. Armiku u-dorëzua dhe nënshkroi marrëveshjen për armëpushim, i cili do të hynte në fuqi në mesnatë. Ndërkaq, u-lajmërua që luftimet të pushonin kudo, pa qenë nevoja të prisnin mesnatën. Po atë ditë, forcat tona parakaluan nëpër rrugën kryesore të kryeqytetit. Në mesnatë, zëri i një borie lajmëroi se lufta kish marrë fund dhe trupat kudo shpërthyen në brohori duke u-përçafuar me njeri tjetrin.

Armiku u-çarmatos në muajt që pasuan nga data e fitores, dhe forcat aleate u-përpoqën që ish-armiku i tyre të vihej sa më shpejt e më mirë në rrugën e paqës.

Pasi mbaruan luftimet, komandat tona eprore dekoruan ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të dalluar për trimëri, si edhe bënë ca gradime. Menjëherë pas këtyre ceremonive filloi edhe çmobilizimi i forcave tona, dhe shumë njësi të kohës së luftës u-suprimuan.

Agimi pati rast dhe kohë të shkonte për të vizituar ca nga shokët e tij, të cilët ishin plagosur dhe që ende ishin të shtruar ndër spitalet e ushtrisë. Në një nga këto spitale Agimi pa, për të parën herë pas shumë kohe, një bashkëqytetare të tijën, një infermiere.

Autoritetet vendosën të dërgonin në atdhe, me vapor, trupin e një ushtari të panjohur për t'a vënë në Monumentin e Ushtarit të Panjohur. Agimi, i cili pasi mbaroi lufta u-gradua kapter, u-zgjodh të mirrte pjesë si rojë nderi gjatë transportimit të këtij Ushtari. Pasi e vunë trupin e Ushtarit të Panjohur në pushim të përjetshëm, Agimi e çoi mendjen te formacioni i parë ushtarak, aty ku u-fut në rrjesht ditën që e morën ushtar. Që nga ajo ditë kish kaluar një kohë mjaft e gjatë. Tani ai e ndjente veten ushtar të vjetër e të pjekur.



PYETJE

1. Kush nuk tregoi më asnjë vullnet për t'a vazhduar luftën me pushtimin e kryeqytetit?
2. Në ç'rast nuk tregoi armiku asnjë vullnet për t'a vazhduar luftën?
3. Ç'ndodhi me pushtimin e kryeqytetit?
4. Kush u-dorëzua dhe nënshkroi marrëveshjen për armëpushim?
5. Ç'bëri armiku pas pushtimit të kryeqytetit?
6. Ç'nënshkroi armiku për armëpushim?
7. Kur do të hynte në fuqi marrëveshja që nënshkroi armiku?
8. Ç'do të hynte në fuqi në mesnatën e asaj dite që u-nënshkrua marrëveshja?
9. Ndërkaq, ç'u-lajmërua të bëhej, pa qenë nevoja të prisnin mesnatën?
10. Ku duhej të pushonin luftimet pa qenë nevoja të prisnin mesnatën?
11. Ç'duhej të pushonte kudo?
12. Cilat forca parakaluan nëpër rrugën kryesore të kryeqytetit?
13. Kur parakaluan forcat tona nëpër rrugën kryesore të kryeqytetit?
14. Ç'bënë forcat tona po atë ditë?
15. Nëpër çfarë rruge parakaluan forcat tona po atë ditë?
16. Kur lajmëroi zëri i një borie se lufta kish marrë fund?
17. Ç'lajmëroi në mesnatë zëri i një borie?
18. Cilët shpërthyen në brohori duke u-përqaftuar me njeri tjetrin?

19. Ç'bënë trupat tona kudo?
20. Pse shpërthyen në brohori dhe u-përçafuan me njeri tjetrin trupat tona?
21. Kush u-çarmatos në muajt që pasuan nga data e fitores?
22. Kur u-çarmatos armiku?
23. Ç'bëri armiku në muajt që pasuan nga data e fitores?
24. Cilat forca u-përpoqën që ish-armiku i tyre të vihej sa më shpejt e sa më mirë në rrugën e paqës?
25. Kur dhe si duhej vënë ish-armiku në rrugën e paqës?
26. Në ç'rrugë duhej vënë ish-armiku sa më shpejt e sa më mirë?
27. Pasi mbaruan luftimet, cilat komanda dekoruan ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të dalluar për trimëri?
28. Kur dekoruan komandat tona eprore ushtarë, nënoficerë dhe oficerë?
29. Cilat komanda dekoruan ushtarë, nënoficerë dhe oficerë?
30. Për ç'arësye i dekoruan komandat tona eprore ushtarët, nënoficerët dhe oficerët?
31. Cilët ishin dalluar për trimëri në luftë?
32. Kë dekoruan komandat tona eprore për trimëri?
33. Përveç dekorimeve, ç'bënë tjetër komandat tona eprore?
34. Sa gradime bënë komandat tona eprore?
35. Kur filloi çmobilizimi i forcave tona?
36. Ç'filloi menjëherë pas këtyre ceremonive?
37. Çmobilizimi i cilave forca filloi menjëherë pas këtyre ceremonive?
38. Sa njësi të kohës së luftës u-suprimuan?

39. Ç'u ngjau shumë njësi të kohës së luftës?
40. Cilat njësi u-suprimuan?
41. Kush pati rast dhe kohë të shkonte për të vizituar ca nga shokët e tij?
42. Ç'pati rast dhe kohë të bënte Agimi?
43. Kë pati rast të vizitonte Agimi?
44. Kur ishin plagosur dhe ku gjendeshin ca nga shokët që Agimi vajti të vizitonte?
45. Cilët gjendeshin ende të shtruar ndër spitalet e ushtrisë?
46. Ndër çfarë spitalesh gjendeshin ca nga shokët e Agimit?
47. Kush pa në një nga këto spitale një bashkëqytetare të tijën?
48. Kë pa Agimi në një nga këto spitale ushtarake?
49. Pas sa kohe e pa Agimi këtë bashkëqytetare?
50. Ç'detyrë kish kjo bashkëqytetare e Agimit?
51. Kush ish infermiere?
52. Kë vendosën autoritetet ushtarake të dërgonin me vapor në atdhe?
53. Ç'vandosën të bënin autoritetet ushtarake me trupin e një ushtari të panjohur?
54. Pse vendosën autoritetet të dërgonin në atdhe trupin e një ushtari të panjohur?
55. Ku duhej vënë Trupi i Ushtarit të Panjohur?
56. Kush u-gradua kapter pasi mbaroi lufta?
57. Ç'u-zgjodh të bënte Agimi pasi mbaroi lufta dhe u-gradua kapter?
58. Në transportimin e cilit ushtar do të mirrte pjesë Agimi?



59. Si çfarë roje do të merrte pjesë Agimi në transportimin e Ushtarit të Panjohur?
60. Ku e çoi mendjen Agimi pasi e vunë trupin e Ushtarit të Panjohur në pushim të përjetshëm?
61. Ku e vunë Trupin e Ushtarit të Panjohur?
62. Ç'çoi Agimi te formacioni i parë ushtarak?
63. Kur e çoi Agimi mendjen te formacioni i parë ushtarak, aty ku u-fut në rrjesht ditën që e morën ushtar?
64. Ç'bëri Agimi pasi e vunë Trupin e Ushtarit të Panjohur në pushim të përjetshëm?
65. Sa kohë kish kaluar nga ajo ditë?
66. Nga cila ditë kish kaluar një kohë mjaft e gjatë?
67. Si çfarë ushtari e ndjente ai veten tani?
68. Kush e ndjente veten si ushtar të vjetër dhe të pjekur?
69. Ç'duhet t'i bëni një çeku para se t'a thyeni?
70. A dini t'i bini borisë, Z....?
71. Ç'bëni kur largoheni nga të dashurit tuaj?
72. Si çfarë ushtari e ndieni veten ju, Z....?

## FJALOR

abuzim, -i abuzime, -t	(m.)	abuse, misuse
për t'u-ahmarrë (unë ahmerrem)	(v.)	to avenge
arbitrar, -e	(adj. m. & f.)	arbitrary
arratisje, -a arratisje, -t	(f.)	flight, fleeing, escape, defection
bashkëqytetar, -i bashkëqytetarë, -t	(m.)	fellow citizen
bashkëqytetare, bashkëqytetarja bashkëqytetare, -t	(f.)	fellow citizen
bori, -a bori, -të	(f.)	bugle, trumpet
për t'u-çarmatosur (unë çarmatosem)	(v.)	to be disarmed
çmobilizim, -i	(m.)	demobilization
i, e, të dalluar të dalluara	(adj. m. & f.)	distinguished, distinct, discerned
për të dekoruar (unë dekoroj)	(v.)	to decorate
dezertim, -i dezertime, -t	(m.)	desertion
për të ekzekutuar (unë ekzekutoj)	(v.)	to execute
për t'u-ekzekutuar (unë ekzekutohem)	(v.)	to be executed
fitore, fitorja fitore, -t	(f.)	victory

fre, -ri frerë, -t	(m.)	rein; brake
funksionar, -i funksionarë, -t	(m.)	a high official
gradim, -i gradime, -t	(m.)	promotion
për t'u-graduar (unë gradohem)	(v.)	to be promoted
ish	(prefix)	ex, former
kremtim, -i kremtime, -t	(m.)	celebration
për t'u-lajmëruar (unë lajmërohem)	(v.)	to be notified, informed, announced
marrëveshje, -a marrëveshje, -t	(f.)	agreement
ndëshkim, -i ndëshkime, -t	(m.)	punishment, penalty
parakalim, -i	(m.)	parade
për të parakaluar (unë parakaloj)	(v.)	to parade
për të pasuar (unë pasoj)	(v.)	to follow
për t'u-përqafuar (unë përqafohem)	(v.)	to embrace
për t'u-suprimuar (suprimohet)	(v.)	to be deactivated, to be abolished
totalitar, -ë totalitare	(adj. m. & f.)	totalitarian
për të transferuar (unë transferoj)	(v.)	to transfer

L. 109

vullnet, -i	(m.)	will, desire
për të zhdukur (unë zhduk)	(v.)	to get rid of, to do away with

#### SHËNIME

Agimi e çoi mendjen....		Agim mused over, contemplated....
...që do të hynte në fuqi		...that it would go into effect
për të hyrë në fuqi (hyn në fuqi)	(v.)	to go into effect
...e morën ushtar		...they drafted him
i shtruar në spital		hospitalized
për t'u-shtruar në spital (unë shtrohem në spital)	(v.)	to be hospitalized
duke u vënë fre....		putting a stop to....
për t'i (u) vënë fre (unë i (u) ve fre)	(v.)	to put a stop to

#### DETYRË SHËNIME

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. He shows no desire to do this job.
2. A few departments were deactivated some years ago.
3. There were many high government officials at the ceremony.
4. They were disarmed and thrown in a concentration camp.
5. He was promoted for bravery on the battlefield.



6. A trade agreement was signed last week between the two countries.
7. This law will go into effect June 1st.
8. He plays the trumpet beautifully.
9. He got rid of the gun before the police came.
10. I think that the punishment was very severe.

L. 109

## Mësimi i 110-të






### LIRIMI

### DIALOGU

1. Agim, më dukesh i hieshëm me rrobe civile. Kur u-lirove dhe si vajti ceremonia?
2. Një javë më parë u-lirova. Ceremonia qe shumë e mallëngjyeshme.
3. U-mundova mjaft të vija, por në Sheshin e Lirisë qe një mizëri njerëzish sa që nuk qe e mundur t'i afrohesha monumentit.
4. Duhet të kenë qenë afër 60.000 veta, përveç oficerëve të Komandës së Përgjithshme e ushtarakëve tjerë.
5. Më trego me pak fjalë si u-zhvillua ceremonia.
6. Ne ishim rreshtuar me kohë rreth e rrotull altarit ku do të vendosej trupi i Ushtarit të Panjohur. Në të dy anët e altarit digjeshin dy flakë.
7. Sa pamje e trishtueshme!
8. Në orën e caktuar, duke kaluar përmes turmës, një rresht i gjatë oficerësh e civilash u-drejtua nga monumenti.
9. Kush e udhëhiqte rreshtin?
10. Banda ushtarake. Pas kësaj vinte një top i tërhequr nga tetë kuaj të mbuluar në zi. Mbi top ish vendosur arkivoli i mbuluar me flamurin kombëtar.
11. Sipas zakonit, mbi flamur ishin vënë helmata e një ushtari dhe një jastëk me dekorata.
12. Po. Ndërsa vendosën arkivolin mbi altar, banda ushtarake ekzekutoi himnin kombëtar.
13. A mbajti kush ndonjë fjalim?
14. Po, Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura mbajti një fjalim shumë prekës.
15. Ç'përmbajtje pati fjalimi?
16. Ai përmendi me fjalë të bukura theroritë e ushtarëve tonë, kujtoi dëshmorët e të gjitha fronteve dhe sakrificat e mbarë kombit.

L. 110

17. Përveç oficerëve të lartë, kush tjetër qe aty?
18. Qenë të pranishëm edhe prindët e disa dëshmorëve, të cilëve i u-dorëzuan dekoratat e bijve të tyre.



## LEXIM E PËRKTHIM

Para se të nisej Agimi si pjesëtar i togës së nderit, që shoqëroi trupin e Ushtarit të Panjohur në udhëtim për atdhe, pëshpëritej se njësia në të cilën bënte pjesë ai, do të dilte shpejt në lirim. Me të vërtetë kësaj njësie i u-dha urdhër që të kthehej në atdhe dhe pikërisht në qytetin ku e kish bazën e vet. Kështu, ata u-ngarkuan edhe një herë në një anije. Pas pak ditësh që arritën në bazë, përveç Agimit që, siç u-tha, duhej të ish në shërbim edhe disa ditë, të gjithë ushtarëve dhe graduatëve i u-dorëzua nga një fletë lirimi. Bashkangjitur me fletën e lirimit ish edhe një listë, në të cilën radhiteshin zyrat e ndryshme ku duhej të shkonte secili para se të largohej. Kështu u-formuan edhe një herë rreshtat e gjatë para infermerisë për të bërë vizitën mjekësore, para magazinave të ndryshme për të dorëzuar pajimet e veshmbathjen e kohës së luftës, para komandës së kompanisë etj. Më në fund u-paraqitën në Zyrën e Transportit dhe, me kamionat që vuri kjo zyrë në dispozicion të tyre, u-drejtuan nga stacionet, ku do të hypnin të trena të ndryshëm.

Këtë njësi, të cilën e kemi parë në shumë faza të luftës e në çaste heroike, nuk mund t'a ndjekim më, sepse secili do të marrë drejtim të ndryshëm; secili do të vejë në vendlindje dhe në gjirin e familjes së vet. Këta ushtarë do t'i ndjekë vetëm

mirënjohja e bashkatdhetarëve të tyre, për liri të të cilëve luftuan e fituan. Gjithashtu do të jetë e përjetshme edhe mirënjohja për ata që ranë dëshmorë në fushën e luftës.

Pas një periudhë pushimi të merituar, secili prej tyre do të ketë problemet e veta për të zgjidhur, në mënyrë që sa më shpejt të jetë në gjendje të vijojë jetën normale në paqë e në punë. Kështu, ca do të kthehen në universitet, ca do të vazhdojnë mjeshtritë e tyre ndër fabrika, në ndërmarrje, ndër zyra etj.; kurse disa tjerë do të gëzojnë pensionin që do t'u akordojë shteti.

PYETJE

1. Për ku e shoqëroi Agimi trupin e Ushtarit të Panjohur?
2. Ç'shoqëroi Agimi për atdhe?
3. Ç'pëshpëritej para se të nisej Agimi për atdhe?
4. Kur pëshpëritej se njësia në të cilën bënte pjesë ai, do të dilte shpejt në lirim?
5. Ç'njësi do të dilte shpejt në lirim?
6. Cilës njësi i u-dha urdhër që të kthehej në atdhe?
7. Pikërisht në cilin qytet do të kthehej njësia e Agimit?
8. Cilët u-ngarkuan edhe një herë në anije?
9. Ku u-ngarkuan edhe një herë ushtarët e njësisë së Agimit?
10. Ç'i u-dorëzua të gjithë ushtarëve dhe graduatëve pas pak ditësh që arritën në bazë?
11. Pse nuk i u-dorëzua fleta e lirimit Agimit?
12. Kush duhej të ish në shërbim edhe për ca ditë?
13. Cilëve i u-dorëzua nga një fletë lirim pas pak ditësh që arritën në bazë?
14. Ç'ish bashkangjitur me fletën e lirimit?
15. Ku ishin radhitur zyrat e ndryshme, në të cilat duhej të shkonte secili para se të largohej?
16. Ku duhej të shkonte secili para se të largohej?
17. Çfarë rreshtash u-formuan edhe një herë?
18. Para cilave zyra u-formuan edhe një herë rreshtat e gjatë?
19. Pse u-formuan rreshtat e gjatë para infermerisë?



20. Në cilën zyrë do të bëheshin vizitat mjekësore?
21. Ku do të dorëzoheshin pajimet e veshmbathja e kohës së luftës?
22. Ç' do të dorëzohej në magazinat e ndryshme?
23. Ku u-paraqitën më në fund ushtarët e liruar?
24. Kush u-paraqit më në fund në zyrën e transportit?
25. Ç'vuri në dispozicion të tyre zyra e transportit?
26. Në dispozicion të kujt vuri kamiona zyra e transportit?
27. Me ç'mjete u-drejtuan nga stacionet ushtarët e liruar?
28. Nga u-drejtuan ata me kamionat që vuri në dispozicion të tyre zyra e transportit?
29. Në çfarë mjet transporti do të hypnin ushtarët në stacionet e ndryshme?
30. Cilën njësi e kemi parë në shumë faza të luftës e në çaste heroike?
31. Ku dhe në çfarë çastesh e kemi parë këtë njësi?
32. Pse nuk mund t'a ndjekim më këtë njësi?
33. Kush do të marrë ndër trena drejtim të ndryshëm?
34. Çfarë drejtimi do të marrë secili?
35. Ku do të vejë secili ushtar?
36. Kush do të vejë në vendlindje dhe në gjirin e familjes së vet?
37. Mirënjohja e kujt do t'i ndjekë këta ushtarë?
38. Kë do të ndjekë mirënjohja e bashkatdhetarëve?
39. Për liri të kujt luftuan dhe fituan këta ushtarë?
40. Pse luftuan këta ushtarë?

41. Si do të jetë mirënjohja e bashkatdhetarëve për ata që ranë dëshmorë në fushën e luftës?
42. Mirënjohja e kujt do të jetë e përjetshme për ata që ranë dëshmorë në fushën e luftës?
43. Për kë do të jetë e përjetshme mirënjohja e bashkatdhetarëve?
44. Kush do të ketë problemet e veta për të zgjidhur?
45. Ç'do të ketë për të zgjidhur secili?
46. Pas çfarë periudhe do të ketë secili problemet e veta për të zgjidhur?
47. Cilët do të jenë në gjendje të vijojnë jetën normale në paqë e në punë pas një periudhë pushimi të merituar?
48. Çfarë jete do të jetë në gjendje të vijojë secili?
49. Si do t'a vijojë secili jetën normale?
50. Kush do të kthehet në universitet?
51. Ç'do të bëjnë ca tjerë?
52. Cilët do të vazhdojnë mjeshtritë e tyre ndër fabrika, në ndërmarje, ndër zyra etj.?
53. Ku do t'i vazhdojnë ca prej tyre mjeshtritë e tyre?
54. Ç'do të gëzojnë disa tjerë?
55. Kush do të gëzojë pensionin që do t'i akordojë shteti?
56. Kush do t'u a akordojë pensionin disa tjerëve?
57. Cilëve do t'u akordojë pension shteti?
58. Kur do të ju dorëzohet fleta e lirimit, a do të ktheheni në gjirin e familjes suaj?
59. A e mbani mend datën kur jeni paraqitur në këtë shkollë?
60. Në ç'moshë do të dëshironit të dilni në pension?

## FJALOR

për të akorduar (unë akordoj)	(v.)	to grant, accord; to tune (a musical instrument)
altar, -i altarë, -t	(m.)	altar
bandë, -a banda, -t	(f.)	band (music); gang
bashkangjitur	(adv.)	attached, herewith
dekoratë, -a dekorata, -t	(f.)	decoration
dëshmor, -i dëshmorë, -t	(m.)	martyr
dispozicion, -i	(m.)	disposal
graduat, -i graduatë, -t	(m.)	an Army Pfc and his equal in other branches of the Armed Forces
gji, -ri gji, -të	(m.)	breast, bosom; udder; bay; midst
helmetë, -a helmeta, -t	(f.)	helmet
heroik, -ë heroike	(adj. m. & f.)	heroic
himn, -i himne, -t	(m.)	anthem; hymn
infermeri, -a infermeri, -të	(f.)	infirmary
liri, -a	(f.)	freedom, liberty

lirim, -i	(m.)	release; discharge (mil.)
mbarë	(adj.)	all, entire
i, e, të merituar të merituar	(adj. m. & f.)	deserved
mirënjohje, -a	(f.)	gratitude
mizëri, -a	(f.)	see "mori"
normal, -e	(adj. m. & f.)	normal
përmbajtje, -a	(f.)	contents
për t'u-pëshpëritur (pëshpëritet se....)	(v.)	it's a rumor that....
i pranishëm, i pranishmi të pranishëm, të pranishmit	(m.)	present, those present
prekës, -e	(adj. m. & f.)	touching, moving, stirring
për t'u-radhitur (unë radhitem)	(v.)	to be lined up; to be listed; to be set up (type)
për t'u-rreshtuar (unë rreshtohem)	(v.)	to be lined up; to be listed
rreth e rrotull	(adv.)	around
sakrificë, -a sakrifica, -t	(f.)	sacrifice
shesh, -i sheshe, -t	(m.)	square, plaza
i, e, të tërhequr të tërhequra	(adj. m. & f.)	drawn (by), towed
i, të trishtueshëm e, të trishtueshme	(adj. m. & f.)	sad

turmë, -a turma, -t	(m.)	crowd, mass
therori, -a therori, -të	(f.)	sacrifice
vendlindje, -a vendlindje, -t	(f.)	birthplace
për të zgjidhur (unë zgjidh)	(v.)	to solve, resolve; to absolve; to untie

## SHËNIME

për të dalë në pension (unë dal në pension)	to retire (from office, business, etc.)
fletë lirimi	discharge papers
në zi	in black

## DETYRË SHTEPIE

Përktheni fjalitë që vijojnë:

1. What's the name of this plaza?
2. I chose one problem out of three and I think I solved it.
3. He holds the highest decoration in the country.
4. I don't like sad songs very much.
5. His birthplace is Korça.
6. All those present applauded his beautiful speech.
7. There is a rumor that he is dead.
8. S'më akorduan lejë, prandej s'vete dot.

L. 110

9. Ai është një nga dëshmorët e luftës së fundit.
10. Në shenjë mirënjohje i bënë një peshqesh.